<sup>37</sup> Shih Matteo Cinelli, Walter Quattrociochi, Alessandro Galeazzi et al., Infodemia COVID-19 e medias sociale, «Raporte shkencore», 10, 16598 (2020), <https://doi.org/10.1038/s41598-020-73510-5>.

të diskutimit online? A mund të mbahet Twitter përgjegjës për cicërimat raciste? Ose YouTube për video raciste?

## 1.6 Masa specifike për gjuhën e urrejtjes online?

Sa i përket prodhimit të përmbajtjes, shkëputja që krijohet kur ke mundësi të shkruash pa ndonjë detyrim për t'u shfaqur direkt nënkupton se komunikimi virtual u mundëson njerëzve të ndjejnë liri më të madhe se si të shprehën. Mirëpo për fat të keq, kjo ka edhe një anë të errët dhe media sociale është shndërruar në terren pjellor për diskutime të ashpra që shpesh rezultojnë në përdorimin e gjuhës fyese, poshtëruese dhe kërcënuese, ose me komente që gjenerojnë një ndjesi të rrezikut, kërcënimit dhe pasigurisë, duke shkaktuar kështu dëm tek shënjestrat direkte duke i sulmuar, poshtëruar dhe dehumanizuar ata.

Lehtësia relative e ruajtjes së anonimitetit në një mjedis online sigurisht që i ka kontribuar përkeqësimit të dëmit emocional ose psikologjik që u bëhet viktimave të gjuhës së urrejtjes (dhe i ka shtyrë drejt diskutimit të vazhdueshëm për dhe kundër anonimitetit online).<sup>38</sup> Kur identitetet e vërteta të atyre që janë përgjegjës për bullizmin kibernetik apo mesazhet e urrejtjes që shpërndahen nëpër rrjete sociale janë të mbështjella nga vëli i anonimitetit apo i pseudonimeve, vetë dyshimi se ata persona mund të jetojnë pranë viktimës apo të frekuentojnë të njëjtat rrethe shoqërore, arsimore apo profesionale ka gjasa të shkaktojë shqetësim. Nga ana tjetër, shpeshherë krijohen mesazhe të urrejtjes edhe kur viktimat është krejtësisht e panjohur dhe shënjestra e vërtetë bëhet grupi të cilit ai/ajo i përket. Në këtë rast, qarkullimi i urrejtjes mund të jetë mënyra më e lehtë që autori i mesazhit, i cili në këtë rast nuk ka ndonjë interesim për t'u fshehur, të tërheqë vëmendje, pëlqime dhe shikueshmëri.

Cilado qoftë arsyeja, kur mesazhet e urrejtjes qarkullohen përmes shërbimeve të rrjeteve sociale, **amplifikimi që marrin ato mesazhe, bashkë me perceptimin se shpërndarja e tyre është e pakontrolluar, mund të rrisë nivelin e shqetësimit të viktimave.** Po kështu, edhe vlefshmëria apo autoriteti në dukje që u vishet këtyre mesazheve nga numrat e lartë të pëlqimeve, përmendjeve, preferimeve apo ndjekësve që mund të tërheqin.

Mundësia që përmbajtja në dispozicion online të jetë e përhershme është gjithashtu një konsideratë e rëndësishme kur përcaktohet natyra dhe shkalla e dëmit të shkaktuar nga gjuha e urrejtjes. Shfaqja e gjuhës së urrejtjes online zakonisht është më e pakontrolluar sesa në ekuivalentet tradicionale, jo në internet. Qëndrueshmëria e përmbajtjes online mundësohet edhe nga linqet dhe aftësia për të kërkuar në internet: pas shpërndarjes së saj origjinale përmbajtja mbetet e gjurmueshme dhe kryesisht e rikuperueshme në një masë të paparë kur del online, madje edhe kur përmbajtja fillestare është memorizuar ose larguar.<sup>39</sup> Kjo do të thotë se ekziston rreziku që viktimat e gjuhës së urrejtjes të përballen vazhdimisht, ose të paktën në mënyrë të përsëritur, me të njëjtat raste të gjuhës së urrejtjes edhe pas artikulimit të tyre fillestar.

**Gjuha e urrejtjes online shkon përtej thjesht shprehjes së ideve apo mospajtitimit: ajo nxit frikën, frikësimin dhe ngacmimin e individëve dhe grupeve.** Kjo mund të rezultojë në shkelje të rëndë të dinjitetit njerëzor, madje të shkaktojë trauma, SPT, depresion dhe mundet edhe tentativa për vetëvrasje nga ana e viktimave të gjuhës së urrejtjes. Mund të jetë edhe nxitje për vrasje dhe gjenocid ndaj atyre që shënjestron.

Jo çuditërisht, **institucionet transnacionale dhe qeveritë vendore e njohin gjithnjë e më shumë problem gjuhën e urrejtjes.** Kjo ka çuar drejt propozimit të një sërë nismash kombëtare dhe ndërkombëtare që synojnë përkufizimin dhe trajtimin e problemit dhe përpjekje për të zhvilluar kundërmasa efektive. Edhe pse shumë mbrojtës të lirisë së shprehjes kanë frikë se autoritetet mund t'i keqpërdorin ligjet që kufizojnë shprehjen për t'ua mbyllur gojën kritikëve, pakicave, kundërshtarëve dhe prandaj, pretendojnë se, për këtë rrezik, mund të mos ia vlejë të kufizohet liria e shprehjes online, komuniteti ndërkombëtar duket se pajtohet, të paktën deri në një farë mase, se gjuha e urrejtjes online duhet të rregullohet disi.

Në nivelin evropian, *Protokolli Shtesë i Konventës mbi Krimin Kibernetik* i Këshillit të Evropës, që u miratua në vitin 2003 dhe hyri në fuqi në vitin 2006 për të nxitur «dispozita thelbësore, procedurale dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar [...] për të mbuluar [...] veprat penale të propagandës raciste ose ksenofobisë», ishte

<sup>38</sup> Shih <https://tinyurl.com/enpd7nhx>.

<sup>39</sup> Shih Alexander Brown, Pse gjuha e urrejtjes online është kaq e veçantë (krahasuar me atë offline)?, «Etnicitetet», 18 (3), 2018, f. 297-326.



posaçërisht me rëndësi për sjelljen e disa rregulloreve.<sup>40</sup> Jo vetëm që ishte një hap drejt sqarimit të përkufizimeve të gjuhës së urrejtjes online (që nënkupton «çdo material të shkruar, çdo imazh apo përfaqësim tjetër të ideve ose teorive, që mbron, promovon ose nxit urrejtjen, diskriminimin ose dhunën, kundër çdo individ ose grupi të individëve, bazuar në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare ose etnike, si dhe fenë nëse përdoret si pretekst për ndonjë nga këta faktorë»), por gjithashtu i detyronte shtetet palë të miratojnë masa legislative dhe masa të tjera për t'u përfshirë si vepra penale sipas ligjeve vendore kundër gjuhës së urrejtjes online.

Kjo ka çuar në marrjen efektive të masave të ashpra ndaj gjuhës së urrejtjes online në disa vende evropiane, si Danimarkë, Britani, Francë, për të përmendur disa.<sup>41</sup> Mirëpo, përfshirja e *Protokollit Shtesë* të Këshillit të Evropës në sisteme të ndryshme ligjore kombëtare ka dalë të jetë sfiduese. Interneti është medium global transnacional dhe një pjesë e madhe e materialit që mund të shihet me rregullore më strikte në disa vende, mund të jetë jashtë juridiksionit të gjykatave të atyre vendeve. Nëse ndonjë përmbajtje ekstremiste mund të jetë e paligjshme dhe që i nënshtrohet fshirjes në ndonjë vend evropian për shembull, nuk do të thotë se mund të fshihet gjithnjë, pasi shpeshherë, serverët e mediave sociale gjenden në SHBA, ku mund të mos ketë baza ligjore për fshirjen e atij materiale.

Po ashtu, edhe bashkëpunimi mes ofruesve të medias sociale për të implementuar protokolle të tilla dhe rregulloret e tjera kanë qenë jokonsistente dhe të shkëputura. Për një kohë të gjatë, për shembull, Twitter ka ndërmarrë veprime vetëm mbi bazën e raportimeve ose kërkesave, pa ndonjë sistem tjetër të vetin për filtrim dhe pa marrë përgjegjësi për cicërima urrejtjeje. Pavarësisht nismave si INHOPE dhe INACH<sup>42</sup> që, për një rrjet të linjave të drejtpërdrejta të internetit dhe kompani, ofruan mekanizëm për të pranuar ankesa nga publiku për pohime të përmbajtjes së paligjshme në internet, gjërat nisën të lëvizin vetëm pasi Komisioni Evropian nxori në maj 2016 *Kodin e sjelljes për t'iu kundërvënë gjuhës së urrejtjes së paligjshme*, me të cilin ranë dakord edhe lojtarë kyçë si Facebook, Microsoft, Twitter dhe YouTube (më vonë edhe Instagram, Snapchat, Dailymotion dhe TikTok).<sup>43</sup>

Mirëpo, ISP-të komerciale mund të kenë rënë dakord me vullnetin e tyre për t'i penguar përdoruesit që të postojnë gjuhë të urrejtjes nëpërmjet shërbimeve të tyre, por një pjesë e madhe e **zbatimit të ligjit mund të ndodhë kryesisht përmes bashkëpunimit ndërkombëtar vullnetar** dhe ende nuk ka ndonjë mënyrë për t'i detyruar ata të kenë mekanizëm monitorimi. **Prandaj roli i organizatave të shoqërisë civile ka rëndësi kyçe për të monitoruar qarkullimin e gjuhës së urrejtjes në internet** dhe media sociale, për sa kohë që nismat për t'i përfshirë përdoruesit e internetit në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe për të zhvilluar programe edukative për t'i bërë ata të kuptojnë se gjuha e urrejtjes bart përgjegjësi penale, mund të jetë krim dhe nuk duhet të konsiderohet e pranueshme. **Harmonizimi i legjislationit (në nivel evropian) është i dëshirueshëm dhe i këshillueshëm, por nuk ka gjasa që të përcaktohet si qëllim pa bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet shteteve, partnerëve mediatikë dhe aktorëve nga shoqëria civile.**

## 1.7 Gjuha e urrejtjes dhe zbatimi i ligjit: cilat janë opsionet?

Në mesin e nismave më të fundit, **Ligji Gjerman për Zbatimin e Rrjetit** (NetzDG) që u miratua në vitin 2017 ka përcaktuar termat e referencës dhe krahasimit për shumë vende.<sup>44</sup> Kur u miratua në vitin 2017, Ligji për Zbatimin e Rrjetit (NetzDG) shkaktoi protesta të zhurmshme nga kryqtarët e lirisë së shprehjes: kritikët e ligjit thanë se masat e tij, që kërkojnë nga platformat e mediave sociale që menjëherë të fshijnë materialin nxitës ose përndryshe përballen me gjopa të mëdha, mund të shtypin gjuhën politike ose të përdoren si model për qeveritë autoritare që të godasin kundërshtimet online.

Përkundrazi, kritikë të tjerë thonë se ai nuk ka shkuar mjaftueshëm larg, pasi njerëzit që postojnë gjuhë të urrejtjes duhet të demaskohen dhe të vihen para drejtësisë, duke kërkuar azhurnimin që do t'i detyrojë platformat ta raportojnë aktivisht gjuhën e urrejtjes tek agjencitë për zbatimin e ligjit dhe të zbulojnë për autoritetet identitetin e përdoruesve pa urdhër gjyqate, ashtu si kërkohet aktualisht në Gjermani. Sipas mbrojtësve të privatësisë, kjo sidoqoftë do të shkelte garancitë e sundimit të ligjit në kushtetutën gjermane.

<sup>40</sup> Shih <https://tinyurl.com/48rpfswu>.

<sup>41</sup> Shih <https://tinyurl.com/ft4ew495>.

<sup>42</sup> Shih [www.inhope.org](http://www.inhope.org); [www.inach.net](http://www.inach.net).

<sup>43</sup> Shih <https://tinyurl.com/7bbm2f9z>.

<sup>44</sup> Shih <https://tinyurl.com/nvbhuvyf>.

Hartuar në fundin e viteve 1950, ligjet e fuqishme gjermane për gjuhën e urrejtjes ishin reagimi direkt pas përvojës së vendit me nazizmin dhe pranonin se fuqizimi i autoritarizmit pjesërisht u mundësua nga fakti se ishte e ligjshme të përdorje propagandë nxitëse që mbështetej mbi trope raciste dhe ishte hartuar për të ushqyer paragjykimet. Tashmë prej dekadash, nxitja e urrejtjes kundër grupeve kombëtare, fetare, etnike ose racore në Gjermani është e paligjshme dhe ky vend ka disa nga ligjet më të rrepta, ndër to edhe NetzDG, se ç'është gjuha e pranueshme.

Mirëpo as NetzDG nuk ia ka dalë ta pengojë gjuhën e urrejtjes të kapërcejë në dhunë të vërtetë, sikurse ndodhi në qershor 2019, kur Walter Lübcke, një politikan lokal gjerman në Kassel, u qëllua për vdekje nga një neonazist, pasi u bë shënjestër e krahut të djathtë ekstrem duke mbrojtur politikën e kufijve të hapur të Gjermanisë dhe duke u shndërruar në fytyrën e politikave për refugjatët të Gjermanisë. Apo si ndodhi në shkurt 2020 (vetëm pak orë pasi qeveria e Merkelit miratoi një nga dy azhurnimet e NetzDG), kur një burrë, që më parë kishte publikuar online video dhe dokumente ku citonte teori konspirative të internetit dhe bënte thirrje për "shfarosjen" e disa grupeve etnike të caktuara, vrau nëntë vetë në dy shishabare në Hanau.

Vrasja e Lübcke-s dhe masakra në Hanau vërtetuan nevojën urgjente për zbatime të mëtejshme të NetzDG për t'u përballur dhe luftuar gjuhën e urrejtjes online dhe krimin e urrejtjes, që pavarësisht përpjekjeve në vend janë mjaft të përhapura përmes një rrjeti të rrezikshëm të aktivistëve të radikalizuar të së djathtës ekstreme. Sipas këtyre masave të reja, platforma si Facebook dhe Twitter tani janë të detyruara që shembuj posaçërisht të rëndë të gjuhës së urrejtjes t'i sjellin në vëmendjen e agjencive për zbatimin e ligjit dhe ideja pas kësaj është që një sulmues potencial të kapet para se ai/ajo t'i drejtohet dhunës. Edhe kompanitë janë të detyruara të japin më shumë informata se si dhe me përdorimin e cilës teknologji i trajtojnë rastet kur ju vjen në vëmendje përmbajtje potencialisht e paligjshme.

Mirëpo OJQ si Digitale Gesellschaft, shtrëngimi i mëtejshëm i ligjit duke ia kaluar disa pjesë të **zbatimit të ligjit kompanive private** dhe duke mundësia mbledhjen e të dhënave në shkallë masive, nuk e zgjidh problemin me ekstremizmin e krahut të djathtë dhe nuk i trajton tërësisht shqetësimet e viktimave, sikurse vështirësia e ndër marrjes së veprimeve kundër postuesve anonimë të gjuhës së urrejtjes, e demonstrimit se çfarë cilësohet ligjërisht si gjuhë e urrejtjes, e sjelljes së kryesve para drejtësisë me çdo kusht (normalisht viktimat duhet të paguajnë paraprakisht për kostot e procedurave ligjore) dhe pa iu ekspozuar hakmarrjes.

Nga ana tjetër, kundërshtarët e NetzDG paralajmërojnë se ligji mund t'i sjellë dëme afatgjate standarde të vendit për mbrojtjen e të dhënave. Për më tepër, ata shqetësohen posaçërisht për faktin se **moderatorët e përmbajtjes (në mënyrë masive) që janë punësuar nga platformat** për të respektuar rregulloret do të jenë të parët që marrin vendimin nëse një koment apo postim i caktuar është në kundërshtim me ligjet për gjuhën e urrejtjes në Gjermani (NetzDG nuk ripërkufizon se çfarë është e paligjshme dhe çfarë jo, pasi vetëm synon zbatimin më të mirë të ligjit ekzistues) – diçka kjo që shpeshherë gjyqtarët kanë vështirësi ta konstatojnë.

Nga moderatorët e përmbajtjes atëherë pritet t'i raportojnë autorët e atyre postimeve tek hetuesit e Policisë Penale Federale Gjermane.

Kjo jo vetëm që do të shkaktojë një cunami me çështje me të cilat duhet të merren autoritetet, por t'i detyrosh platformat që të shpaleshin identitetet e përdoruesve u mundëson autoriteteve të ndërtojnë një databazë gjithnjë e në zgjerim me informacion shumë të ndjeshëm, sikurse ka ndodhur në Rusi me miratimin e ligjit të tyre për gjuhën e urrejtjes (që i referohet shprehimisht ligjit gjerman)<sup>45</sup> dhe me mjetet e raportimit, që shpesh manipulohen nga nxitësit në internet, që përdoret për t'ia mbyllur gojën kundërshtarëve dhe pjesëtarëve të grupeve të marginalizuara dhe për ta rrezikuar edhe më tej lirinë e shprehjes në vend. E njëjta gjë ka ndodhur në Hungari, Turqi dhe rishtazi, në Poloni.

Pavarësisht pikave të veta sfiduese, që kohëve të fundit janë trajtuar nga konferenca e qeverisë së Gjermanisë *Largimi i gjuhës së urrejtjes* (shkurt 2021)<sup>46</sup> - që nga viti 2017, më shumë se një duzinë vendesh, nga Venezuela e deri në Filipine dhe Malajzi kanë miratuar legjislacion mbi gjuhën e urrejtjes online, që deri diku referohet në NetzDG dhe që të gjithë ata i kushtojnë shumë vëmendje mënyrës se si Berlioni ka trajtuar baraspeshën e brishtë të kontrollimit të gjuhës së urrejtjes online dhe ruajtjes së lirisë qytetare.

<sup>45</sup> Shih <https://tinyurl.com/5bvjk7sf>.

<sup>46</sup> Shih <https://tinyurl.com/phe3jms4>.

Në maj 2020, parlamenti francez miratoi një ligj kundër gjuhës së urrejtjes («**Loi Avia**»)<sup>47</sup> që u përkrah nga shumë organizata të shoqërisë civile. Ky ligj ka shumë ngjashmëri me ligjin gjerman, por pësoi një refuzim madhor kur në qershor, Gjykata Kushtetuese e Francës ia rrëzoi disa seksione si jokushtetuese, duke i detyruar ligjberësit që ta rihartonin tekstin. Në tekstin origjinal, nga platformat online kërkohej që ta largonin shumë shpejt përmbajtjen e paligjshme në të kundërt do të përballëshin me gjoba të mëdha (deri në 4% të të ardhurave të tyre globale), duke u dhënë afate një-orësh për të larguar përmbajtje të ndërlidhur me terrorizmin apo pedofilinë ose afat njëzet e katër-orësh kur ishte fjala për përmbajtje tjetër “haptazi të paligjshme”, si gjuha e urrejtjes, komente raciste, apo paragjykitime fetare.

Ashtu si NetzDG, ligji ishte hartuar për të ushqyer përgjegjësinë nga ofruesit e shërbimeve online duke krijuar edhe një prokurori të specializuar në përmbajtje digjitale dhe një njësi qeveritare për të monitoruar gjuhën e urrejtjes online. Mirëpo kjo u kritikua haptazi nga Komisioni Konsultativ Kombëtar për të Drejtat e Njeriut pasi rrishte rrezikun e censurës. Grupet për liritë qytetare online thanë se ishte jashtë realitetit të mendoje se përmbajtja e paligjshme mund të largohet aq shpejt dhe se afatet e shkurtra për largim dhe gjobat e mëdha për mosrespektim kryesisht do të dënonin ndërmjetësit më të vegjël dhe kështu, do të shkonin në dëm të pluralitetit të tregut dhe do t'i nxisnin platformat për të tejlarguar përmbajtje, duke ia besuar kështu kontrollimin e mendimeve dhe të shprehjes bizneseve private, me vendndodhje kryesisht në vende të huaja. Sipas Gjykatës Kushtetuese, afatet për largimin e përmbajtjes së paligjshme nuk mund të ishin realiste, sepse përcaktimi se çfarë është e paligjshme dhe çfarë jo nuk mund të kërkohej nga kompanitë private (por vetëm nga institucionet republikane) dhe kërkesa që administrata publike të merret me këtë një numër të çështjeve që supozohet të jetë shumë i lartë brenda një kohe aq të shkurtër do të ishte krejtësisht e paimagjinueshme. Ligji më në fund u nënshkrua nga Emanuel Macron më 24 qershor 2020, por që të shpallej ai u «retushua në mënyrë të konsiderueshme» (ndryshime të thella) dhe kryesisht përfshiu «përshtatje më të vogla» (rregullime minore) që qartazi ia kanë reduktuar fushëveprimin dhe sferën.<sup>48</sup>

Në verën e vitit 2020, Austria diskutoi për **Kommunikationsplattformen-Gesetz (KoPI-G)**, një ligj për gjuhën e urrejtjes online (edhe ky i bazuar në NetzDG) që do t'u mundësonte përdoruesve të vërenin përmbajtje potencialisht të paligjshme dhe ta raportonin, platformave që të vendosnin nëse përmbajtja ishte «dukshëm e paligjshme» (në atë rast duhet të fshihet brenda 24 orëve pas raportimit). Sërish, teksti e le në dorë të vetë kompanive të vendosin brenda afatit nëse përmbajtja është e paligjshme ose jo («privatizimi i zbatimit të ligjit», sikurse thonë kritikët),<sup>49</sup> dhe gjykatat mund të kontrollojnë vetëm më pas nëse platforma ka vepruar në mënyrë të ligjshme. Ashtu si në Gjermani, duke iu frikësuar gjobave të larta, platformat mund të preferojnë të fshijnë më shumë përmbajtje se sa më pak, duke u dhënë kështu shkas shqetësimeve për lirinë e shprehjes.

Mirëpo ligji austriak sjell edhe disa risi të rëndësishme: ndërkohë që NetzDG shënjestron vetëm median sociale, qeveria austriake ia nënshtron këtij ligji të gjitha platformat që kanë përmbajtje të gjeneruar nga përdoruesit, që do të thotë se edhe forumet e lajmeve, portale si Wikipedia, platforma si WhatsApp apo softuer për video konferenca si Zoom, përmes të cilave gjatë pandemisë vërtet ka qarkulluar një volum tepër i lartë i gjuhës së urrejtjes dhe që duhet të mbulohen nga rregullorja. Kjo mund të jetë problematike për kompani më të vogla, të cilat duhet të krijojnë moderim intensiv për të respektuar afatet, por mund të ndihmojë institucionet në mënyrë efektive që të monitorojnë në thellësi dhe të shënjestrojnë gjuhën e urrejtjes përtej medias sociale dhe të përcjellin evoluimin e dukurisë në mënyrë më të kujdesshme. NetzDG, ligji francez dhe ligji austriak kanë treguar se kur është fjala për të luftuar gjuhën e urrejtjes online nuk ka përgjigje të lehta dhe se standardet e përbashkëta për të rregulluar gjuhën e urrejtjes online nuk janë të lehta për t'u arritur, për t'u shpërndarë dhe zbatuar.

Një studim i zhvilluar në pranverën e vitit 2020 nga Këshilli i Evropës që shqyrtonte risitë më të fundit në mjetet e qeverisjes për gjuhën e urrejtjes online, nisur nga qeveritë kombëtare, organizatat ndërqeveritare dhe ndërmjetësuesit e internetit nëpër Evropë viteve të fundit, sugjeron se standardet e përbashkëta për rregullimin e gjuhës së urrejtjes në Evropë, edhe pse janë të nevojshme për të shmangur efektin e fragmentuar, nuk ka nevojë të zbatohen në mënyrë identike për secilin vend dhe duhet të mundësojnë pluralizmin dhe lirinë e shprehjes. Standardet e përbashkëta për të rregulluar gjuhën e urrejtjes online në Evropë duhet të ruajnë elemente të rëndësishme të decentralizimit, sidomos për çështje nga «zona gri» (kur ka dyshime për paligjshmërinë e përmbajtjes), që duhet të trajtohen nga institucione kompetente të pavarura të mbikëqyrjes apo për nisma që

<sup>47</sup> Shih <https://tinyurl.com/erwzd5a4>.

<sup>48</sup> Shih <https://tinyurl.com/vas3h6k>.

<sup>49</sup> Shih <https://tinyurl.com/42pmdnsj>.

synojnë të nxisin bashkëpunimin ndërmjet aktorëve dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve, apo një qasje më e ndjeshme ndaj viktimave, që mund të kenë nevojë të hartohen dhe të zbatohen nga vendet për të maksimizuar rrjetet ekzistuese që përfshijnë edhe agjenci qeveritare, platforma të internetit dhe organizata të shoqërisë civile, edhe grupe të njerëzve që zakonisht janë shënjestër e gjuhës së urrejtjes.

Për më tepër, **duken krijuar mekanizma për të zbutur shtysën për të tejfshirë materiale, gjë që rrit censurën dhe për të përdorur metodën e ndjeshme ndaj viktimave** në vend të qasjes dënuese, që duhet të jenë në zemër të përpjekjeve nga ana e qeverisë. Sa i përket viktimave, në nivel të moderimit ato duhet të njoftohen për vendimet e marra, mekanizmat që merren me raportimin e gjuhës së urrejtjes duhet të shpjegohen me fjalë të thjeshta dhe në shumë gjuhë dhe ata duhet të fuqizohen për të ndikuar mbi strategjitë e moderimit të informacionit dhe të ndikojnë mbi rezultatet e moderimit, aty ku është e mundur. Organet e mbikëqyrjes duhet të shpjegojnë arsyetimin prapa vendimeve të tyre për të ndihmuar me lehtësimin e rekuperimit të viktimave, p.sh., duke iu siguruar qasje në drejtësinë restorative. Në nivel rregullativ, mekanizmat e raportimit duhet të minimizojnë rrezikun e ritraumatizimit dhe viktimave u duhet mundësuar të luajnë rol aktiv në proceset ligjore ose administrative, përfshirë dhënien e dëshmimeve.

## 1.8 Një hap përpara: Ligji për Shërbime Digjitale

Brenda këtij konteksti, më 15 dhjetor 2020, Komisioni Evropian publikoi propozimin që pritej prej kohësh për **Ligjin për Shërbime Digjitale (LSHD)**: rezultat ky i disa viteve të përbaljes me vështirësi që janë pjesë e shpërndarjes online të përmbajtjes së paligjshme dhe të shqetësimeve në rritje për amplifikimin e përmbajtjes 'toksike' dhe disinformacionit.<sup>50</sup>

LSHD-ja synon të konsolidojë pjesë të ndryshme të veçanta të legjisllacionit të BE-së dhe të praktikave vetërregulluese që merren me përmbajtjen online të paligjshme ose 'të dëmshme'. Gjithashtu, synon të harmonizojë rregullat për ofrimin e shërbimeve digjitale në BE dhe të pakësojë fragmentimin e legjisllacioneve potencialisht kundërshtuese, si NetzDG në Gjermani apo Ligji Avia në Francë.

Sipas LSHD-së, **ndërmjetësuesit në internet duhet të përmbushin detyrën e tyre për kujdes, në kuadër të së cilës duhet t'u përmbahen detyrimeve ligjore** dhe të veprojnë në përputhje me përgjegjësinë e tyre korporative sociale për të trajtuar gjuhën e urrejtjes, duke marrë në konsideratë si duhet Rekomandimin CM/Rec (2016) të Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare lidhur me të Drejtat e Njeriut dhe Biznesin, pra, për përgjegjësinë e sipërmarrjeve që të respektojnë të drejtat e njeriut.<sup>51</sup>

Po ashtu, synimi është të kërkojë të mbrojë të drejtat themelore të përdoruesve, si liria e shprehjes, ndërkohë që i bën platformat online dhe ndërmjetësuesit në internet të respektojnë detyrimet ligjore, të veprojnë në përputhje me përgjegjësinë e tyre korporative sociale për të trajtuar gjuhën e urrejtjes dhe të japin llogari para autoriteteve publike nëpërmjet detyrimeve të reja të konsiderueshme dhe transparente.

Në fakt, nga të gjithë ndërmjetësuesit do të kërkohej të:

- **paraqesin raporte të transparencës** – të kategorizuar nga lloji i përmbajtjes së paligjshme në fjalë duke deklaruar a) numrin e njoftimeve të marra, b) çdo veprim të ndërmarrë dhe kohën mesatare për ta marrë, c) nëse ky veprim u mor në bazë të ligjit apo të kushteve dhe detyrimeve të ofruesit, d) dhe nëse ka pasur moderim të përmbajtjes me nismë të vet ofruesit;
- **paraqesin informacion për numrin e kontesteve** të paraqitura tek organet për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve, rezultatit e këtyre kontesteve dhe kohën që është dashur për t'i zgjidhur, si edhe për zbatimin e masave pezulluese si reagim ndaj postimit të përmbajtjes haptazi të paligjshme, njoftimeve haptazi të pabazuara dhe paraqitjes së ankesave të pabazuara;
- **jenë transparente dhe të ofrojnë informacion** për çdo përdorim të mjeteve automatike për qëllime të moderimit të përmbajtjes, përfshirë indikatorët e saktësisë së filtrave të përdorur dhe të masave mbrojtëse që janë zbatuar.<sup>52</sup>

<sup>50</sup> Shih <https://tinyurl.com/w4s32ske>.

<sup>51</sup> Shih <https://tinyurl.com/266m9n78>.

<sup>52</sup> Për zbulimin dhe filtrimin automatik të gjuhës së urrejtjes, Shih. Për zbulimin dhe filtrimin automatik të gjuhës së urrejtjes, Shih Anne Schmidt, Michael Wiegand, Një anketë për zbulimin e gjuhës së urrejtjes përmes përpunimit natyror të gjuhës, punimet e Seminarit të Pestë Ndërkombëtar për Përpunimin e Natyrshëm të Gjuhës për Media Sociale, Valencia, 2017 [<https://tinyurl.com/45b4xa7z>]; Shih edhe

Platformat online shumë të mëdha (VLOP) po ashtu i nënshtrohen kërkesave për transparencën e reklamimit online, për të publikuar vetëvlerësimet e tyre lidhur me rreziqet sistematike të platformave të tyre dhe të deklarojnë masat përkatëse zbutëse që kanë miratuar si kundërpërgjigje.

Nëse (dhe kur) zbatohet tërësisht, **LSHD-ja duhet të harmonizojë raportimin dhe mbledhjen e të dhënave**, duke e bërë më të lehtë që të shqyrtohen deklaratat që japin kompanitë e mediave sociale lidhur me arsyet e largimit të përmbajtjes dhe të krahasohen me mënyrën se si e trajtojnë dhe përmirësojnë moderimin e përmbajtjes në platformat e tyre. Nga ky këndvështrim, LSHD-ja duket si një hap përpara drejt synimit për t'i bërë platformat më të mëdha të përgjegjshme për mënyrën se si e bëjnë moderimin e përmbajtjes.

Mirëpo, **LSHD-ja përfshin gjithashtu edhe aspekte kundërthënëse për përgjegjësinë penale dhe fuqinë diskrecionale të ofruesve të medias**. Ai i fuqizon ofruesit e shërbimit të hostingut që të marrin vendime për ligjshmërinë e përmbajtjes pasi pranojnë njoftim të arsyetuar për paligjshmërinë e pohuar (Neni 14), pra, për të vendosur se farë duhet të mbrohet si liri e shprehjes dhe farë jo, që sërish nënkupton delegim të fuqisë juridiksionale dhe ligjore tek kompanitë private. Gjithashtu parasheh që nga VLOP-et kërkohet të bëjnë së paku një herë në vit vlerësimin e rrezikut për sistemet e tyre të moderimit të përmbajtjes (Neni 26), pa u dhënë udhëzime se si të zgjidhet konflikti ndërmjet shpërndarjes së përmbajtjes së paligjshme dhe ushtrimit të të drejtave themelore (sidomos të drejtat për privatësi dhe mbledhje të të dhënave, liria e shprehjes, ndalimi i diskriminimit dhe të drejtat e fëmijës), pra duke i lënë ata me një hapësirë të jashtëzakonshme të diskrecionit se si t'i zbusin këto rreziqe; edhe se rekomandohen rregullatorë të pavarur, platformat shumë të mëdha i nënshtrohen vetëm mbikëqyrjes së Komisionit Evropian, që nuk është rregullator i pavarur, por krahu ekzekutiv i BE-së.<sup>53</sup>

Nevoja **për të balancuar tregun online** është vërtet një tjetër sferë sfiduese. Pa trajtuar mjaftueshëm fuqinë e tyre ose pa përcaktuar kufizime për modelin e tyre të biznesit në bazë të grumbullimit masiv të të dhënave personale, profilizimit dhe reklamimit tek grupet e synuara, dominimi i VLOP-eve në vend se të kundërshtohet, mund të rrënojset edhe më shumë. Pjesa më e madhe e ligjërimit publik (dhe gjuhës së urrejtjes) ndodh në një numër shumë të vogël të platformave që kanë fuqi të tepruar mbi rrjedhat e informacionit dhe rregullat e moderimit të përmbajtjes mund të mos jenë të mjaftueshme për ta trajtuar këtë problem, që mund të trajtohet duke e hapur tregun për platforma të reja dhe duke decentralizuar kanalizimin e ligjërimit publik.

## 1.9 Disa pyetje (dhe mundësi) të hapura

Debatet dhe nismat e kohëve të fundit lidhur me mundësinë e përmbajtjes së gjuhës së urrejtjes online kanë sfiduar jo vetëm përkufizimet ekzistuese për gjuhën e urrejtjes, kanë vënë në pikëpyetje qasjet legjislative ndaj saj, ose na kanë përkujtuar për baraspeshën e vështirë ndërmjet lirisë së shprehjes dhe masave që duhen për ta trajtuar diskriminimin. Ato kanë sjellë **pika të reja në rendin e ditës** lidhur me:

- Rekomandimet e BE-së dhe të Këshillit të Evropës kundrejt **rregulloreve shtetërore/kombëtare për barrën dhe përgjegjësinë penale të ndërmjetësuesve të internetit** (dhe **nevojës për ndërhyrje nga organe të pavarura për barazi** si palë e tretë që kanë ekspertizën e duhur për trajtimin e gjuhës së urrejtjes);
- kërkesën për politika transparente dhe mekanizma për ndarjen e të dhënave;
- shtysën që **moderatorët e përmbajtjes së ndërmjetësuesve të internetit të aftësohen si duhet** dhe t'u jepet përkrahja e duhur, përvojë solide me gjuhën e urrejtjes dhe të drejtat e njeriut dhe i kuptuar i qartë i konteksteve të rëndësishme lokale, kulturore, socio-politike dhe historike;
- mundësia që aktorët shtetërorë dhe nga sektori i internetit të zhvillojnë dhe vënë në **zbatim alternative, sidomos për përmbajtjen që nuk ka gjasa të jetë me përgjegjësi penale, civile ose administrative**, në mënyrë që të përkrahen nisma të cilat inkurajojnë dhe promovojnë kundërshtuesit, të drejtat e njeriut dhe vlerat pozitive shoqërore për të trajtuar gjuhën e urrejtjes;
- rëndësia kyçe për kornizat joligjore që të fuqizojnë njohuritë dhe ndërgjegjësimin mediatik të përdoruesve;

Paula Fortuna, Sérgio Nunes, Anketat për zbulimin automatik të gjuhës së urrejtjes në tekst, "Anketat kompjuterike ACM (CSUR)", 51 (2018), f. 1-30; Sean MacAvaney et al., Zbulimi i gjuhës së urrejtjes: Sfidat dhe zgjidhjet, "PloS one", vëllimi 14 (8), 2019. [<https://tinyurl.com/8xcj9b96>]

<sup>53</sup> Shih Neni 19, Me një vështrim: A e mbron lirinë e shprehjes Akti për Shërbimet Dixhitale i BE-së? [<https://tinyurl.com/3m6n36kh>]

- përgjithësisht, **bashkëpunimi i pashmangshëm ndërmjet institucioneve, ofruesve të medias, shoqërisë civile dhe komuniteteve të praktikës.** Në veçanti, shtetet dhe ndërmjetësuesit e internetit duhet të krijojnë bashkëpunim efektiv me grupet e shoqërisë civile, përfshirë grupet që potencialisht cenohen nga gjuha e urrejtjes, dhe të mbështesin përpjekjet e tyre për politika dhe praktika të përmirësuara për monitorimin, analizimin dhe trajtimin e gjuhës së urrejtjes.

Përveç miratimit të masave ligjore dhe rregullative, sfida është që **të parandalohet dhe luftohet gjuha e urrejtjes duke zhvilluar dhe zbatuar strategji ose plani veprimi gjithëpërfshirëse** që përmbajnë masa konkrete jo vetëm nga këndvështrimi ligjor, por edhe në fusha të tilla si rritja e ndërgjegjësimit, edukimi, promovimi i kundërsprehjes dhe dialogu ndërkulturor. Këto strategji duhet të përfshijnë eksplorimin kritik të rrënjëve të gjuhës së urrejtjes, përfshirë ato që burojnë nga përdorimi i disinformacionit dhe stereotipet negative dhe stigmatizimi i individëve dhe grupeve. Edukimi për të drejtat e njeriut, edukimi për qytetari demokratike dhe njohuritë për median dhe informacionin duhet të jenë pra, pjesë e kurrikulumit të përgjithshëm arsimor, dhe për aq sa është e mundur të zhvillohen trajnime të duhura për mësime dhe të bëhen rishikime periodike të librave shkollorë për t'i spastruar nga stereotipizimet dhe për të promovuar barazinë dhe diskurin jodiskriminues.

**Programet e trajnimit për organet përkatëse publike, përfaqësuesit e tyre, shërbyesit civilë dhe nëpunësit publikë,** përfshirë agjentët e zbatimit të ligjit dhe të forcave të sigurisë, gjyqësorit dhe të tjerë të përfshirë në administrimin e drejtësisë, personelin e shërbimeve mjekësore, duhet të hartohen në atë mënyrë që të nxisin njohjen e menjëhershme të gjuhës së urrejtjes, të trajtojnë dukurinë e regjistrimit të ulët, të shmangin përdorimin e saj dhe të kufizojnë ndikimin e saj tek ata që i cenon. Gjithashtu, ato duhet të përfshijnë trajnimin për nevojat e personave që janë viktimat e gjuhës së urrejtjes dhe të shmangen nga paragjykimet e pavetëdijshme apo të shprehura, armiqësia apo stereotipizimi që mund të luhetë gadishmërinë e personave të cenuar për të kërkuar përmirësim. Të dhënat nga sondazhi tregojnë se perceptimi i gjuhës së urrejtjes në transportin publik dhe zyrat publike është tronditës dhe shumë shqetësues (shih f...) dhe sugjerojnë hulumtim të mëtejshëm cilësor në këto sfera për të kuptuar më mirë përgjegjësitë, dinamikat, nevojat për trajnim dhe sfidat.

Shtetet duhet t'i inkurajojnë figurat publike, si politikanët, zyrtarët e nivelit të lartë, krerët fetarë, ekonomikë dhe të komuniteteve për të **promovuar kundërnarrativat dhe narrativat alternative, të dënojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të promovojnë mirëkuptim ndërmjet grupeve,** përfshirë edhe shprehjen e solidaritetit me ato viktimat e gjuhës së urrejtjes.

Pa vënë në rrezik pavarësinë e medias, **profesionistët e medias dhe gazetarët** duhet që në kuadër të edukimit të tyre fillestar dhe të vazhdueshëm të trajnohen për të dalluar, raportuar dhe redaktuar gjuhën e urrejtjes si dhe për ta shmangur përdorimin dhe përhapjen e saj dhe, më në përgjithësi, për rolin e gazetarëve/medias për të promovuar gjithëpërfshirjen nën ombrellën e të drejtave të njeriut.

**Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, organet për barazi, ndërmjetësuesit e internetit dhe organizatat e shoqërisë civile** duhet të inkurajohen për të punuar bashkërisht që të zhvillojnë dhe promovojnë komunikimin për kundërnarrativat dhe narrativat alternative të të gjitha kategorive të gjuhës së urrejtjes dhe t'i përfshijnë viktimat e gjuhës së urrejtjes në këtë proces, edhe duke e lehtësuar qasjen e tyre në media.

Në përgjithësi, duhet të rritet ndërgjegjësimi për rreziqet që paraqet gjuha e urrejtjes ndaj individëve, komuniteteve dhe shoqërive demokratike në tërësi. Shtetet duhet të mbështesin programet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnime që përfshijnë edhe kryesit e gjuhës së urrejtjes për t'i trajtuar paragjykimet, veprimet diskriminuese dhe shprehjet e tyre. Këto programe duhet të imponohen si sanksione alternative nga gjykata me qëllimin për të arritur drejtësinë restorative në interes të palëve të përfshira në komunitet.

Mekanizmat efektivë mbështetës, përfshirë ndihmën dhe asistencën juridike, këshillimin mjekësor, për strehim dhe psikologjik sigurisht që duhen krijuar për t'iu **ndihmuar 'viktimate' që të mos ndjehen të izoluar apo të braktisur, nëse jo të diskriminuar, nga institucionet, në mënyrë që të përballojnë me efektivitet dëmin e shkaktuar nga gjuha e urrejtjes.** Sikurse tregon sondazhi, rreziku për t'u bërë viktimë dhe "viktimizuar" së dyti është real dhe i pranishëm (shih f...). Po ashtu, rritja e ndërgjegjësimit që ka qasje të lehtë dhe të kuptueshme dhe aktivitetet edukative për grupe dhe për individë që **direkt dhe indirekt**

**shënjestrohen nga gjuha e urrejtjes**, të përshtatur për nevojat e tyre specifike, duhet gjithashtu të inkurajohen, promovohen dhe mbështeten financiarisht, jo vetëm për t'i bërë viktimat të vetëdijshme për të drejtat që kanë (dhe për t'iu mundësuar t'i zbatojnë të drejtat e tyre), por edhe për të **fuqizuar një kulturë të kujdesit, solidaritetit dhe gjithëpërfshirjes** në nivel kombëtar dhe lokal, që nënkupton edhe pjesëmarrje aktive (dhe empatike) për agjencitë e mirëqenies, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e arsimit.

**Raportimi i gjuhës së urrejtjes nga viktimat dhe dëshmitarët** duhet të mundësohet në mënyrën e duhur. Heqja e çdo pengese ligjore dhe joligjore për raportime të tilla dhe trajtimi i raportimit të mangët duhet të jetë prioritet institucional, deri në atë masë sa që të sigurohet se personat që raportojnë gjuhën e urrejtjes të jenë të mbrojtur nga çdo trajtim kundërvënës apo pasojë negative si reagim ndaj ankesës dhe nëse ndodh një viktimizim i tillë, kryesit të dënohen; njerëzit që janë viktimat të gjuhës së urrejtjes po ashtu duhet të marrin siguri se nuk do të bartin tarifa gjyqësore dhe administrative apo pagesa për përfaqësim.

**Të qëndrosh në krah të personave të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes** për ta kundërshtuar gjuhën e urrejtjes dhe për të kërkuar drejtësi para autoriteteve kompetente ose nëpërmjet procedurave ligjore sipas ligji civil, administrativ ose penal **duhet të mishërohet në çdo strategji apo kuadër që lufton gjuhën e urrejtjes**. Dhe duhet dhënë mbështetje institucionale për organizatat e të drejtave të njeriut, organet për barazi dhe shoqatat e shoqërisë civile, të cilat përkrahin ose përfaqësojnë, edhe ligjërish, viktimat dhe që gjithnjë e më shumë shënjestrohen nga gjuha e urrejtjes dhe agresioni sistematik edhe nga politikanët dhe media. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse mund të mos jetë e lehtë për t'u koordinuar dhe vënë në zbatim, por do t'u mundësonte të gjithë aktorëve të përfshirë në dinamikën e gjuhës së urrejtjes një **qasje tërësore** dhe një mundësi jo vetëm për të përkufizuar më mirë dhe për të kuptuar një dukuri komplekse, me shumë anë dhe të pandërprerë, por edhe për të reaguar në mënyrë kolektive dhe për të mbështetur njëri-tjetrin. Gjë për të cilën duhet të përkujdeset një shoqëri dhe institucionet e saj.

## 2. Gjuha e urrejtjes në Shqipëri – të dhëna dhe analiza<sup>54</sup>

---

### 2.1 Përmbledhje ekzekutive e gjetjeve

**Ky raport synon të sigurojë të dhëna në nivel kombëtar për situatën e gjuhës së urrejtjes në vend.** Kjo është një terminologji dhe dukuri shumë e re në Shqipëri, por ende e pranishme në mesin e popullatës së përgjithshme dhe grupeve të ndjeshme në veçanti. Ky raport do të sigurojë të dhëna lidhur me perceptimet, përvojat dhe besimin në institucionet që duhet të merren me gjuhën e urrejtjes me qëllim të plotësimit të zbrazëtirës së informacionit se si perceptohet kjo dukuri nga individët. Mostra përbëhet nga 1511 pjesëmarrës të zgjedhur në mënyrë rastësore dhe një mostër shtesë prej 301 të të anketuarve.

**Të dhënat tregojnë se ka njohuri të mira se çfarë është gjuha e urrejtjes.** Rreth 96 për qind e popullsisë e dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes dhe vetëm 6 për qind nuk e dinë se ç'nënkupton. Njerëzit që nuk dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes nuk janë pjesë e pyetjeve vijuese në analizë. Kjo përqindje është më e ulëta në radhët e grupit të ndjeshëm LGBTIQ dhe komunitetit rom/egjiptian. Niveli i njohurive të grupeve të ndjeshme duket se është më i ulët pasi rreth 16 për qind nuk e dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes. Kur u drejtohet pyetjeve të hapura, shumica e të anketuarve e asociojnë gjuhën e urrejtjes me fyerjen apo epitetet ndaj dikujt.

Rreth 58 për qind e të anketuarve mendojnë **se gjuha e urrejtjes mbizotëron në masë të madhe në vend.** Tek grupet e ndjeshme, më shumë se nëntë nga dhjetë të anketuar mendojnë se gjuha e urrejtjes është shumë e përhapur.

Programet më të zakonshme televizive që perceptohen se **përhapin gjuhë të urrejtjes** më shpesh, janë debatet politike (69%) dhe shfaqjet e realitetit (46%). Përgjigjet nga grupet e ndjeshme janë mjaft të ngjashme në lidhje me këtë pyetje. Më konkretisht, ata mendojnë se shfaqjet e realitetit, debatet e përgjithshme dhe debatet politike përkrahin përhapjen e gjuhës së urrejtjes gjerësisht. (73%, 67%, 56%) përkatësisht.

Nga të dhënat del se motivet më të zakonshme që ngacmojnë gjuhën e urrejtjes janë **Varfëria (54 %), Statusi social, opinioni politik dhe paraqitja fizike (44 %)**. Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se më shumë gra mendojnë se gjuha e urrejtjes nxitet nga paraqitja fizike, në krahasim me burrat që mendojnë se opinioni politik nxit më shumë përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Për dallim, përgjigjet e mësipërme janë mjaft të ndryshme tek mostra shtesë, të cilët mendojnë se etnia (50 %) dhe raca (44 %) janë dy motivet kryesore që nxisin gjuhën e urrejtjes. Rezultatet për LGBTIQ tregojnë se ata mendojnë në mënyrë specifike se homo-bi-lesbo-transfobia është motivi më i zakonshëm që nxit gjuhën e urrejtjes (68 %).

Akti i dëmtimit të reputacionit të mirë të dikujt perceptohet më së shumti si **formë e gjuhës së urrejtjes**, pasuar nga Nxitja e urrejtjes (69%) dhe sharjet ose fyerjet etnike (66%). Rezultatet nga mostra shtesë për grupet më të ndjeshme tregojnë se Sharjet etnike, Nxitja e urrejtjes dhe shakatë për pakicat etnike perceptohen kryesisht si forma të gjuhës së urrejtjes (përkatësisht 69 %, 69 % dhe 58 %).

**Ankthi dhe depresioni dhe dhimbja emocionale perceptohen si ndjenjat kryesore që përjeton një person i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes**, përkatësisht me mostrën totale prej 69 % dhe 66 %. Humbja e vetëbesimit perceptohet kryesisht nga të anketuarit e rinj në krahasim me më të moshuarit. Rezultatet janë të ngjashme me grupet më të ndjeshme që sërish mendojnë se ankthi, depresioni dhe humbja emocionale ka më shumë gjasa të përjetohen nga personi që shënjestrohet nga gjuha e urrejtjes.

---

<sup>54</sup> Nga Xheni Karaj



Rreth një në dhjetë mendon se **pandemia e COVID-19** e ka rritur përdorimin e gjuhës së urrejtjes në përgjithësi dhe rreth 13 % mendojnë se COVID-19 e ka rritur përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj individëve ose grupeve specifike. Rezultatet për mostrën shtesë tregojnë se gjysma e tyre nuk e dinë se si pandemia mund të ketë ndikuar mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes.

Media sociale, shkollat ose universitetet dhe vendet e punës (përkatesisht 64 %, 59 %, 54 %) mendohet të jenë **konteksti/mjedisi ku përdoret më së shumti gjuha e urrejtjes**. Rezultatet nga grupet e ndjeshme janë shumë të ngjashme me përjashtim të transportit që është kategori e përmendur nga grupet e ndjeshme në tri kontekstet kryesore ku përdoret gjuha e urrejtjes.

Të dhënat për përvojën me gjuhën e urrejtjes tregojnë se  **shumica e të anketuarve nuk i janë ekspozuar personalisht gjuhës së urrejtjes**, 61 %, dhe rreth 32 % kanë dëgjuar për të tjerë dhe 14 % e kanë përjetuar personalisht gjuhën e urrejtjes. Më shumë se gjysma e pjesëmarrësve, kur kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti të gjuhës së urrejtjes ndaj dikujt tjetër, kanë deklaruar se kanë ndërmarrë veprime, rreth 22 % nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim dhe rreth 19 % kanë dashur të bëjnë diçka, por nuk kanë ditur çfarë të bëjnë. Ngjashëm, **analiza e grupeve në nevojë** tregojnë rezultate të ndryshme. Më specifikisht, rreth 46 % e të anketuarve në mesin e grupeve në nevojë e kanë përjetuar personalisht gjuhën e urrejtjes dhe e njëjta përqindje kanë deklaruar se kanë dëgjuar për të tjerë që e kanë përjetuar. Rreth 62 % thonë se kanë ndërmarrë veprime kur kanë qenë dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes dhe vetëm 7 % nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Këto rezultate tregojnë se grupet në nevojë janë më aktive për të ndërmarrë veprime në rast se janë dëshmitarë të ndonjë situatë me gjuhë të urrejtjes në krahasim me popullatën e përgjithshme.

**Rreth 80 % e të anketuarve nuk i janë ekspozuar asnjëherë gjuhës së urrejtjes online** dhe rreth 11 % i janë ekspozuar disa herë. Rezultatet sipas grupmoshave tregojnë se të anketuarit e rinj kanë më shumë gjasa të përjetojnë gjuhë të urrejtjes online në krahasim me të anketuarit më të moshuar. Rezultatet për grupet në nevojë tregojnë se vetëm 21 % nuk i janë ekspozuar ndonjëherë gjuhës së urrejtjes online. Rreth 28 % e kanë përjetuar disa herë dhe 32 % kanë deklaruar se e kanë përjetuar shpesh. Kjo kategori është mjaft e lartë në mesin e grupit LGTBIQ sa që pothuajse gjysma e tyre deklarojnë se i janë ekspozuar gjuhës së urrejtjes online.


**Niveli i njohurive për ligjet që i mbrojnë njerëzit nga gjuha e urrejtjes duket se është në masë të mesatarisht i ulët**, me vetëm 8 % të të anketuarve që janë në dijeni të ligjeve të tilla dhe rreth 37 % kanë dëgjuar diçka, por nuk janë shumë mirë të informuar. Rezultati për grupet në nevojë tregon se kjo kategori ka nivel disi më të lartë të njohurive (19%) për ligjet që i mbrojnë njerëzit nga gjuha e urrejtjes.

**Familja dhe/ose miqtë janë kanalet kryesore për të kërkuar ndihmë në raste të gjuhës së urrejtjes** (55 %), pasuar nga mjeku dhe psikologu (25 %) dhe zyrtari policor (24 %). Rreth 11 % e të anketuarve kanë deklaruar se nuk do të shkonin të flisnin me askënd në rast se përjetojnë gjuhë të urrejtjes. Bazat mbizotëruese për këtë tendencë është se ata e pranojnë që askujt nuk i intereson (rreth 56 %), ose sepse askush nuk do t'i marrë seriozisht (21 %). Rezultatet për grupet në nevojë tregojnë se familja dhe miqtë janë kanalet kryesore ku kërkojnë ndihmë (33 %), por zgjedhja mbizotëruese në mesin e alternativave janë shoqatat e shoqërisë civile, 37 %, gjë që tregon se ky komunitet ka besim atje në rast se kanë nevojë për ndihmë. Rreth 10 % nuk do të kërkonin ndihmë për shkak të besimit të përhapur se askujt nuk i intereson (68 %) dhe për shkak se u vjen turp t'ua tregojnë përvojën e tyre të tjerëve (60 %).

## 2.2 Metodologjia e studimit

Sondazhi ka punuar me një mostër prej 1.500 të anketuarish nga të gjitha rajonet e Shqipërisë, pra përfaqësuese në nivel kombëtar. Intervistat u zhvilluan me dy metodologji: CATI (intervista telefonike me asistencë kompjuterike) dhe CAWI (intervista përmes internetit me asistencë kompjuterike), ndërmjet datave 14 janar deri 1 shkurt 2020. Më specifikisht, rreth 68 % e intervistave u zhvilluan me telefon dhe 32 % përmes internetit. Kohëzgjatja mesatare e intervistës ishte rreth 15 minuta. Përshkrimi i hollësishëm i këtyre metodologjive jepet në Shtojcën e këtij raporti. Sondazhi përfshiu edhe një mostër shtesë prej rreth 300 të anketuarish nga komunitetet LGTBIQ dhe romë/egjiptianë për të marrë informata të thelluara rreth gjuhës së urrejtjes specifikisht për këto grupe të shënjestruara.

Figura 1. Metodologjia për mbledhjen e të dhënave



## 2.2.1 Shpërndarja e mostrës

Popullata e shënjestruar për studimin përfshinte grupmoshën 18-64 vjeçare, që konsiderohet të jetë popullata e pranueshme për këtë sondazh. Shpërndarja e mostrës u bazua në të dhënat zyrtare për shifrat e përafërta të popullsisë për grupin e shënjestruar të pranueshëm. Në bazë të këtyre të dhënave zyrtare u projektua edhe numri i intervistave për secilin rajon dhe për secilin rajon u respektua edhe shpërndarja e urbanitetit.

Figura 2. Shpërndarja e mostrës për secilin rajon

	Përqindja	Numri
Berat	5%	82
Dibër	4%	59
Durrës	9%	135
Elbasan	10%	150
Fier	11%	165
Gjirokastrë	3%	46
Korçë	8%	120
Kukës	3%	49
Lezhë	5%	75
Shkodër	8%	120
Tiranë	28%	420
Vlorë	6%	90
Totali	100%	1511

Mostra e madhësisë prej 1500 intervistash mundëson studim përfaqësues me një margjinë të gabimit prej +/- 2.5, me 95% të intervalit të besimit.

## 2.2.2 Hartimi i instrumentit të sondazhit

Pyetësi i sondazhit përfundimtar përfshinte një seri prej rreth 20 pyetjesh të mbyllura (një kopje e pyetësit është në shtojcë të këtij raporti). Pyetjet ndiqnin renditje specifike, duke marrë së pari nivelin e njohurive rreth gjuhës së urrejtjes, pasuar nga pyetjet për perceptime të ndryshme që të anketuarit mund të kishin përjetuar në vend lidhur me këtë temë; pyetësi tjetër përfshiu disa pyetje për matjen e përvojës lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe në fund disa pyetje lidhur me nivelin e besimit në institucionet në vend për trajtimin e gjuhës së urrejtjes. Të dhënat janë analizuar në nivel kombëtar për secilën pyetje, si edhe sipas gjinisë, grupmoshës dhe zonës, për të kuptuar nëse ka ndryshime midis grupeve të ndryshme të popullatës, sa i përket temave specifike që trajton sondazhi (lista e plotë e tabelave është në shtojcë të këtij raporti), Të dhënat për mostrën shtesë janë analizuar sipas dy grupeve kryesore të ndryshme, specifikiisht LGBTI dhe romët/egjiptianët.

## 2.2.3 Përzgjedhja e pjesëmarrësve në sondazh

Pjesëmarrësit u përzgjedhën përmes Platformës CATI (intervista telefonike me asistencë kompjuterike) dhe metodologjisë CAWI. Në bazë të kuotave gjeografike të përcaktuara për sondazhin, operatorët bënë një kontroll të shpejtë para se të fillonin me intervistat e vërteta. Kjo siguroi gjenerimin totalisht rastësor të

numrave që u përdorën brenda kuotave të specifikuara për secilin rajon. Kontrolli është i rëndësishëm edhe për të kuptuar profilin e të anketuarit duke pasur parasysh parametrat demografikë si moshë, gjinia etj. (përshkrimi i platformës CATI dhe metodologjisë CAWI janë në shtojcë të këtij raporti). Pasi kuotat u kontrolluan dhe u verifikuan, atëherë filluan intervistat kryesore. Para se të fillonin, u kërkua pajtimi verbal nga të anketuarit. Operatorëve u duhej të deklaronin pjesëmarrjen vullnetare në sondazh dhe se nuk do të shpërndahej asnjë e dhënë në nivel individual, si edhe që i gjithë informacioni i dhënë gjatë intervistave do të përdorej vetëm për hir të analizimit të të dhënave.

## 2.2.4 Etika, Privatësia dhe konfidencialiteti

Gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave, operatorët e bënë të qartë se nuk kishte ndonjë shtytje të shprehur apo të nënkuptuar, në mënyrë që të anketuarit të mund të merrnin vendim të mirinformuar dhe të lirë për përfshirjen e tyre të mundshme në sondazh. Të anketuarit ishin në dijeni të natyrës vullnetare të përfshirjes së tyre dhe se mund të tërhiqeshin nga sondazhi në çfarëdo momenti, pa asnjë pasojë negative. Të gjithë pjesëmarrësit në studim u informuan se studimi po bëhej duke respektuar anonimitetin dhe se pjesëmarrja në sondazh ishte tërësisht vullnetare. Operatorët e bënë të qartë për pjesëmarrësit se përgjigjet e tyre do të interpretoheshin vetëm në formë kumulative dhe se nuk do të përdorej asnjë informacion personal dhe ky informacion nuk do t'i bëhej i ditur asnjë pale tjetër apo në materialet me shkrim. Duke qenë se të anketuarit në sondazh ndanë disa informata personale (p.sh., moshë, gjinia, numri i telefonit/adresa e postës elektronike) është përgjegjësi e ekipit të hulumtimit që të sigurojë se konfidencialiteti i tyre ruhet dhe se informacioni personal mbrohet. Kjo do të operacionalizohet duke u siguruar se të gjitha databazat janë të anonimizuara, në kuptimin që të gjitha të dhënat personale të të anketuarve hiqen para se të dhënat të ndahen publikisht.

## 2.2.5 Kufizimet e studimit

Për shkak të gjendjes së krijuar nga COVID-19, intervistat u zhvilluan përmes telefonit dhe internetit. Metodologjia CATI garanton përfitimet e njëjta si sy më sy dhe qasja online siguron shënjestër heterogjene dhe operatori i telefonatës mund ta ndihmojë të anketuarin gjatë intervistës. Mirëpo, qasja CATI ka disa kufizime që përshkruhen më poshtë: Shpesh, thirrjet telefonike perceptohen ndonjëherë si telemarketing dhe për rrjedhojë, priten negativisht nga të anketuarit. Në përgjithësi, vlerësohet se operatorëve u duhej të bënin mesatarisht dy telefonata për një intervistë të suksesshme. Kohëzgjatja e intervistës perceptohet si shqetësim në intervistat telefonike. Për shkak të mungesës së kontaktit direkt, i anketuari mund të kërkojë që pyetjet të përsëriten në mënyrë që ai/ajo ta marrë kuptimin e saktë.

## 2.3 Gjetjet kryesore

Kjo pjesë paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të gjetjeve të sondazhit për gjuhën e urrejtjes. Renditja e analizës nuk ndjek në mënyrë rigorozë renditjen e pyetësorit, por bazohet në një rrjedhë logjike të temave të ndryshme të përfshira në pyetësor.

Më konkretisht, analiza fillon me grupin demografik të të anketuarve; vazhdon me perceptimet rreth gjuhës së urrejtjes; seksioni tjetër ka të bëjë me përvojën lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe seksioni i fundit i kushtohet nivelit të ndërgjegjësimit lidhur me ligjet për trajtimin e gjuhës së urrejtjes dhe nivelit të besimit në institucionet në vend që duhet të merren me këto tema dhe çështje.

Për shkak të metodologjive të ndryshme, analiza ndahet në popullatën kombëtare, që bazohet në një përzgjedhje rastësore të të anketuarve dhe në mostrën shtesë të cilët u arritën përmes intervistave të shënjestruara.

### 2.3.1 Profili i popullatës së anketuar


Në total, pati 1,511 pjesëmarrës<sup>55</sup> në sondazh, të moshave ndërmjet 18-64 vjeç. Moshë mesatare e popullatës së hulumtuar ishte 39 vjeç dhe moshë mediane 37 vjeç.

Rreth 49 për qind e të anketuarve ishin meshkuj dhe 51 për qind femra dhe 4 të anketuar nuk preferuan ta deklarojnë gjininë.

---

<sup>55</sup> Pjesëmarrës këtu konsiderohen të anketuarit që kanë plotësuar të gjithë pyetësorin.

Figura 3. Të anketuarit sipas seksit



Rreth 57 për qind e të anketuarve jetonin në zonat urbane dhe 43 për qind në zonat rurale. Të dhënat sipas rajonit tregojnë se rreth 28 për qind e të anketuarve jetojnë në Tiranë, rreth 20 për qind në Veri, 19 për qind në Shqipërinë e Mesme dhe 33 për qind në Jug.<sup>56</sup>

Figura 4. Të anketuarit sipas urbanitetit






Figura 5. Të anketuarit sipas rajonit



Rreth 33 për qind e të rinjve të anketuar ishin ndërmjet 18-29 vjeçarë, që konsiderohet popullatë e re<sup>57</sup>. Rreth 39 për qind ishin të moshës 30 deri 49 vjeç dhe 28 për qind ishin në shkallën 50 deri 64 vjeç.

Figura 6. Të anketuarit sipas grupmoshës



Të dhënat për nivelin e shkollimit të përfunduar tregojnë se shumica e të anketuarve (36 %) janë me shkollë të mesme, 26 % kanë së paku diplomë universitare. Rreth katër nga dhjetë të anketuar janë të papunësuar dhe rreth gjashtë nga dhjetë janë të punësuar, ku shumica punojnë në sektorin privat.

<sup>56</sup> Jug: Berat Fier Gjirokastrë Korçë Vlorë; Veri: Dibër Kukës Lezhë, Shkodër Qendër: Durrës Elbasan

<sup>57</sup> Përkufizimi i rinisë sipas Eurostat.

Figura 7. Të anketuarit sipas nivelit arsimor






Figura 8. Të anketuarit sipas statusit të punësimit



Instrumenti i të dhënave përfshinte edhe një pyetje për fenë. Të dhënat tregojnë se më shumë se gjysma e të anketuarve deklaruan se ishin të besimit islam (53%), Bektashi rreth (14%), katolikë rreth 10% dhe ortodoksë rreth 9%. Një nga dhjetë deklaronte se nuk kishte orientim fetar.


Figura 9. Të anketuarit sipas fesë



### 2.3.2 Profili i mostrës shtesë


Në përputhje me mostrën kryesore prej 1511 pjesëmarrësish, u intervistua edhe një mostër shtesë prej 301 vetësh. Ideja kryesore pas kësaj teknike qëndron në faktin se pjesëmarrësit e këtij grupi janë më së shumti të ekspozuar ndaj dukurisë së gjuhës së urrejtjes. Pavarësisht avancimit të Shqipërisë drejt ligjeve që rregullojnë çështje sociale, ende mbizotëron tendenca për të diskriminuar ndaj atyre njerëzve, ndaj mund të etiketohen si pjesë e një komuniteti në rrezik. Kjo nënmostër përbëhet nga 47% femra, 48% meshkuj, 5% preferojnë të mos e përshkruajnë veten (shumica janë jobinarë).

Figura 10. Shpërndarja e mostrës sipas seksit




la vlen të përmendet se segmentimi ndërmjet komunitetit LGBTIQ dhe atij romë/egjiptianë ka proporcione 53% dhe 47% përkatësisht.

Figura 11. Shpërndarja e mostrës shtesë sipas vulnerabiliteti




Në mesin e pjesëmarrësve në sondazhin me mostrën shtesë, rreth 53% janë ndërmjet 18-29 vjeç dhe rreth 47% janë ndërmjet 30 deri 49 vjeç.

Figura 12. Shpërndarja e mostrës sipas grupmoshës




Të dhënat sipas nivelit arsimor kryesisht kanë të bëjnë me njerëz me diplomë universitare, 22% e tyre kanë diplomë të nivelit të parë, 13% pretendojnë se kanë diplomë pasuniversitare (master, Ph.D.), ndërsa 29% e rezultateve tregojnë se kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ciklit të dytë. Pjesa tjetër e mbetur e popullatës pohon se ka një cikël të parë të shkollimit të mesëm, rreth 17% dhe pjesa tjetër 18% nuk ka shkollim.

Figura 13. Shpërndarja e mostrës shtesë sipas nivelit arsimor




Nga kategorizimi i të dhënave sipas vendit të punës 46% rezultojnë të jenë të papunësuar dhe 33% punojnë në sektorin privat, mirëpo 46% nuk është befues, pasi mostra përbëhet kryesisht nga një pjesë relativisht në nevojë dhe e diskriminuar. Një pakicë prej tyre ose punojnë në sektorin publik, ose janë të vetëpunësuar, ndërsa një pjesë e papërfillshme prej vetëm 4% janë në pension.

Figura 14. Shpërndarja e mostrës shtesë sipas nivelit të statusit të punësimit



Në mesin e pyetjeve të formuluar në mënyrë të posaçme, është përfshirë dhe një tjetër variabël i indikatorit të fesë, duke pasur parasysh se feja është masë e rëndësishme që formëson sjelljet e njerëzve. Megjithatë, është interesante të vëresh se 51% e të anketuarve i përkasin besimit islam. Rreth 21% e pjesëmarrësve pretendojnë se nuk kanë fe dhe pjesa e mbetur përfshijnë ortodoksë, katolikë, Bektashi dhe një grup i vogël që nuk preferon të tregojë.

Figura 15. Shpërndarja e mostrës shtesë sipas fesë




### 2.3.3 Njohuritë për “gjuhën e urrejtjes”

Vlerësimi i njohurive për atë që nënkupton ‘gjuha e urrejtjes’ është matur përmes një sërë pyetjesh si: Si hap i parë, të anketuarit duhet të përgjigjen nëse e dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes, pa ndonjë udhëzim apo ndihmë. Si hap i dytë, atyre që u përgjigjën se nuk e dinin çfarë është gjuha e urrejtjes, iu bë një pyetje e dytë, nëse e dinin se çfarë është gjuha fyese/diskriminuese. Në rast se e dinin, pyetësi vazhdoi me një pyetje të hapur ‘Çfarë nënkuptoni me termin ‘gjuhë e urrejtjes’? Të dhënat tregojnë se rreth gjashtë nga dhjetë të anketuar e dinin se çfarë ishte gjuha e urrejtjes. Rreth 3 nga dhjetë thonë se nuk e dinin, por ata e dinin se çfarë është gjuha diskriminuese ose fyese. Rreth 6% e të anketuarve të intervistuar u përgjigjën se nuk e dinin se çfarë është gjuha e urrejtjes ose gjuha fyese/diskriminuese, nga të cilët rreth 56 % ishin femra dhe 44 % ishin meshkuj. Kështu, mund të arrijmë në përfundimin se rreth 94 % e të anketuarve e dinin se çfarë është gjuha e urrejtjes/diskriminuese/fyese dhe 6 % nuk dinë për gjuhën e urrejtjes.<sup>58</sup>


<sup>58</sup> Analiza e të dhënave për tema të tjera në raport i referohet vetëm 1511 të anketuarve që ishin në dijeni të gjuhës së urrejtjes (që përbëjnë 94 % të personave të kontaktuar).

Figura 16. A e dini se çfarë është gjuha e urrejtjes?



Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se në mesin e të anketuarve **që nuk e dinin** se çfarë është gjuha e urrejtjes, 56 % ishin femra dhe 44 % meshkuj. Moshja duket të ketë më shumë rëndësi kur flasim për nivelin e njohurive për gjuhën e urrejtjes. Të anketuarit e rinj duket se kanë më pak njohuri për gjuhën e urrejtjes, përkatësisht 59 % e të anketuarve që nuk kanë njohuri për gjuhën e urrejtjes ishin të rinj dhe vetëm 4 % ishin të anketuar nga një grupmoshë më e madhe, 50-64 vjeç.

Figura 17. Struktura moshore e të anketuarve që nuk e dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes/diskriminuese/fyese



Studimi përfshinte një pyetje të hapur për të kuptuar në mënyrë më specifike se çfarë nënkuptonin të anketuarit me termin 'gjuhë e urrejtjes'. Qëllimi i kësaj pyetjeje ishte të mateshin njohuritë se çfarë nënkupton termi 'gjuha e urrejtjes' dhe për të kuptuar nëse të anketuarit e asocionin atë me terma të tjerë. **Shumica, rreth 40 për qind e kuptonin gjuhën e urrejtjes si fyerje e personave të tjerë.** Rreth 20 për qind e identifikonin si të urreje dikë. Për rreth 10 për qind 'gjuha e urrejtjes' përfshinte diskriminimin, denigrimin për shkak të bazave racore. Tabela më poshtë identifikon kategoritë më të identifikuara të asociuara me gjuhën e urrejtjes.



Tabela 1. Kategoritë kryesore për pyetjen se çfarë është gjuha e urrejtjes


Kategoria	Përqindja
Të fyesh	40%
Të urresh dikë	20%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza racore	10%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza fetare	10%
Diskriminimi	10%
Përbuzja	7%
Bullizmi	6%
Të flasësh keq për dikë	4%
Zemërim ndaj dikujt/zili	4%
Urrejtje për shkak të paraqitjes	4%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi për shkak të statusit ekonomik	4%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza etnike	4%
Nacionalizmi	3%
Paragjykimet	2%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza gjinore	2%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza seksuale	2%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza politike	2%
Dhuna verbale	2%
Ksenofobia	1%
Abuzimi	1%
Terma të tjerë	9%

### 2.3.4 Njohuritë për gjuhën e urrejtjes nga mostra shtesë

Brenda nënmostrës së atyre personave që quhen se janë të rrezikuar sa i përket ekspozimit ndaj gjuhës së urrejtjes, u përdor e njëjta metodë për të matur njohuritë për gjuhën e urrejtjes. Kështu, pyetja se çfarë është gjuha e urrejtjes për ta u bë e para dhe më pas pyetësori vijoi me pyetjet përkatëse. Doli se 50% e tyre e dinin se ç'do të thotë gjuhë e urrejtjes, 34% e tyre nuk e dinin se çfarë është gjuha e urrejtjes, por e dinin se çfarë është gjuha diskriminuese ose fyese dhe 16% as nuk e dinin çfarë është gjuha e urrejtjes, as gjuha diskriminuese ose fyese.<sup>59</sup>


<sup>59</sup>Në total 49 të anketuar nuk e dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes ose diskriminuese/fyese, prandaj pyetjet do të vazhdojnë vetëm për ata që dinë për të, me fjalë të tjera, tani mostra u reduktua në 252 pjesëmarrës.

Figura 18. Niveli i njohurisë për gjuhën e urrejtjes për mostrën shtesë



Në mesin e 16% të të anketuarve që nuk e dinin se çfarë është gjuha e urrejtjes/diskriminuese ose gjuha fyese, 28% janë nga komuniteti rom dhe egjiptian dhe 44% LGBTIQ. Sipas grupmoshës, shpërndarja është për 18-29 vjeçarë, 25% pretendojnë se nuk e dinë çfarë është gjuha e urrejtjes, ndërsa 38% e tyre janë brenda 30-64 vjeç.

Figura 19. Struktura moshore e të anketuarve të mostrës shtesë që nuk e dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes/diskriminuese/fyese



Atyre që u përgjigjën me po në pjesën e parë iu drejtua një pyetje e hapur dhe ajo përbëhet nga disa kategori kryesore për të matur shkallën e saktësisë së përkufizimit të gjuhës së urrejtjes. Shumica prej tyre, 44% duket se e asociojnë termin gjuhë e urrejtjes me fyerjen, ndërsa 18% e kanë identifikuar me urrejtje, diskriminim, denigrim mbi baza racore, 15% me diskriminim dhe 12% urrejtje për shkak të paraqitjes. Pjesa tjetër e të anketuarve e lidhin gjuhën e urrejtjes me përbuzjen, urrejtjen e bazuar në etni, urrejtjen ndaj dikujt, urrejtjen mbi baza seksuale, etj., (shih fig.21).


Figura 20. Çfarë do të thotë gjuha e urrejtjes për të anketuarit nga mostra shtesë që u përgjigjën me po

Kategoria	Përqindja
Të fyesh/të vësh epitete	44%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza racore	18%
Diskriminimi	15%
Urrejtje për shkak të paraqitjes	12%
Përbuzja	8%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza etnike	8%
Të urresh dikë	7%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza seksuale	6%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza fetare	5%
Dhuna verbale	5%
Bullizmi	4%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi për shkak të statusit ekonomik	3%
Paragjykimet	2%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza gjinore	2%
Abuzimi	2%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi për shkak të statusit shoqëror	1%
Zemërim ndaj dikujt/zili	1%
Nacionalizmi	1%
Të flasësh keq për dikë	0%
Ksenofobia	0%
Urrejtja, diskriminimi, denigrimi mbi baza politike	0%
Injoranca	0%
Tjetër	9%

### 2.3.5 Perceptimet për gjuhën e urrejtjes


Të anketuarit u pyetën për mendimin e tyre se deri në ç'masë mendojnë se është e përhapur në vend gjuha e urrejtjes. Të dhënat tregojnë se 21 % mendojnë që gjuha e urrejtjes është e përhapur në masë të vogël në vend, rreth 18 për qind mendojnë se është e përhapur në masë të moderuar dhe 58 për qind mendojnë se është e përhapur në masë të madhe ose shumë të madhe. Rreth 3 për qind nuk kanë ide se sa e përhapur është në vend gjuha e urrejtjes.

Figura 21. Sipas mendimit tuaj, deri në ç'masë është e përhapur gjuha e urrejtjes në Shqipëri?




**Perceptimet për nivelin e përhapjes së gjuhës së urrejtjes në Shqipëri tregojnë dallime ndërmjet gjinive.** Niveli i perceptimit se sa e përhapur është gjuha e urrejtjes sipas gjinisë tregon se rreth 67 % e grave mendojnë se gjuha e urrejtjes është e përhapur në masë të madhe ose shumë të madhe në vend, kundrejt 49 % të burrave. Rreth një në tre burra mendojnë se gjuha e urrejtjes është e përhapur në masë të vogël ose deri diku dhe vetëm një nga dhjetë gra e mendon këtë.

Figura 22. Sipas mendimit tuaj, deri në ç'masë është e përhapur gjuha e urrejtjes në Shqipëri, sipas seksit




Të dhënat sipas grupmoshës tregojnë se të **anketuarit e rinj mendojnë më shumë që gjuha e urrejtjes është e përhapur në vend në masë të madhe në krahasim me grupmosha të tjera.**

Figura 23. Sipas mendimit tuaj, deri në ç'masë është e përhapur gjuha e urrejtjes në Shqipëri, sipas grupmoshës




Për më tepër, të anketuarit u pyetën se sipas mendimit të tyre, cilat programe televizive i kontribuojnë përhapjes së gjuhës së urrejtjes. Rreth shtatë nga dhjetë mendojnë se janë debatet politike ato që i kontribuojnë përhapjes së gjuhës së urrejtjes. Programi i dytë televiziv që perceptohet se i kontribuon përhapjes së gjuhës së urrejtjes janë shfaqet e realitetit, përkatësisht nga 46 % e të anketuarve. Rreth katër nga dhjetë mendojnë se në përgjithësi, të gjitha llojet e debateve i kontribuojnë përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Figura 24. Sipas mendimit tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin gjuhën e urrejtjes tek audiencat e tyre?



Grupmosha të ndryshme mendojnë ndryshe sa i përket se çfarë kontribuon më shumë në përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Të anketuarit e rinj mendojnë se shfaqjet e realitetit janë programet televizive që i kontribuojnë më së shumti përdorimit të gjuhës së urrejtjes, 66 % e tyre në krahasim me vetëm 25 % për 50-64 vjeçarët. Nga ana tjetër, grupmoshat më të vjetra perceptojnë se programet politike i kontribuojnë më shumë përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, edhe lajmet e mbremjes perceptohen nga grupmoshat më të vjetra se përhapin gjuhën e urrejtjes.


Figura 25. Sipas mendimit tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin gjuhën e urrejtjes tek audiencat e tyre? Sipas grupmoshave



Të anketuarit u pyetën se ç'mendonin, cili ishte motivi më i zakonshëm që nxit përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Ata mund të zgjidhnin më shumë se një alternativë për të deklaruar të gjitha motivet që ishin relevante për ta. Të dhënat tregojnë se më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se varfëria ose të qenit pa strehë

nxit përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Rreth katër në dhjetë të anketuar mendojnë se statusi social, opinioni politik, ose paraqitja fizike janë motive për gjuhë të urrejtjes.

Figura 26. Sipas mendimit tuaj, cili është motivi më i zakonshëm që nxit gjuhën e urrejtjes




Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se varfëria perceptohet se nxit gjuhën e urrejtjes vetëm pak më shumë nga burrat në krahasim me gratë. Nga ana tjetër, opinioni politik perceptohet nga burrat si motivi i dytë më i zakonshëm që shkakton gjuhë të urrejtjes. Për gratë, paraqitja fizike duket të jetë motivi i dytë i gjuhës së urrejtjes.

Figura 27. Tre motivet kryesore më të zakonshme të perceptuara për gjuhën e urrejtjes, sipas gjinisë




Të dhënat tregojnë se grupmosha të ndryshme shfaqin mendime të ndryshme se çfarë e nxit gjuhën e urrejtjes. Të anketuarit e rinj mendojnë se fobia ose frika nga komuniteti LGBT është shkak më i zakonshëm që nxit gjuhën e urrejtjes. Frika nga grate perceptohet më shumë nga grupmoshat më të vjetra (50-64 vjeç) si motiv për gjuhën e urrejtjes në krahasim me grupmosha të tjera.

Figura 28. Sipas mendimit tuaj, cili është motivi më i zakonshëm që nxit gjuhën e urrejtjes, sipas grupmoshave




Të pyetur për format e shprehjes që mund të etiketohen ose identifikohen si gjuhë e urrejtjes, rreth 76 % e të anketuarve mendojnë se akti i dëmtimit të reputacionit të dikujt mund të etiketohet si gjuhë e urrejtjes. Nxitja për urrejtje perceptohet si formë e gjuhës së urrejtjes nga 69 % e të anketuarve dhe 66 % i perceptojnë fyerjet me baza etnike si forma të gjuhës së urrejtjes. Rezultatet sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të konsiderueshme në perceptimin ndërmjet grave dhe burrave rreth formave të shprehjes së gjuhës së urrejtjes.

Figura 29. Sipas mendimit tuaj, cilat nga format në vijim të shprehjes mund të etiketohen si gjuhë e urrejtjes?



Rezultatet sipas gruomoshave tregojnë se shpifja perceptohet si formë e gjuhës së urrejtjes nga një përqindje shumë e lartë tek grupmoshat më të mëdha (50-64 vjeç). Stereotipet për LGBTQ perceptohen nga më të rinjtë si formë e shprehjes së gjuhës së urrejtjes.


Figura 30. Sipas mendimit tuaj, cilat nga format në vijim të shprehjes mund të etiketohen si gjuhë e urrejtjes, sipas grupmoshës



Të anketuarit u pyetën më tej për mendimin e tyre se çfarë mund të përjetojë një person apo grup i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes për shkak të përdorimit të kësaj gjuhe ndaj tyre. Rreth 69 % e të anketuarve mendojnë se një person/grup i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes mund të përjetojë ankth ose depresion; 66 % mendojnë se përjetojnë dhimbje emocionale; 61 % mendojnë se përjetojnë humbje të vetëbesimit; rreth gjysma e të anketuarve mendojnë se këta njerëz mund të përjetojnë turp, pasiguri, humbje të besimit tek të tjerët. Vetëm 2 % mendojnë se gjuha e urrejtjes nuk është e dëmshme dhe se janë vetëm fjalë. Kjo tregon sa i lartë është niveli i empatisë së të anketuarve ndaj personave apo grupeve që janë shënjestruar nga gjuha e urrejtjes.




Figura 31. Cilën nga pikat në vijim ka gjasa të përjetojë një person/grup i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes:




Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se gratë kanë përqindje më të lartë në mesin e të gjitha kategorive të ndjenjave që një person apo grup i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes mund të përjetojë. Kjo mund të tregojë se gratë mendojnë më shumë se sa burrat se çfarë vuajnë personat e shënjestruar nga gjuha e urrejtjes.

Figura 32. Cilën nga pikat në vijim ka gjasa të përjetojë një person/grup i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes, sipas seksit



Rezultatet sipas grupmoshave tregojnë se humbja e besimit për shkak të gjuhës së urrejtjes perceptohet më shumë nga të anketuarit e rinj, përkatësisht 69 % e personave 18-29 vjeçarë. Paretat fizike perceptohet më shumë nga grupmoshat më të mëdha 50-64 vjeçarë, në krahasim me grupmoshat e tjera, përkatësisht 48 %.

Figura 33. Cilën nga pikat në vijim ka gjasa të përjetojë një person/grup i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes, sipas grupmoshës



Në kohën e pandemisë së Covid-19, sondazhi përfshiu edhe një pyetje të dedikuar për të matur opinionin nëse pandemia perceptohej të kishte ndikuar mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Rreth 45 % mendojnë se pandemia ka ndikuar tek rritja e gjuhës së urrejtjes, përkatësisht 32 % mendojnë se gjuha e urrejtjes është rritur në përgjithësi dhe 13 % mendojnë se është rritur ndaj individëve ose grupeve specifike. Rreth 11% mendojnë se përhapja e gjuhës së urrejtjes është ulur si rezultat i Covid-19 dhe 29 % mendojnë se pandemia nuk ka pasur ndikim mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Rreth 15 % nuk mund të thonë ose nuk kanë asnjë ide për ndikimin e Covid-19 mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes.


Figura 34. Sipas mendimit tuaj, deri në ç'masë ka ndikuar epidemia e Covid-19 në qarkullimin e gjuhës së urrejtjes?



Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se më shumë gra mendojnë se pandemia e ka rritur nivelin e gjuhës së urrejtjes ndaj individëve apo grupeve specifike, përkatësisht 15 % gra kundrejt 11 % burra. Nga ana tjetër, më


shumë burra mendojnë se pandemia nuk ka pasur ndikim mbi përdorimin e gjuhës së urrejtjes, përkatësisht 32 % burra kundrejt 26 % gra.

Figura 35. Sipas mendimit tuaj, deri në ç' masë ka ndikuar epidemia e Covid-19 në qarkullimin e gjuhës së urrejtjes? Sipas seksit




Të anketuarit u pyetën se në cilin kontekst mendojnë se gjuha e urrejtjes përjetohet më së shumti në vend. Ata mund të zgjidhnin të gjitha kontekstet që mendonin se vlejnë. Sipas mendimit të tyre, rreth 64 për qind e të anketuarve mendojnë se media sociale është një kontekst ku gjuha e urrejtjes përjetohet më së shumti. Rreth gjashtë nga dhjetë mendojnë se shkollat ose universitetet janë një kontekst ku njerëzit mund të përjetojnë gjuhë të urrejtjes. Më shumë se gjysma mendojnë se vendet e punës janë një tjetër kontekst ku njerëzit mund të përjetojnë gjuhën e urrejtjes. Mjediset sportive dhe platformat për komunikim direkt, si Zoom, perceptohen më së paku si kontekst ku përjetohet gjuha e urrejtjes, përkatësisht me 19 % dhe 13 % të të anketuarve.

Figura 36. Ku/në cilin kontekst përjetohet më së shumti në Shqipëri gjuha e urrejtjes?




Ka disa dallime sipas gjinisë sa i përket perceptimit të konteksteve ku mund të përjetohet gjuha e urrejtjes. Media sociale dhe shkollat/universitetet perceptohen më shumë nga gratë se sa burrat në favor të përdorimit të gjuhës së urrejtjes. **Kjo mund të jetë masë indirekte e mirë që gratë mund ta përjetojnë gjuhën e urrejtjes më shumë se burrat në media sociale ose shkolla/universitete në këto kontekste.** Nga ana tjetër, burrat mendojnë se ligjërimi politik shkakton më shumë gjuhë të urrejtjes, përkatësisht 48 % e burrave në krahasim me 36 % të grave.

Figura 37. Ku/në cilin kontekst përjetohet më së shumti në Shqipëri gjuha e urrejtjes? Sipas seksit



Rezultatet sipas grupmoshave tregojnë se grupmosha të ndryshme perceptojnë kontekste të ndryshme ku mund të përjetohet gjuha e urrejtjes. Media sociale dhe shkollat/universitetet perceptohen më shumë nga grupmoshat më të reja në krahasim me grupmoshat më të vjetra; 50-64 vjeçarët. Për grupmoshat më të vjetra, ligjërimet politike dhe media si TV, radio perceptohen më shumë se shfaqin gjuhë të urrejtjes. Edhe vendet e punës shfaqin dallime sipas grupmoshave, ku grupmoshat më të vjetra i perceptojnë më shumë si vende ku mund të përjetohet gjuha e urrejtjes.


Figura 38. Ku/në cilin kontekst përjetohet më së shumti në Shqipëri gjuha e urrejtjes? Sipas grupmoshave



### 2.3.6 Perceptimet për gjuhën e urrejtjes sipas mostrës shtesë


Grupet e ndjeshme u pyetën në të njëjtën mënyrë për perceptimet, ashtu si popullata në mbarë vendin. Të dhënat për shkallën në të cilën gjuha e urrejtjes është e përhapur në Shqipëri tregojnë se në total 63% e mostrës shtesë mendojnë se gjuha e urrejtjes është e përhapur në masë shumë të madhe, përkatësisht 90% nga LGBTIQ dhe 38% romë dhe egjiptianë, ndërsa 16% në total mendojnë se gjuha e urrejtjes është e përhapur në masë të moderuar, ku 5% janë pjesë e LGBTIQ dhe 27% romë dhe egjiptianë. Pavarësisht përqindjeve të mësipërme, ende është një 13% në total që mendon se gjuha e urrejtjes është e përhapur deri diku, 24% romë dhe egjiptianë, shumica kryesisht për shkak të nivelit të ulët të arsimimit të komunitetit të tyre që mund t'i kontribuojë njohurive më të sakta për të dalluar këtë dukuri.

Figura 39. Sipas jush, deri në ç'masë është e përhapur në Shqipëri gjuha e urrejtjes? Mostra shtesë



Kur u pyetën për mënyrat e komunikimit lidhur me përhapjen e gjuhës së urrejtjes, të dhënat tregojnë se në total 73% mendojnë se gjuha e urrejtjes përhapet nëpërmjet shfaqjeve të realitet, përkatësisht 73% janë pjesë e LGBTIQ dhe 83% romë dhe egjiptianë. Gati 67% besojnë se gjuha e urrejtjes përhapet nga programet e zakonshme prej të cilëve 67% janë pjesë e LGBTIQ dhe 56% romë dhe egjiptianë. Një tjetër instrument me rëndësi për përhapjen e gjuhës së urrejtjes janë debatet politike, 56% e personave që mendojnë se debatet politike përhapin gjuhë të urrejtjes janë LGBTIQ dhe 31% romë dhe egjiptianë. Lista përmes së cilës mund të përhapet gjuha e urrejtjes sipas tyre përfshin programe të pasdites, programe të mbrëmjes, telenovela, filma, reklama etj. Sikurse pritet, komuniteti rom dhe egjiptian duket se kanë një pjesë më të zbutur kur krahasojnë kanalet e ndryshme nëpërmjet të cilëve mund të përhapet gjuha e urrejtjes, me përjashtim për shfaqjet e realitetit dhe ato të përgjithshme, prandaj mund të arrijmë në përfundimin se për këtë kategori, pothuajse të gjitha mjetet e komunikimit mund të nxisin gjuhë të urrejtjes.


Figura 40. Cilat programe televizive kanë më shumë gjasa të përhapin gjuhë të urrejtjes, mostra shtesë



Për më tepër, pjesëmarrësit u pyetën për ngacmimet më të zakonshme që nxisin gjuhën e urrejtjes. Arsyeja themelore prapa kësaj pyetjeje është shumë intuitive, për të marrë sa më shumë informacion që është e mundur kur është fjala për të dalluar gjuhën e urrejtjes.


Rreth 50% e të anketuarve duket se besojnë që gjuha e urrejtjes kryesisht nxitet nga etnia (sidomos kundër minoriteteve etnike), ku 41% janë nga LGBTIQ dhe 59% janë romë dhe egjiptianë. Mirëpo, përqindja më e lartë ku komuniteti LGBTIQ mendon se nis gjuha e urrejtjes është 68% që mendojnë se gjuha e urrejtjes nxitet përmes homo-bi-lesbo-transfobisë (frika/fobia nga komuniteti LGBT), ndërkohë që 59% e romëve dhe egjiptianëve mendojnë se gjuha e urrejtjes nxitet nga raca, prandaj ata kanë mendimin e përbashkët se dy arsyet kryesore që përkojnë me gjuhën e urrejtjes janë raca dhe etnia. Edhe paraqitje fizike ka tjetër rol me rëndësi kur përcaktojnë se çfarë e nxit gjuhën e urrejtjes, pasi 44% e LGBTIQ dhe 34% e romëve dhe egjiptianëve kanë mendimin se gjuha e urrejtjes nxitet nga kjo karakteristikë. Përcaktues të tjerë që nxisin gjuhën e urrejtjes janë statusi social dhe varfëria, që arrijnë në rreth 30-35% të mostrës shtesë që besojnë se këto të dy janë përbërës me rëndësi. Nuk është befasues fakti se 40% e komunitetit LGBTIQ beson se gjuha e urrejtjes nxitet nga misogjinia. Motive të tjera të rëndësishme që shkaktojnë gjuhë të urrejtjes janë aftësia e kufizuar, orientimi politik, kombësia, feja, ksenofobia etj.

Figura 41. Cili është motivi më i zakonshëm që nxit gjuhën e urrejtjes? Mostra shtesë



Një tjetër pyetje me rëndësi ka të bëjë me format e shprehjes që mund të etiketohen si gjuhë e urrejtjes, ku përqindja më e lartë, 69% në total mendon se fyerjet etnike etiketohen si gjuhë e urrejtjes, përkatësisht 60% janë LGBTIQ dhe 79% romë dhe egjiptianë. Edhe pse një numër shumë i madh i LGBTIQ, 85% besojnë se stereotipet për njerëzit LGBTIQ përbëjnë etiketim të rëndë të gjuhës së urrejtjes. Etiketa të tjera që u shfaqën janë paralelisht me rëndësi brenda komunitetit LGBTIQ, ku 64%-68% besojnë se sulmet verbale, fyerjet etnike, nxitja për urrejtje, kërcënimet, shakatë për gra, shakatë për persona me aftësi të kufizuara, fyerja për trupin dhe shpifja janë ndër to. Shkalla deri ku këto etiketa përbëjnë problem të rëndë në gjuhën e urrejtjes ndryshon për romët dhe egjiptianët, shumica e të cilëve mendojnë se fyerjet etnike përbëjnë pjesën më të madhe, për të vazhduar me shaka për pakicat etnike (rreth 63%) dhe nxitja për urrejtje (rreth 62%).


Figura 42. Cilat nga format e shprehjes më poshtë mund të etiketohet si gjuhë e urrejtjes? Mostra shtesë



Pasi një individ i caktuar shënjestrohet nga çështje sociale kërcënuese, ai/ajo ka të ngjarë të përjetojë ndjenja negative, prandaj një pyetje u hartua posaçërisht për t'i pyetur pjesëmarrësit e nënmostrës. Rezultatet tregojnë se 76% nga komuniteti LGBTIQ janë përgjigjur se kanë ndjerë ankth dhe depresion kur janë përballur me gjuhë të urrejtjes, ndërsa 35% e komunitetit rom dhe egjiptian u përgjigjën se kishin ndjerë të njëjtën gjë, kështu që ekziston një ndryshim i madh midis këtyre dy komuniteteve kur është fjala për përjetimin e gjuhës së urrejtjes.

Ngjashëm, LGBTIQ duket se përjetojnë dhimbje emocionale, humbje të vetëbesimit ose të besimit tek të tjerët, parehati fizike, ndjesi të kërcënimit ndaj vetes, stres posttraumatik, një ndjesi të përgjithshme të pasigurisë etj., më shumë se sa komuniteti rom dhe egjiptian. Edhe pse të dyja grupet, LGBTIQ dhe romë e egjiptianë duket se përjetojnë rëndë urrejtjen e përbashkët ndaj personit që i ka sulmuar. Ajo që bie në sy tek komuniteti rom dhe egjiptian është fakti se ata janë më të prirur të hakmerren se sa LGBTIQ, pra kjo është e vetmja ndjenjë ku romët dhe egjiptianët duket se kanë përjetime më të thella në krahasim me LGBTIQ. Megjithatë, në total, përqindjet janë shumë të larta për shumicën e ndjenjave që përjetojnë kur përballen me gjuhën e urrejtjes, për shembull në total 55% kanë gjasa të përjetojnë ankth dhe depresion, 54% dhimbje emocionale, 51% urrejtje ndaj personit që i ka sulmuar, 45% humbje të vetëbesimit, 44% humbje të besimit tek të tjerët e kështu me radhë, ndaj mund të arrijmë në përfundimin se kjo pjesë e shoqërisë shqetësohet edhe më shumë kur u cenohet dinjiteti i tyre.


Figura 43. Cilat nga pikat në vijim ka më shumë gjasa të përjetojë personi/grupi i shënjestruar nga gjuha e urrejtjes?



Duke pasur parasysh se pandemia e Covid-19 është direkt e ndërlidhur me shumë aspekte shoqërore, kemi një pyetje ekskluzive nëse pandemia ndikon tek qarkullimi i gjuhës së urrejtjes. Rezultatet tregojnë se 51% e nënmostrës nuk e dinë nëse pandemia ndikon apo jo tek përhapja e gjuhës së urrejtjes, mirëpo 70% e tyre janë pjesë e komunitetit rom dhe egjiptian (komuniteti i tyre ka më shumë gjasa të dijë më pak për zhvillimet më të fundit).




Figura 44. Deri në ç'masë ka ndikuar pandemia e Covid-19 tek qarkullimi i gjuhës së urrejtjes?



Sigurisht, ka dallime ndërmjet vendndodhjes se ku përfetohet gjuha e urrejtjes. Për komunitetin LGBTIQ, media sociale dhe institucionet arsimore (shkolla, universiteti) duket se zënë vendet më të rëndësishme, me 77% dhe 76% përkatësisht. Nga ana tjetër, gjendja për romët dhe egjiptianët duket të jetë mjaft e ndryshme, ku 69% e tyre duket se e përfetojnë gjuhën e urrejtjes në zyra publike, 68% në transportin publik dhe 62% në sektorin e shëndetësisë. Çuditërisht, kjo kategori duket se përballet me çështje kritike të gjuhës së urrejtjes në vende publike, ku supozohet se ata që janë në rrezik nga gjuha publike duhet të mbrohen nga autoritetet. Vende të tjera ku këto grupe përballet me gjuhën e urrejtjes janë vendi i punës, biseda private, media e popullarizuar dhe ligjërimi politik.

Figura 45. Ku/në cilin kontekst përfetohet më së shumti në Shqipëri gjuha e urrejtjes? Mostra shtesë




### 2.3.7 Përvoja me gjuhën e urrejtjes

Seksioni në vijim me pyetjet e sondazhit iu kushtua përvojave të të anketuarve lidhur me gjuhën e urrejtjes. Pas analizimit të perceptimeve dhe njohurive të tyre, sondazhi tenton të shpjegojë si janë përvojat në vend lidhur me këtë dukuri.


Të anketuarit u pyetën nëse rishtazi kishin dëgjuar apo ishin ekspozuar personalisht apo kishin dëgjuar për të tjerë lidhur me gjuhën e urrejtjes. Rezultatet tregojnë se shumica, rreth 64%, asnjëherë nuk i ishin ekspozuar personalisht gjuhës së urrejtjes, as nuk kishin dëgjuar për të tjerë pranë tyre që t'i ishin ekspozuar. Rreth një në tre kishin dëgjuar që njerëz pranë tyre i ishin ekspozuar gjuhës së urrejtjes dhe rreth 14 %.

Figura 46. A keni dëgjuar rishtazi ose a i jeni ekspozuar personalisht ju apo të tjerë gjuhës së urrejtjes?




Rezultatet sipas seksit tregojnë se burrat kanë më pak gjasa t’i ekspozohen apo të dëgjojnë se të tjerë i janë ekspozuar gjuhës së urrejtjes. Nga ana tjetër, gratë kanë më shumë gjasa të kenë dëgjuar për të tjerë që i janë ekspozuar gjuhës së urrejtjes.

Figura 47. A keni dëgjuar rishtazi ose a i jeni ekspozuar personalisht ju apo të tjerë gjuhës së urrejtjes? Sipas gjinisë




Rezultatet sipas grupmoshave tregojnë se të rinjtë kanë më shumë gjasa t’i ekspozohen gjuhës së urrejtjes, sidomos kur flasim për njerëz të tjerë. Rreth katër nga dhjetë të anketuar të rinj kanë dëgjuar për të tjerë që i janë ekspozuar gjuhës së urrejtjes, në krahasim me dy nga dhjetë nga grupmoshat më të vjetra.

Figura 48. A keni dëgjuar rishtazi ose a i jeni ekspozuar personalisht ju apo të tjerë gjuhës së urrejtjes? Sipas grupmoshës




Të anketuarit u pyetën edhe nëse kanë qenë dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes ndaj dikujt tjetër, a kishin ndërmarrë ndonjë veprim apo jo. Rezultatet tregojnë se më shumë se gjysma e të anketuarve kishin ndërmarrë veprim. Rreth 41 % nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim, por 19 % kishin dashur të bënin diçka, por nuk kishin ditur çfarë të bënin.

Figura 49. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes ndaj dikujt tjetër, a keni ndërmarrë ndonjë veprim?



Rezultatet sipas gjinisë nuk tregojnë asnjë dallim ndërmjet reagimit të sekseve të ndryshme në këto situata. Përkundrazi, rezultatet sipas grupmoshës tregojnë se grupmoshat më të vjetra kanë më shumë gjasa të ndërmarrin veprime në këto rrethana. Grupmoshat më të reja kanë më shumë gjasa të ndjehen konfuzë dhe të mos e dinë se ç'të bëjnë kur janë dëshmitarë të situatave të gjuhës së urrejtjes.

Figura 50. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes ndaj dikujt tjetër, a keni ndërmarrë ndonjë veprim? Sipas grupmoshave




Të anketuarit u pyetën lidhur me përvojat e tyre sa i përket ekspozimit ndaj gjuhës së urrejtjes. Rezultatet tregojnë se tetë nga dhjetë të anketuar nuk i janë ekspozuar kurrë gjuhës së urrejtjes. Rreth një në dhjetë i është ekspozuar disa herë dhe 5 për qind shumë shpesh. Rreth 4 për qind janë përgjigjur se nuk e dinë.

Figura 51. A i jeni ekspozuar ndonjëherë gjuhës së urrejtjes online?




Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se më pak gra nuk i janë ekspozuar kurrë gjuhës së urrejtjes në krahasim me burrat.

Figura 52. A i jeni ekspozuar ndonjëherë gjuhës së urrejtjes online? Sipas gjinisë




**Të dhënat sipas grupmoshave tregojnë se grupmoshat e reja kanë më shumë gjasa t’i ekspozohen gjuhës së urrejtjes.** Pothuajse asnjë i anketuar i moshës 50-64 vjeçare nuk i është ekspozuar gjuhës së urrejtjes. Përkundrazi, rreth 27 për qind e të anketuarve të rinj, 18-29 vjeç, i janë ekspozuar gjuhës së urrejtjes online, disa herë ose shumë shpesh, në krahasim me 16 për qind në radhët e 30-49 vjeçarëve dhe 3 % në radhët e grupmoshave më të vjetra.

Figura 53. A i jeni ekspozuar ndonjëherë gjuhës së urrejtjes online? Sipas grupmoshës




Të anketuarit që i janë ekspozuar gjuhës së urrejtjes online u pyetën më tutje se çfarë kishin bërë më pas. Shumica, rreth 39 % për qind e të anketuarve thanë se nuk kishin bërë asgjë. Rreth 31 % e kishin fshirë tekstin dhe e kishin bllokuar personin. Rreth 20 për qind u përgjigjën se ishin kundërpërgjigjur dhe vetëm 3 % u përgjigjën se e kishin raportuar në polici.

Figura 54. Në rast se i jeni ekspozuar gjuhës së urrejtjes online, çfarë keni bërë?




Rezultatet sipas gjinisë tregojnë se burrat kanë më shumë gjasa të mos ndërmarrin asnjë veprim pasi përjetojnë gjuhë të urrejtjes online në krahasim me gratë. Nga ana tjetër, gratë kanë më shumë gjasa t'i kundërpërgjigjen personit që i ka sulmuar.

Figura 55. Në rast se i jeni ekspozuar gjuhës së urrejtjes online, çfarë keni bërë? Sipas gjinisë



Rezultatet sipas grupmoshave tregojnë se të anketuarit e rinj kanë më shumë gjasa t'i fshijnë mesazhet dhe t'i kundërpërgjigjen personit që i ka sulmuar. Nga ana tjetër, grupmoshat më të vjetra kanë më shumë gjasa që të raportojnë në polici, në krahasim me grupmoshat më të reja.


Figura 56. Në rast se i jeni ekspozuar gjuhës së urrejtjes online, çfarë keni bërë? Sipas grupmoshës



### 2.3.8 Përvoja me gjuhën e urrejtjes së mostrës shtesë


Disa nga pyetjet e përfshira në studim i kushtohen përvojave të të anketuarve në lidhje me gjuhën e urrejtjes. Të anketuarit u pyetën nëse ata kishin dëgjuar ose i ishin ekspozuar rishtazi, personalisht ose për njerëz të tjerë, gjuhës së urrejtjes. Rezultatet tregojnë se shumica, rreth 46%, i ishin ekspozuar personalisht gjuhës së urrejtjes, dhe ngjashëm, kishin dëgjuar për njerëz të tjerë pranë tyre që ishin ekspozuar. Në një përqindje më të ulët (28%) disa persona nuk kishin dëgjuar ose nuk i ishin ekspozuar gjuhës së urrejtjes. Të intervistuarit romë dhe egjiptianë (rreth 35%) kanë pasur më pak përvojë ose kanë dëgjuar më pak situata të gjuhës së urrejtjes krahasuar me personat LGBTIQ (rreth 20%).

Figura 57. A keni dëgjuar rishtazi ose a i jeni ekspozuar personalisht apo të tjerë gjuhës së urrejtjes? Mostra shtesë




Një tjetër pyetje me rëndësi që u drejtohet vetëm atyre që kanë dëgjuar ose i janë ekspozuar personalisht gjuhës së urrejtjes, është se sa janë të predispozuar të ndërmarrin masa kur të tjerët cenohen nga gjuha e urrejtjes. Provat tregojnë se në përgjithësi, 62% e tyre kanë ndërmarrë veprime në momentin kur janë përballur me një situatë të tillë. Ndërsa 2 në 10 prej tyre nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim. Të dhënat tregojnë se romët dhe egjiptianët (75%) duket se kanë një pjesë më të madhe kur bëhet fjalë për të ndërmarrë veprime kundër gjuhës së urrejtjes krahasuar me LGBTIQ, nga të cilët 52% u përgjigjën se kishin ndërmarrë veprime.

Figura 58. Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes ndaj dikujt tjetër, a keni ndërmarrë ndonjë veprim? Mostra shtesë




Po ashtu, të anketuarit u pyetën nëse i ishin ekspozuar gjuhës së urrejtjes online. Rezultatet tregojnë se ekziston një ndryshim i madh midis LGBTIQ dhe komunitetit rom dhe egjiptian kur bëhet fjalë për shpeshhtësinë e rasteve kur hasin në gjuhë të urrejtjes. Rreth gjysma e të anketuarve LGBTIQ i janë ekspozuar shumë shpesh gjuhës së urrejtjes online krahasuar me 17% të romëve dhe egjiptianëve. Në total, 6 në 10 persona në këtë grup kanë përjetuar gjuhë të urrejtjes online të paktën një herë.

Figura 59. A i jeni ekspozuar ndonjëherë gjuhës së urrejtjes online? Mostra shtesë



Për më tepër, pjesëmarrësit u pyetën nëse kishin ndërmarrë ndonjë veprim në momentin kur kishin përjetuar gjuhë të urrejtjes online. Pothuajse 40% e të anketuarve pretendojnë se i janë kundërpërgjigjur personit që i ka sulmuar dhe rreth 30% kishin zgjedhur ta fshijnë mesazhin e urrejtjes. Të dhënat tregojnë se vetëm 10 për qind e të anketuarve zgjedhën të raportojnë në institucione publike si policia, komisioneri kundër diskriminimit, gjykata, etj. Nga ana tjetër, komunitetet rome dhe egjiptiane kanë më shumë të ngjarë të kundërpërgjigjen ndaj atyre që i sulmojnë (rreth 73%), në krahasim me personat LGBTIQ të cilët preferojnë të fshijnë mesazhe me përmbajtje diskriminuese ose ta anashkalojnë problemin se sa të përballen me të.

Figura 60. Në rast se jeni përballur me gjuhë të urrejtjes, çfarë keni bërë? Mostra shtesë



### 2.3.9 Niveli i ndërgjegjësimit dhe besimit në institucione

Të anketuarit u pyetën nëse ishin në dijeni të ekzistencës së një ligji në vend që i mbron njerëzit nga gjuha e urrejtjes. Rezultatet tregojnë se vetëm 8 për qind e të anketuarve ishin në dijeni të ekzistencës së një ligji të tillë në vend. Rreth 37 për qind dinin për ekzistencën e disa ligjeve, por asgjë konkrete. Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk ishin në dijeni të ekzistencës së këtyre ligjeve në vend.


Figura 61. A jeni në dijeni të ndonjë ligji që i mbron njerëzit nga gjuha e urrejtjes?



Rezultatet sipas grupmoshave tregojnë se më shumë të rinj janë në dijeni të ligjeve që i mbrojnë njerëzit nga gjuha e urrejtjes, në krahasim me grupmoshat më të mëdha. Rreth shtatë nga dhjetë të anketuar nuk dinë gjë për këto lloje të ligjeve në vend.




Figura 62. A jeni në dijeni të ndonjë ligji që i mbron njerëzit nga gjuha e urrejtjes, sipas grupmoshës?




Statusi i punësimit duket se luan rol në nivelin e ndërgjegjësimit për këto lloje të ligjeve në vend. Rreth 67 % e të papunësuarve nuk dinë asgjë për këto ligje, në krahasim me 47 % të të punësuarve. Punësimi duket të jetë me rëndësi jo vetëm në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, por në të njëjtën kohë, mund të ndikojë në mbrojtjen e njerëzve nga dukuri të tilla.

Figura 63. A jeni në dijeni të ndonjë ligji që i mbron njerëzit nga gjuha e urrejtjes, sipas grupmoshës? Sipas statusit të punësimit




Të pyetur lidhur me një situatë hipotetike nëse të anketuarit do të gjendeshin në kushte apo në situatë ku të shënjestroheshin nga gjuha e urrejtjes, shumica u përgjigjën se do të kërkonin ndihmë nga familja ose do t'u drejtoheshin miqve. Rreth 25 % do të shkonin tek mjeku ose psikologu. Rreth 24 % do të shkonin në polici dhe 15 % tek Avokati i Popullit.

Figura 64. Nëse do të bëheshit shënjestër e gjuhës së urrejtjes, ku do të drejtoheshit për ndihmë?




Rezultatet sipas seksit tregojnë se ka disa dallime ndërmjet gjinive në nivelin e besimit të njerëzve të ndryshëm apo të institucioneve. Më shumë gra do t'u drejtoheshin miqve dhe familjes. Më shumë gra do të shkonin tek mjeku/psikologu. Burrat kanë më shumë gjasa të mos ndërmarrin veprime në krahasim me gratë, përkatësisht 15 % deri 7 %. **Ka tregues të fuqishëm se burrave u duhet kushtuar më shumë vëmendje, pasi prirja e tyre për të mos i treguar askujt për këtë problem mund të shkaktojë probleme për ta.**

Figura 65. Nëse do të bëheshit shënjestër e gjuhës së urrejtjes, ku do të drejtoheshit për ndihmë? Sipas gjinisë




Pyetësi vazhdoi më tej në përpjekje për të eksploruar arsyet se përse njerëzit do të hezitonin të kërkonin ndihmë. Rezultatet tregojnë se më shumë se gjysma e të anketuarve mendojnë se askujt nuk i intereson nëse kërkojnë ndihmë. Rreth 21 % kanë frikë se mos nuk i marrin seriozisht dhe rreth 15 % mendojnë se të tjerët nuk do t'i besojnë.

Figura 66. A mund të shpjegoni përse? (vetëm ata që nuk do të kërkonin ndihmë)




Rezultatet sipas seksit tregojnë se më shumë gra kanë frikë se mos nuk i marrin seriozisht dhe më shumë burra mendojnë se gjuha e urrejtjes nuk është çështje serioze. Burrat kanë përqindje më të lartë të arsyeve të tjera që nuk janë listuar në pyetësor.

Figura 67. A mund të shpjegoni përse? (vetëm ata që nuk do të kërkonin ndihmë), sipas seksit



Në fund, të anketuarit u pyetën për mendimin e tyre në lidhje me perceptimin e tyre se cilat institucione i konsiderojnë më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes në vend. Kjo është një pyetje që indirekt mat nivelin e besimit të njerëzve në institucione të tilla në trajtimin e çështjeve të tilla në vend. Shkollat dhe universitetet janë institucionet që më së shumti perceptohet se kanë bërë më shumë kundër gjuhës së urrejtjes në vend, nga 46% e të anketuarve. Zyrtarët publikë, qeveria lokale, parlamenti dhe partitë politike perceptohen më pak nga të anketuarit si të përkushtuar në luftimin e gjuhës së urrejtjes në vend.


Figura 68. Sipas mendimit tuaj, cilat janë institucionet më të përkushtuara për luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri?



### 2.3.10 Niveli i ndërgjegjësimit dhe besimit në institucione të mostrës shtesë


Një nga pyetjet kryesore që iu bë të anketuarve kishte të bënte me dijeninë për ekzistencën e ligjeve që mbrojnë njerëzit nga gjuha e urrejtjes. Vetëm 19% në total kishin dijeni se ligje të tilla ekzistojnë, prej të cilëve 23% janë LGBTIQ dhe 14% romë dhe egjiptianë. Rrjedhimisht, 55% e komunitetit LGBTIQ dhe 37% e romëve dhe egjiptianëve, e dinë se ekzistojnë ligje të caktuara, por ata nuk janë të informuar për to. Romët dhe egjiptianët janë pjesa më pak e informuar e shoqërisë, ku 49% deklarojnë se nuk janë në dijeni të ndonjë ligji ekzistues në vend, megjithatë, situata ndryshon për komunitetin LGBTIQ ku 22% dukej se nuk ishin në dijeni të ligjeve që mbrojnë njerëzit nga gjuha e urrejtjes.

Figura 69. A jeni në dijeni të ndonjë ligji që i mbron njerëzit nga gjuha e urrejtjes?




Në pyetësor u përfshinë disa metrika shtesë për matjen e besimit të njerëzve në disa nga institucionet e specializuara që mund t'u ndihmojnë personave të cenuar nga gjuha e urrejtjes. Të dhënat tregojnë se në total, shumica e të anketuarve janë më të prirur të kërkojnë ndihmë nga shoqëria civile, që pasohet nga 33% që kërkojnë ndihmë nga familja/miqtë, 31% kërkojnë ndihmë nga komisioneri kundër diskriminimit, Avokati i Popullit, media, etj. Kur krahasojmë komunitetin rom dhe egjiptian me atë LGBTIQ, të dhënat tregojnë se komuniteti rom së pari do të kërkonte ndihmë nga shoqëria civile (42%), ndërsa 39% e LGBTIQ preferojnë të kërkojnë ndihmë kryesisht nga Komisioneri Kundër Diskriminimit. Sikurse ilustron në grafikun më poshtë, ekzistojnë fondacione/organizata ku romët dhe egjiptianët nuk do të shkonin për të kërkuar ndihmë, si mjeku/psikologu, zyrtari policor, zyrat publike ose OJQ-të, megjithatë LGBTIQ i ndryshon disi adresat ku kërkojnë ndihmë, ku i vetmi vend ku ata nuk do të shkonin janë OJQ-të. **Në këto rrethana, nënkuptohet se grupet që rrezikojnë më shumë nga përballja me gjuhën e urrejtjes nuk janë të prirur të kërkojnë ndihmë nga OJQ-të kur përballen me incidente të tilla.**

Figura 70. Nëse do të bëheshit shënjestër e gjuhës së urrejtjes, ku do të shkonit për ndihmë? Mostra shtesë




Në përpjekje për të kuptuar se përse një numër i konsiderueshëm i njerëzve nuk do të kërkonin ndihmë apo të flisnin me dikë, u hartua një pyetje specifike, vetëm për ata që u përgjigjën në këtë mënyrë. Shumica e mostrës, mesatarisht 68%, prirën të mendojnë se nuk do të kërkonin ndihmë pasi askujt nuk i intereson, pasuar nga 60% që mendojnë se u vjen turp t'i tregojnë dikujt se çfarë u ka ndodhur. Edhe pse ka ndryshime ndërmjet përgjigjeve të LGBTIQ dhe të romëve e egjiptianëve sa i përket asaj se përse nuk do të kërkonin ndihmë, dy arsytet e lartpërmendura janë më mbizotërueset dhe përcaktojnë shkaqet e ngurrimit të tyre. Përkatësisht 76% e LGBTQ dhe 50% e romëve dhe egjiptianëve mendojnë se askujt nuk i intereson ose se nuk kanë nevojë për ndihmë, ndërsa më pak LGBTIQ dhe më shumë romë dhe egjiptianë mendojnë se do t'u vinte turp të vepronin ashtu. Prandaj, dalim në përfundimin se 2 arsytet kryesore për se zona të segmentuara të shoqërisë nuk kërkojnë ndihmë kur përballen me diskriminim është në fakt se askujt nuk i intereson dhe se u vjen turp.

Figura 71. A mund të shpjegoni përse? (vetëm ata që nuk do të kërkonin ndihmë)



Në fund, një tregues i njohurive të tyre rreth institucioneve më të angazhuara në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri nxirret nga përgjigjet e tyre. Institucionet që kanë më shumë peshë lidhur me angazhimin për të luftuar gjuhën e urrejtjes janë shoqatat e shoqërisë civile (48%), organizatat ndërkombëtare (44%) të tilla si BE, Këshilli i Evropës, USAID, UN... etj., Avokati i Popullit (36%), dhe Komisioneri Kundër Diskriminimit (35%). Një dallim i rëndësishëm është vërejtur midis LGBTIQ kundrejt komunitetit rom dhe egjiptian lidhur me nivelin e besimit në institucionet publike, duke pasur parasysh që përqindja e njerëzve që zgjedhën institucionet publike si më të përkushtuara për të luftuar gjuhën e urrejtjes, është më e lartë në komunitetin LGBTIQ se sa tek romët dhe egjiptianët. Për shembull, 19% e LGBTIQ mendojnë se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e angazhuar për të luftuar gjuhën e urrejtjes në Shqipëri ndërsa vetëm 2% e romëve dhe egjiptianëve besojnë se ky institucion lufton gjuhën e urrejtjes. Afërsisht, 18% e LGBTIQ mendojnë se Ministria e Drejtësisë është një institucion tjetër për të luftuar gjuhën e urrejtjes, ndërsa vetëm 5% e romëve dhe egjiptianëve kanë të njëjtin mendim. Të dy komunitetet kanë një besim të përbashkët në lidhje me rolin e OJQ-ve në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri.

Sipas mendimit tuaj, cilat janë institucionet më të angazhuara në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri?



## 3. Gjuha e urrejtjes - standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për Shqipërinë<sup>60</sup>

---

### 3.1 Standardet Ndërkombëtare

#### 3.1.1 Kuadri Ligjor për gjuhën e urrejtjes në kontekstin e Kombeve të Bashkuara - Rregullimi i 'Gjuhës së Urrejtjes' në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara<sup>61</sup>

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike - PNDCP*

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike*, që është dokumenti kryesor në kuadrin e Kombeve të Bashkuara që liston lirit dhe të drejtat civile dhe politike të qytetarëve. Ai parashikon në mënyrë të plotë të drejtat dhe elementet që lidhen me lirinë e shprehjes, në mënyrë të përgjithshme dhe gjithashtu detyron shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara të ruajnë të njëjtin formulim apo standard në legjislacionet e tyre kombëtare, për t'i jetësuar ato.

Kështu Neni 19 garanton që "çdokush duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje dhe të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes. Liria e shprehjes përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij. Nga ana tjetër, ushtrimi i këtyre lirive lidhet me detyra dhe përgjegjësi të posaçme, ndaj këto të drejta mund t'u nënshtrohen kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve, për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik".

Ndërkohë që Neni 20 i PNDCP, në mënyrë të posaçme parashikon elementet që lidhen me gjuhën e urrejtjes, duke sanksionuar që çdo propagandë në favor të luftës duhet të ndalohet me ligj, si dhe faktin se çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë duhet të ndalohet nga ligji. Këto janë standarde të përgjithshme që çdo shtet që ratifikon PNDCP duhet t'i zbatojë, njësoj si t'i kishte miratuar vetë në legjislacionin kombëtar. Gjithsesi fakti që një konventë apo marrëveshje ndërkombëtare ratifikohet nga Parlamenti Shqiptar, nënkupton që të gjithë elementet apo standardet që ai parashikon, janë njësoj të detyrueshme për t'u zbatuar.

*Plani i Veprimit i Rabatit*

Plani i Veprimit të Rabat-it, është një dokument i miratuar në kuadrin e 4 takimeve të organizuara nën drejtimin e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, lidhur me nxitjen e urrejtjes kombëtare, racore apo fetare në vende të ndryshme, si dhe me diskutimin e përgjigjeve strategjike në qasjen ligjore dhe atë ekstra-ligjore, pas vlerësimit të situatës lidhur me zbatimin e legjislacionit, jurisprudencës dhe

---

<sup>60</sup> Nga Mirela Bogdani

<sup>61</sup>Promovimi dhe mbrojtja e të drejtës për lirinë e mendimit dhe të shprehjes\* Shënim nga Sekretari i Përgjithshëm

politikave për advokimin e çështjeve që përbëjnë urrejtje kombëtare, racore apo fetare, që nxisin diskriminimin, armiqësinë, apo dhunën në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.

Fatkeqësisht, individët apo grupet kanë vuajtur nga forma të ndryshme të diskriminimit, urrejtjes apo dhunës për shkak të prejardhjes së tyre etnike apo fetare, që mbartin efektet negative të manipulimit të racës, origjinës etnike dhe fetare, në mbrojtje të koncepteve të unitetit apo identitetit kombëtar, që shpesh instrumentalizohen ndër të tjera për qëllime politike apo elektorale. Gjithashtu ka një shqetësim në rritje të pandëshkueshmërisë së personave që kanë kryer këto krime apo kanë shkaktuar këto incidente, që kanë mbërritur në nivelin e nenit 20 të PNDCP, ndërkohë që anëtarë të grupeve në pakicë ndiqen penalisht duke krijuar një efekt parandalues tek të tjerët, për shkak të zbatimit në mënyrë abuzive të legjislacionit të brendshëm të paqartë, të jurisprudencës apo politikave lidhur me këto çështje. Ky kontrast ndërmjet pandëshkueshmërisë së çështjeve të nxitjes së urrejtjes si dhe ndjekja penale e pakicave nën petkun e ligjeve kombëtare kundër urrejtjes, duket që është një fenomen në rritje. Plani i Veprimit parashikon një sërë masash konkrete për parandalimin e nxitjes së urrejtjes në fushën e legjislacionit, infrastrukturës gjyqësore, dhe politikave shtetërore, si udhëzime për të gjithë aktorët në zbatimin e ndalimit ndërkombëtar të çdo lloj advokimi të urrejtjes kombëtare, racore apo fetare, që përbën apo pas-sjell nxitje apo stimulon diskriminimin, armiqësinë apo dhunën.

Për këtë qëllim, Shtetet duhet të angazhohen maksimalisht për të luftuar stereotipet negative të diskriminimit për shkak të kombësisë, përkatësisë etnike apo besimit fetar, promovojnë mirëkuptimin ndër-kulturor, përfshirë këtu edhe ndjeshmërinë gjinore, të krijojnë një kulturë paqeje dhe dhënie fund të pandëshkueshmërisë për këto çështje, të trajtojnë mësuesit për vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut, në fokusin e mirëkuptimit ndër-kulturor dhe të bëjnë pjesë të kurrikulave mësimore këto çështje, të trajtojnë dhe sensibilizojnë forcat policore apo agjencitë ligjzbatuese në administrimin e drejtësisë për ndalimin e nxitjes së urrejtjes, krijojnë institucione të posaçme për këtë qëllim apo rrisin kapacitetin e institucioneve ekzistuese për të zgjidhur këto çështje apo fuqizuar dialogun social, të miratojnë kuadrin rregullator apo politika publike që nxisin pluralizmin dhe diversitetin në media, për një akses të plotë dhe pa diskriminim ndaj mjeteve të komunikimit, në bashkëpunim me zyrën e Komisionerit të Lartë të KB për të Drejtat e Njeriut.

Disa nga elementet që ky dokument ka parashtruar për të vlerësuar ashpërsinë e nxitjes së urrejtjes lidhen me egërsinë apo qëllimin për deklaratat e bëra, justifikimin e dëmtimeve për shkak të nxitjes së urrejtjes, shpeshhtësinë, sasinë dhe shtrirjen e komunikimit. Për këtë qëllim, është hartuar një test minimum, i përbërë nga 6 hapa, propozuar për të vlerësuar shprehjet që përbëjnë vepër penale – nëse ato ka të ngjarë të nxisin diskriminim, armiqësi apo dhunë ndaj një grupi të synuar.

- **Konteksti** – ka rëndësi të madhe kur vlerësohet nëse ka efekt direkt tek qëllimi dhe/ose akuza e bërë. Analiza e kontekstit duhet të vendoset në kontekstin social dhe politik në kohën kur u bë deklarata;
- **Folësi** – pozicioni apo statusi i personit që ka bërë deklarin, duhet konsideruar qëndrimi individual apo qëndrimi i organizatës, ndaj audiencës që i është drejtuar shprehja/deklarata;
- **Qëllimi** – Neni 20 i PNDCP parasheh qëllimin për kryerjen e deklarimeve; neglizhenca apo pakujdesia nuk mjaftojnë që një deklarin apo veprim të konsiderohet shkelje e Nenit 20, pasi parashikon advokimin dhe nxitjen më tepër se sa përhapjen e thjeshtë apo qarkullimin e një materiali. Në këtë kontekst, kërkohet aktivizimi i trekëndëshit që lidh objektin dhe subjektin e deklarimeve apo veprimeve me audiencën;
- **Përmbajtja dhe forma** – përmbajtja dhe forma e fjalimit/deklarimit përbën një element kryesor të vendimeve të gjykatave dhe është në të njëjtën kohë edhe një element i nxitjes. Analiza e përmbajtjes mund të përfshijë shkallën në të cilën deklarata ishte prokuese, e drejtpërdrejtë, si edhe formën, stilin, natyrën e argumenteve të dhënë në deklaratë apo edhe balancën ndërmjet tyre;
- **Shtrirja e veprimit të deklaratës** – shtrirja përfshin elemente të tillë si përhapja apo ndikimi i veprimit të deklaratës, natyra e saj publike, si dhe magnituda dhe madhësia e audiencës. Elemente të tjerë që mund të vlerësohen nëse fjalimi apo deklarata ishte publike janë mjetet me anë të të cilave ato janë shpërndarë/përhapur, p.sh nëpërmjet një fletëpalosje apo transmetim në media kryesore apo nëpërmjet internetit, frekuenca e përhapjes, sasia dhe shkalla e përhapjes së komunikimeve, nëse



audience kishte mjete për të vepruar ndaj nxitjes, nëse deklarata apo veprimi qarkullon në një mjedis të kufizuar apo gjerësisht të aksesuar për publikun e gjerë;

- **Probabiliteti**, përfshirë edhe afrësinë/mundësinë e ndodhjes së veprës penale – nxitja (e urrejtjes) si veprim, për shkak të përkufizimit të saj është një krim i pa zhvilluar/kryer, lidhet me fazat fillestare të tij, me përgatitjen apo konceptimin e një vepre penale. Veprimi i kryer nëpërmjet fjalimeve nxitëse nuk kërkon të jetë kryer, në mënyrë që një deklaratë të konsiderohet vepër penale apo krim. Megjithatë, duhet të identifikohet një shkallë e caktuar, sado e vogël e rrezikut për të shkaktuar dëme. Kjo nënkupton që gjykatat duhet të vendosin nëse ka pasur një probabilitet të arsyeshëm që fjalimi do të përfundonte në një nxitje faktike kundër një grupi të synuar, duke vlerësuar se kjo lidhje shkakësore ka qenë e drejtpërdrejtë.

*Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Neni 4<sup>62</sup>*

*Konventa Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor* është një dokument i miratuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara (1965), dhe bën një parashikim të përgjithshëm të standardeve ndërkombëtare për eliminimin e diskriminimit racor, duke e përcaktuar atë si çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike.<sup>63</sup>

Që në preambulën e saj, Konventa parashikon se të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim. Gjithashtu, Kombet e Bashkuara, duke qenë të bindur se çdo doktrinë epërsie e bazuar në diferencimin midis racave është shkencërisht e gabuar, moralisht e dëmshme, shoqërisht e padrejtë dhe e rrezikshme nga pikëpamja shoqërore, dhe theksojnë se nuk duhet të ekzistojë kurrfarë justifikimi për diskriminim racial, askund, as në teori e as në praktikë, as diskriminim midis njerëzve për arsye race, ngjyre ose prejardhjeje etnike.

Në mënyrë të dedikuar, Neni 4 i Konventës parashikon specifikisht se shtetet palë duhet të marrin masa për të dënuar propagandën dhe të gjitha organizatat të bazuara në idetë ose teoritë e epërsisë së një race apo të një grupi personash të një ngjyre apo origjine etnike të caktuar, apo përipiqen të justifikojnë e ndihmojnë çdo formë të urrejtjes e të diskriminimit racial.

Masat e marra nga shtetet duhet të jenë të menjëhershme për të zhdukur çdo nxitje për një diskriminim apo akt diskriminues duke:

- a) shpallur vepra të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsinë ose urrejtjen raciale, çdo nxitje për diskriminim racial, si dhe çdo akt dhune ose provokim për kryerjen e akteve të kësaj natyre kundër çdo race apo grupi personash të një ngjyre ose origjine tjetër etnike, si dhe ndihmën e veprimtarive raciste (përfshirë këtu edhe financimin e tyre);
- b) Shpallur të paligjshme dhe duke ndaluar organizatat si dhe çdo aktivitet propagandistik që ndihmon dhe nxit diskriminimin racial dhe duke parashikuar që pjesëmarrja në këto organizata dhe veprimtari janë vepra të dënueshme me ligj;
- c) Duke mos lejuar autoritetet apo institucionet publike, qofshin ato kombëtare ose lokale, që ndihmojnë diskriminimin racial apo ta nxisin atë.

Ndërkohë që Neni 4 i Konventës ka funksionuar si mjeti kryesor për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, nene të tjera të saj krijojnë kontribute të dukshme në arritjen e këtyre objektivave duke garantuar të drejtën e barazisë përpara ligjit, dhe në mënyrë të veçantë të drejtën e lirisë së opinionëve dhe shprehjes; Neni 7 thekson rolin e mësimnxënies, edukimit, kulturës dhe informacionit në promovimin e mirëkuptimit dhe tolerancës ndër-etnike; Neni 2 lidhet me garantimin e masave që shtetet duhet të ndërmarrin për të eliminuar diskriminimin

<sup>62</sup> Tekstin e plotë të Konventës mund ta aksesoni të përkthyer në linkun

<http://www.magjistratura.edu.al/media/users/4/Konventa%20kunder%20diskriminimit%20racial.pdf>

<sup>63</sup> Për më shumë informacion referohu tek Neni 1/1 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor

racor dhe Neni 6 fokusohet në garantimin e një mbrojtjeje efektive dhe parashikimin e mekanizmave mbrojtës për viktimat e diskriminimit racor, si dhe garantimin e së drejtës për të kërkuar 'dëmshpërblim të drejtë apo të kënaqshëm' për dëmin e shkaktuar në këto raste.

*Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35 (2013) i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor<sup>64</sup> për luftën kundër gjuhës së urrejtjes racore*

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor është krijuar në kuadrin e Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (Neni 8). Ai përbëhet nga tetëmbëdhjetë ekspertë (të njohur për moralin dhe paanësinë e tyre, të përzgjedhur nga shtetet palë) dhe përgatit raporte lidhur me masat e karakterit legjislativ, gjyqësor, administrativ që shtetet kanë miratuar për të eliminuar diskriminimin racor, në zbatim të dispozitave të Konventës. Komiteti gjithashtu mund të paraqesë edhe sugjerime dhe rekomandime të bazuara në analizën e raporteve e të informacioneve që ka marrë nga shtetet, duke informuar edhe Asamblenë e Përgjithshme. Në këtë kontekst, Komiteti ka miratuar Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 35 (2013) për të luftuar gjuhën e urrejtjes racore, duke parashikuar që identifikimi dhe lufta ndaj gjuhës së urrejtjes është pjesë e arritjeve të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor.

Rekomandimi thekson se rëndësia e Neni 7 të Konventës është rritur me kalimin e kohës; qasja e tij gjerësisht edukative për eliminimin e diskriminimit racor është një plotësim i domosdoshëm i qasjeve të tjera për të luftuar diskriminimin racor. Për shkak se racizmi mund të jetë produkt inter alia i indoktrinimit ose edukimit joadekuat, veçanërisht antidotët efektivë të gjuhës raciste të urrejtjes duhet të përfshijnë edukimin për tolerancë dhe kundër-fjalën. Në këtë kontekst, Komiteti rekomandon promovimin e strategjive arsimore, kulturore dhe informuese për të luftuar gjuhën e urrejtjes raciste, të cilat duhet të mbështeten nga grumbullimi dhe analiza sistematike e të dhënave për të vlerësuar rrethanat nën të cilat shfaqet gjuha e urrejtjes, grupet e arritura ose të shënjestruara, mjetet me të cilat arrihen ato dhe përgjigjet e mediave ndaj mesazheve të urrejtjes. Bashkëpunimi ndërkombëtar në këtë fushë ndihmon për të rritur jo vetëm mundësitë e krahasimit të të dhënave, por edhe njohuritë dhe mjetet për të luftuar gjuhën e urrejtjes që tejkalon kufijtë kombëtarë.

*Komenti i Përgjithshëm Nr. 34 (2011) i Komitetit për të Drejtat e Njeriut të OKB<sup>65</sup>*

*Komenti i Përgjithshëm Nr. 34 (2011) i Komitetit për të Drejtat e Njeriut, i referohet detajimit të të gjitha elementeve dhe klauzoleve të Neni 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike që lidhet me lirinë për të dhënë opinione dhe për t'u shprehur. Ky koment nuk bën referime specifike lidhur me gjuhën e urrejtjes apo diskriminimin, por specifikon standarde të vendosura nga komunikimet e Komitetit me shtetet e ndryshme për çështje të lirisë së shprehjes dhe jep referenca të vlefshme lidhur me problematika specifike si rregullimi i lirisë së shprehjes në media dhe internet, çështjeve të fyerjes, të aksesit në informacione, të së drejtës për t'u shprehur në raport me kontekstin politik, çështje të kufizimeve të lirisë së shprehjes, etj.*

*Strategjia e Kombeve të Bashkuara dhe Plani i veprimit për gjuhën e urrejtjes*

Në të gjithë botën, po shihet një terren shqetësues i ksenofobisë, racizmit dhe intolerancës, përfshirë rritjen e antisemitizmit, urrejtjen anti-myslimane dhe persekutimin e të krishterëve. Mediat sociale dhe format e tjera të komunikimit po shfrytëzohen si platforma për fanatizëm. Gjuha e urrejtjes është një kërcënim për vlerat demokratike, stabilitetin shoqëror dhe paqen. Si çështje parimi, Kombet e Bashkuara duhet të përballen me gjuhën e urrejtjes në çdo hap.<sup>66</sup>

Aktualisht, mungon një përkufizim në të drejtën ndërkombëtare e gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, në kontekstin e këtij dokumenti, termi gjuhë urrejtje kuptohet si çdo lloj komunikimi në të folur, shkrim ose sjellje, që sulmon ose përdor gjuhë pejorative ose diskriminuese duke iu referuar një personi ose një grupi në bazë

<sup>64</sup> Tekstin e plotë të Rekomandimit 35/2013 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor mund ta aksesoni në linkun [https://www.ohchr.org/EN/Issues/Education/Training/Compilation/Pages/d/GeneralrecommendationNo35Combatingracisthatespeech\(2013\).aspx](https://www.ohchr.org/EN/Issues/Education/Training/Compilation/Pages/d/GeneralrecommendationNo35Combatingracisthatespeech(2013).aspx)

<sup>65</sup> Tekstin e plotë të Komentit të Përgjithshëm 34(2011) i Komitetit të Drejtave të Njeriut mund ta aksesoni në linkun <https://www.refworld.org/docid/4ed34b562.html>

<sup>66</sup> Për më shumë informacion shiko fjalimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara António Guterres në kuadrin e miratimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit të Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes, që mund të aksesohet online në linkun <https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/UN%20Strategy%20and%20Plan%20of%20Action%20on%20Hate%20Speech%2018%20June%20SYNOPSIS.pdf>

të kush janë ata, me fjalë të tjera, bazuar në fenë e tyre, etninë, kombësinë, raca, ngjyra, prejardhja, gjinia ose faktor tjetër identiteti. Kjo shpesh është e rrënjësor dhe gjeneron intolerancë dhe urrejtje dhe, në kontekste të caktuara, mund të jetë poshtëruese dhe përçarëse. Në mënyrë që të ndalojë gjuhën e urrejtjes si të tillë, e drejta ndërkombëtare ndalon nxitjen ndaj diskriminimit, armiqësisë dhe dhunës (referuar si 'nxitje'). Nxitja është një formë shumë e rrezikshme e të folurit, sepse synon qartë dhe qëllimisht të nxisë diskriminim, armiqësi dhe dhunë, të cilat gjithashtu mund të çojnë ose përfshijnë terrorizëm ose krime mizore. Gjuha e urrejtjes që nuk arrin pragun e nxitjes nuk është diçka që e drejta ndërkombëtare u kërkon shteteve ta ndalojnë. Ndaj është e rëndësishme të theksohet se edhe kur nuk ndalohej, gjuha e urrejtjes mund të jetë e dëmshme.

Gjuha e urrejtjes është në vetvete një sulm ndaj tolerancës, përfshirjes, diversitetit dhe thelbit të normave dhe parimeve tona të të drejtave të njeriut. Më gjerësisht, ajo minon kohezionin shoqëror, shkatërron vlerat e përbashkëta dhe mund të hedhë themelin e dhunës, duke zbrapsur kauzën e paqes, stabilitetit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmbushjes së të drejtave të njeriut për të gjithë.<sup>67</sup> Strategjia dhe Plani i Veprimit mbi Gjuhën e Urrëjtjes përcakton udhëzimet strategjike për sistemin e Kombeve të Bashkuara për të adresuar gjuhën e urrejtjes në nivelin kombëtar dhe global, si dhe përfshin mënyrat se si Sekretariati i Kombeve të Bashkuara mund të mbështesë punën e Koordinatorëve të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara në adresimin dhe kundërveprimin e gjuhës së urrejtjes. Objektivat e tij janë të dyfishtë: së pari, për të rritur përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për të adresuar shkaqet themelore dhe nxitësit e gjuhës së urrejtjes; dhe së dyti, për të mundësuar reagime efektive të Kombeve të Bashkuara për ndikimin e gjuhës së urrejtjes në shoqëri.

Strategjia e Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- Strategjia dhe zbatimi i saj duhet të jenë në përputhje me të drejtën për liri të mendimit dhe shprehjes. OKB mbështet më shumë fjalimin, si mjet kryesor për të adresuar gjuhën e urrejtjes;
- Trajtimi i gjuhës së urrejtjes është përgjegjësi e të gjithëve - qeverive, shoqërive, sektorit privat, duke filluar me individët si gra edhe burra. Të gjithë janë përgjegjës, të gjithë duhet të veprojnë; Në epokën dixhitale, KB duhet të mbështesin një brez të ri të qytetarëve dixhital, të fuqizuar për të njohur, refuzuar dhe përballur me gjuhën e urrejtjes;
- Ne duhet të dimë më shumë për të vepruar në mënyrë efektive - kjo kërkon mbledhjen e koordinuar të të dhënave dhe hulumtimet, përfshirë shkaqet themelore, faktorët dhe kushtet e favorshme për gjuhën e urrejtjes.

Detyrimet kryesore lidhur me zbatimin e strategjinë së KB dhe Planin e Veprimit për gjuhën e urrejtjes përfshijnë:

- Monitorimin dhe analizimin e gjuhës së urrejtjes;
- Adresimin e shkaqeve themelore, nxitësve dhe aktorëve të gjuhës së urrejtjes;
- Angazhimin dhe mbështetjen e viktimave të gjuhës së urrejtjes;
- Koordinimin me aktorët përkatës;
- Angazhimin me media të reja dhe tradicionale, me synimin për të forcuar partneritetin me mediat e reja dhe ato tradicionale për të adresuar gjuhën e urrejtjes dhe për të promovuar vlerat e tolerancës, mos-diskriminimit, pluralizmit dhe lirisë së mendimit dhe shprehjes;
- Përdorimin e teknologjisë dhe inkurajimin e më shumë hulumtimeve/kërkimeve mbi marrëdhëniet midis keqpërdorimit të internetit dhe mediave sociale për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe faktorëve që i shtojnë individët drejt dhunës. OKB duhet gjithashtu të angazhojnë aktorë të sektorit privat, përfshirë kompanitë e mediave sociale, në hapat që mund të marrin për të adresuar dhe luftuar gjuhën e urrejtjes, duke inkurajuar partneritetin midis qeverisë, industrisë dhe shoqërisë civile;
- Përdorimin e arsimit si një mjet për adresimin dhe luftën kundër gjuhës së urrejtjes;
- Nxitjen e shoqërive paqësore, gjithëpërfshirëse dhe të drejta për të adresuar shkaqet kryesore dhe nxitësit e gjuhës së urrejtjes;
- Angazhimi në advokim për të nxjerrë në pah urrejtjen, tendencat e fjalës shqetësuese, si dhe për të shprehur simpatinë dhe mbështetjen ndaj individëve ose grupeve të synuara;

<sup>67</sup> Për më shumë informacion, ju lutemi hidhni një sy kontekstit të miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes që mund ta gjeni online në linkun <https://www.un.org/en/genocideprevention/hate-speech-strategy.shtml>

- Zhvillimin e udhëzimeve për komunikimet e jashtme për të adresuar, luftuar dhe zbutur ndikimin e gjuhës së urrejtjes, si dhe për të kundërshtuar mbajtjen e saj, pa kufizuar të drejtën për lirinë e shprehjes.
- Mbështetja e Shteteve Anëtare në fushën e rritjes së kapaciteteve dhe politikave të zhvillimit për të adresuar gjuhën e urrejtjes.

### 3.1.2 Rregullimi i Gjuhës së Urrejtjes Online

*Parimet e Manilës mbi përgjegjësinë e ndërmjetësve ' (2015) (Electronic Frontier Foundation) <sup>68</sup>*

Parimet e Manilës mbi përgjegjësinë e ndërmjetësve përmbajnë udhëzime për praktikën më të mirë për kufizimin e përgjegjësisë së ndërmjetësve për përmbajtjen, për të promovuar lirinë e shprehjes dhe inovacionin. Kjo është një iniciativë globale e shoqërisë civile, e miratuar në 24 Mars të vitit 2015, me qëllim mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe krijimin e një mjedisi të mundshëm për inovacion, i cili ekuilibron nevojat e qeverive dhe aktorëve të tjerë. Grupet e shoqërisë civile nga e gjithë bota janë bashkuar për të propozuar këtë kornizë/kuadër të masave mbrojtëse dhe praktikave më të mira, që bazohen në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kornizat e tjera ligjore ndërkombëtare.

I gjithë komunikimi përmes internetit lehtësohet nga ndërmjetës të tillë si ofruesit e aksesit në internet, rrjetet sociale dhe motorët e kërkimit. Politikat që rregullojnë përgjegjësinë ligjore të ndërmjetësve për përmbajtjen e këtyre komunikimeve kanë një ndikim në të drejtat e përdoruesve, duke përfshirë lirinë e shprehjes, lirinë e grumbullimit dhe të drejtën për privatësi. Politikat e pa-unifikuara të përgjegjësisë së ndërmjetësve, masat rregullatore të hapura dhe të ashpra dhe mungesa e qëndrueshmërisë në të gjitha këto politika ka rezultuar në censurë dhe abuzime të tjera të të drejtave të njeriut nga qeveritë dhe palët private, duke kufizuar të drejtat e individëve për lirinë e shprehjes dhe duke krijuar një mjedis të pasigurt që gjithashtu pengon inovacionin në internet.

Parimet e Manilës sugjerohet të merren në konsideratë nga politikëbërësit dhe ndërmjetësit në shërbimin e internetit kur zhvillojnë, miratojnë dhe rishikojnë legjislacionin, politikat dhe praktikën që rregullojnë përgjegjësinë e tyre, lidhur me përmbajtjen e komenteve të palëve të treta, me qëllim të inkurajohet zhvillimi i regjimeve të përgjegjësisë ndërvepruese dhe të harmonizuara që mund të promovojnë inovacionin duke respektuar të drejtat e përdoruesve në përputhje me të drejtat e njeriut.

Parimet e Manilës listojnë elementët e mëposhtëm:

- Ndërmjetësit duhet të mbrohen nga përgjegjësia e përmbajtjes së publikimeve/komenteve të palëve të treta;
- Përmbajtja e tyre nuk duhet të kërkohet të kufizohet pa një urdhër/vendim nga një autoritet gjyqësor;
- Kërkesat për kufizime të përmbajtjes së komenteve në internet duhet të jenë të qarta, të jenë pa ekuivokë (të kuptohen menjëherë), dhe të ndjekin parimet e procesit të drejtë;
- Ligjet, urdhrat dhe praktikën e kufizimit të përmbajtjes në internet duhet të jetë në përputhje me testin e nevojës dhe proporcionalitetit;
- Ligjet, politikat dhe praktikën e kufizimit të përmbajtjes në internet duhet të respektojë parimet e procesit të drejtë ligjor;
- Transparenca dhe përgjegjësia duhet të jenë themeli i ligjeve, politikave dhe praktikave e kufizimit të përmbajtjes në internet.

<sup>68</sup> Teksti i plotë i dokumentit mund të aksesohet online në linkun [https://www.eff.org/files/2015/10/31/manila\\_principles\\_1.0.pdf](https://www.eff.org/files/2015/10/31/manila_principles_1.0.pdf)

*Thirrja e Christchurch (në Zelandën e Re) për Eliminimin e Përmbajtjes Terroriste dhe të Dhunshme Ekstremiste në Internet*<sup>69</sup>

Në 15 Mars 2019, njerëzit ndoqën drejtpërdrejt me tmerr për 17 minuta, një sulm terrorist kundër dy xhamive në Christchurch (qytet në Zelandën e Re), që u transmetua drejtpërdrejt. Pesëdhjetë e një njerëz dhe plagosën 50 të tjerë. Transmetimi i drejtpërdrejtë u pa rreth 4,000 herë para se të hiqej. Sulmi u transmetua drejtpërdrejt, u bë viral dhe mbetet i disponueshëm në internet pavarësisht nga masat e marra për ta hequr atë. Ky sulm terrorist i bëri të qarta edhe një herë dëmet që mund të shkaktohen nga përmbajtja terroriste dhe ekstremiste e dhunshme në internet, një kërcënim që vazhdon të evoluojë. Dy muaj më vonë gjatë ditës, më 15 maj 2019, Kryeministria e Zelandës së Re, Jacinda Ardern dhe Presidenti Francez, Emmanuel Macron mblohdën Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive dhe udhëheqës nga sektori i teknologjisë për të miratuar Thirrjen Christchurch. Thirrja është një angazhim i Qeverive dhe kompanive të teknologjisë për të eliminuar përmbajtjen ekstremiste terroriste dhe të dhunshme në internet dhe mbështetet në bindjen se një internet falas, i hapur dhe i sigurt ofron përfitime të jashtëzakonshme për shoqërinë. Respektimi i lirisë së shprehjes është thelbësor, sidoqoftë, askush nuk ka të drejtë të krijojë dhe ndajë përmbajtje ekstremiste terroriste dhe të dhunshme në internet.

Thirrja Christchurch u miratua në Paris dhe është një plan veprimi që angazhon qeveritë (drejtuesit nga 10 shtete) dhe kompanitë e teknologjisë për një sërë masash, duke përfshirë zhvillimin e mjeteve për të parandaluar ngarkimin e përmbajtjeve ekstremiste terroriste dhe të dhunshme në internet. Ato lidhen me çrrënjosjen e ekstremizmit të dhunshëm, me rritjen e transparencës rreth heqjes dhe zbulimit të përmbajtjes në internet, si dhe rishikimi se si algoritmet e kompanive i drejtojnë përdoruesit drejt përmbajtjes ekstremiste të dhunshme. Për herë të parë Qeveritë dhe kompanitë e teknologjisë kanë rënë dakord së bashku për një grup angazhimesh dhe bashkëpunim të vazhdueshëm për ta bërë internetin më të sigurt. Thirrja pranon se rregullimi në nivel kombëtar/shtetëror nuk do të zgjidhë problemin. Ekziston nevoja për të ndërtuar një hapësirë të re kibernetike, një internet të lirë, të hapur dhe të sigurt, i cili lejon të gjithë të ndajnë, mësojnë, përtërijnë, por që gjithashtu lejon shtetet të mbështesim vlerat e tyre, qytetarinë e tyre dhe t'i fuqizojnë ato.

*Akti i Rregullimit të Rrjetit në Gjermani (2017)*

*Akti i Rregullimit të Rrjetit në Gjermani*<sup>70</sup> është një ligj i cili përcakton praktikën e bllokimit dhe filtrimit të gjuhës së urrejtjes në media të caktuara online. Ligji aplikohet tek ofruesit e shërbimeve të telemediave që janë fitimprurës të cilët operojnë në 'platforma interneti që janë dizajnuar të lejojnë përdoruesit për të shpërndarë përmbajtje të ndryshme me përdorues të tjerë ose për ta bërë këtë përmbajtje të aksesueshme nga publiku (rrjetet sociale)'. Ky ligj parashikon edhe detyrimin për raportim dhe detyrimin për të ndjekur një procedurë efektive dhe transparente për trajtimin e ankesave. Procedura duhet të sigurojë që ligjshmëria e një komenti në këto rrjete sociale, duke iu referuar parashikimeve të Kodit Penal Gjerman, kontrollon menjëherë dhe rrjeti heq ose bllokon aksesin në këto komente brenda afateve të përcaktuara kohore.<sup>71</sup>

**Detyrimi për raportim** - ofruesit e shërbimeve të rrjeteve sociale që marrin **më shumë se 100 ankesa në vit kalendarik** në lidhje me përmbajtjen e paligjshme, janë të detyruar të hartojnë **raporte 6-mujore** për trajtimin e ankesave për përmbajtje të paligjshme në platformat e tyre dhe janë të detyruar t'i publikojnë këto raporte në gazeta federale dhe në faqen e tyre në internet jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës 6-mujore. Raportet e botuara në faqen e tyre të internetit duhet të jenë lehtësisht të njohura, të arritshme drejtpërdrejt dhe të disponueshme përgjithmonë.<sup>72</sup> Përmbajtja e detyrueshme e raportimeve është përcaktuar qartë dhe me detaje në Nenin 1, Seksioni 2(2) të ligjit.

**Shqyrtimi i ankesave** - detyrimi për të pasur një procedurë transparente dhe efektive për trajtimin e ankesave përbën një rregullim të rëndësishëm të këtij ligji. Procedura duhet të sigurojë që ligjshmëria e një komenti,

<sup>69</sup>Informacioni mund të gjendet në linkun <https://www.christchurchcall.com/>. Zelandë e Re dhe Franca ishin dy shtetet iniciatore për krijimin e Thirrjes. Ato synojnë të dërgojnë Thirrjen edhe në vende, organizata dhe kompani të tjera dhe do të çojnë përpara qëllimet e saj edhe në forume të tjera. Aktualisht, Thirrja është miratuar nga Franca, Zelandë e Re, Kanadaja, Indonezia, Irlanda, Jordania, Norvegjia, Senegali, Mbretëria e Bashkuar, Australia, Gjermania, India, Italia, Japonia, Holanda, Spanja dhe Suedia dhe Komisioni Evropian, si dhe Amazon, Facebook, Dailymotion, Google, Microsoft, Qwant, Twitter dhe YouTube.

<sup>70</sup>Për më shumë informacion, vizito Aktin për përmirësimin e zbatimit të ligjit në rrjetet sociale 12.07.2017: [https://www.bmjv.de/SharedDocs/Gesetzgebungsverfahren/Dokumente/NetzDG\\_engl.pdf;jsessionid=20142B62A606A9F5E9CFD9655F514FD4A.1\\_cid324?\\_\\_blob=publicationFile&v=2](https://www.bmjv.de/SharedDocs/Gesetzgebungsverfahren/Dokumente/NetzDG_engl.pdf;jsessionid=20142B62A606A9F5E9CFD9655F514FD4A.1_cid324?__blob=publicationFile&v=2)

<sup>71</sup> Për më shumë informacion, vizito komentarin e ligjit: <https://rm.coe.int/dgi-2019-update-chapter-germany-study-on-blocking-and-filtering/168097ac51>

<sup>72</sup> Neni 1, Seksioni 2(1) i Aktit të Rregullimit të Rrjetit në Gjermani.

duke iu referuar disa dispozitave të Kodit Penal Gjerman, kontrollohet menjëherë dhe rrjeti **'heq ose bllokoni qasjen në përmbajtje që është qartazi e paligjshme brenda 24 orëve nga marrja e ankesës'** dhe të gjitha të tjerat me përmbajtje problematike **'përgjithësisht brenda 7 ditëve nga marrja e ankesës'**.<sup>73</sup>

**Gjobat** - Akti i Rregullimit të Rrjetit në Gjermani gjithashtu parashikon mundësinë e vendosjes së gjobave ndaj subjekteve të këtij ligji, nëse ata shkelin këtë ligj. Nëse autoriteti kompetent administrativ gjerman dëshiron të lëshojë një vendim për gjobë duke u mbështetur në faktin se përmbajtja e cila nuk është hequr ose bllokuar nga subjekti është e paligjshme, së pari duhet të ketë një vendim gjyqësor që vërteton një paligjshmëri të tillë. Gjykata që ka juridiksionin në këtë rast është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me ankimin për gjobën. Kërkesa për një vendim paraprak paraqitet në gjykatë së bashku me pretendimet e ofruesit të shërbimeve të rrjetit social. Gjykata mund të vendosë pa qenë nevoja e një seance dëgjimi verbal. Vendimi i kësaj gjykate nuk është i kontestueshëm dhe është i detyrueshëm për autoritetin kompetent administrativ.

*Ligji Francez për Ndalimin e Gjuhës së Urrejtjes Online (2019)*

Në mënyrë të ngjashme me Gjermaninë, Franca ka prezantuar ligjin *'Për luftën kundër përmbajtjes së urrejtjes online'*<sup>74</sup> (2019), i njohur ndryshe në Francë edhe si *'Ligji Avia'* për shkak të mbiemrit të propozueses së tij në Parlament. Ky ligj aplikohet tek "operatorët e platformave online që ofrojnë një shërbim të komunikimit publik online në internet bazuar në lidhjen e shumë palëve me qëllim të shpërndarjes së përmbajtjes publike ose bazuar në klasifikimin apo referencën e përmbajtjes me anë të algoritmeve kompjuterikë, i cili ofrohet në internet nga palë të treta, kur kjo veprimtari tejkalon një prag në territorin francez, i cili përcaktohet me dekret"<sup>75</sup>.

**Detyrimi për fshirjen e materialeve** - Operatorët e platformave online për të cilët aplikohet ky ligj janë të detyruar që, brenda 24 orëve nga njoftimi nga një ose më shumë persona, të bëjnë të paarrtshme çdo përmbajtje që përbën në mënyrë të dukshme të vepër penale sipas Ligjit Avia apo ligjeve të tjera franceze.<sup>76</sup>

**Gjobat**- refuzimi për të fshirë një mesazh apo përmbajtje qartësisht të paligjshme tashmë është shtuar si vepër penale në legjislacionin penal francez. Sipas Ligjit Avia, Këshilli i Lartë Audiovizual Francez mund të gjobisë një operator të një platforme online deri në 4% të xhiros së tij globale vjetore në rast të "dështimeve serioze dhe të përsëritura" për të përmbushur detyrimin e heqjes së përmbajtjes së dukshme të paligjshme.<sup>77</sup> Ky projektligj u kalua nga Asambleja Kombëtare Franceze (njëra dhomë e Parlamentit Francez), por jo në Senat (Dhoma tjetër e Parlamentit Francez). Ky i fundit propozoi disa ndryshime, të cilat nuk u miratuan nga Komiteti Parlamentar i Përbashkët me përfaqësues të të dyja dhomave. Në përputhje me parashikimet e legjislacionit francez, fjalën e fundit e tha Asambleja Kombëtare e cila miratoi këtë ligj. Megjithatë, Këshilli Kushtetues Francez që u vu në lëvizje nga Senati e konsideroi shumicën e neneve të këtij ligji jo në përputhje me Kushtetutën Franceze. Ky ligj ka hasur kritika jo vetëm nga shoqatat në mbrojtje të fjalës së lirë, por edhe nga Komisioni Evropian, i cili e ka konsideruar këtë ligj që bie ndesh me legjislacionin e BE për tregtinë online dhe me parimin e lirisë për të shpërndarë informacion.

*Raporti i Reporterit të Veçantë të Kombeve të Bashkuara mbi Promovimin dhe Mbrojtjen e Lirisë së Opinioneve dhe Shprehjes*

Raporti i vitit 2019 lidhur me adresimin e gjuhës së urrejtjes i Reporterit të Veçantë të Kombeve të Bashkuara mbi Promovimin dhe Mbrojtjen e Lirisë së Opinioneve dhe Shprehjes<sup>78</sup> fokusohet tek aplikimi i të drejtave të njeriut në luftën kundër gjuhës së urrejtjes online. Në rastin e kufizimit të lirisë së shprehjes për të luftuar gjuhën e urrejtjes, raporti thekson se është thelbësore për shtetin të demonstrojë domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e ndërmarrjes së veprimeve të kufizimit të lirisë së shprehjes: sa më i ashpër dënimi, aq më e madhe është nevoja për të provuar domosdoshmërinë e një mase.<sup>79</sup> Lidhur me sa më sipër, Raporti përcakton disa parime:

<sup>73</sup> Neni 1 Seksioni 3(1),(2) dhe (3) Aktit të Rregullimit të Rrjetit në Gjermani.

<sup>74</sup> Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni:

<https://www.legifrance.gouv.fr/download/pdf?id=CP05NSqcP15IPNu3MsP2PSu1fmt64dDetDQxhvJZNMc=>

<sup>75</sup> Ibid. Neni 1.

<sup>76</sup> Ibid. Neni 1.

<sup>77</sup> Ibid. Neni 4.

<sup>78</sup> Për të aksesuar tekstin e plotë të Raportit, vizito: <https://www.undocs.org/A/74/486>

<sup>79</sup> Raporti i vitit 2019 lidhur me adresimin e gjuhës së urrejtjes i Reporterit të Veçantë të Kombeve të Bashkuara mbi Promovimin dhe Mbrojtjen e Lirisë së Opinioneve dhe Shprehjes, faqe 10.

- Kufizimi i lirisë së shprehjes nuk favorizohet të bëhet në rastet e gjuhës që tregojnë mungesë respekti ndaj fesë. Për këtë arsye, blasfemia (si fyerje ndaj një feje) duhet të dekriminalizohet si vepër penale, nëse shtetet nuk e kanë realizuar ende diçka të tillë.<sup>80</sup>
- Sipas këtij raporti, mohimi i saktësisë historike të ngjarjeve të së shkuarës nuk duhet të jetë objekt i dënimit penal ose kufizimeve të tjera pa një vlerësim më të detajuar të mëtejshëm.<sup>81</sup>
- Raporti thekson që shprehjet që mund të jetë fyese ose karakterizohen nga paragjykimet dhe që mund të ngrenë shqetësime serioze të intolerancës shpesh mund të mos përmbushin pragun e ashpërsisë për t'u përballur me çdo lloj kufizimi. Të tilla janë për shembull deklaratat e paragjykimeve kundër grupeve të mbrojtura, por që nuk bëjnë thirrje apo nxitje për dhunë a urrejtje.<sup>82</sup>
- Në përputhje edhe me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit, shtetet duhet të kriminalizojnë jo vetëm genocidin, por edhe nxitjen për genocid.<sup>83</sup>

Në përfundim, raporti përmbledh këto **rekomandime** për shtetet:

- Ligjet kombëtare duhet të përkufizojnë në mënyrë strikte 'përmbajtjen e ndaluar' në përputhje me Nenin 20 (2) të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike Nenin 4 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Gjithsesi, kjo lloj përmbajtje nuk duhet të kriminalizohet, me përjashtim të situatave të rënda, si p.sh. avokimi i urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë. Gjithashtu shtetet duhet të adoptojnë interpretimet e legjislacionit për të drejtat e njeriut të përfshira në Planin e Veprimit të Rabatit;
- Ligjet ekzistuese kombëtare duhet të rishikohen dhe të zhvillohen më shumë legjislacioni mbi gjuhën e urrejtjes për të përmbushur kërkesat e ligjshmërisë, domosdoshmërisë, proporcionalitetit, legjitimitetit etj.;
- Duhet të merren parasysh dhe të vendosen masa të qeverisjes së mirë, përfshirë ato të rekomanduara në rezolutën e Këshillit për të Drejtat e Njeriut 18/18 dhe në Planin e Veprimit të Rabatit, për të luftuar gjuhën e urrejtjes me qëllim zvogëlimin e nevojës për të kufizuar lirinë e shprehjes;
- Duhet të miratohen ose rishikohen rregullat e përgjegjësisë ndërmjetësuese për t'u respektuar në mënyrë rigoroz standardet e të drejtave të njeriut dhe të mos kërkohet që kompanitë të kufizojnë përmbajtjen që Shtetet nuk do të ishin në gjendje ta bënin direkt përmes legjislacionit;
- Duhet të krijohen ose forcohen mekanizma të pavarur gjyqësorë për tu siguruar që individët mund të kenë akses në drejtësi dhe kompensim kur vuajnë dëmet e njohura që lidhen me Nenin 20 (2) të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike ose Nenin 4 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit;
- Duhet të miratohen ligje që u kërkojnë kompanive të përshkruajnë në detaje dhe publikisht si përkufizojnë gjuhën e urrejtjes dhe si zbatojnë rregullat e tyre kundër saj, si dhe të krijojnë bazat e të dhënave të veprimeve të ndërmarra kundër gjuhës së urrejtjes. Kompanitë gjithashtu kompanitë duhet të inkurajohen të respektojnë standardet e të drejtave të njeriut në rregullat e tyre;
- Shtetet duhet të angazhohen aktivisht në proceset ndërkombëtare të hartuara si forume mësimore për adresimin e gjuhës së urrejtjes.<sup>84</sup>

<sup>80</sup> Ibid, faqe 11.

<sup>81</sup> Ibid, faqe 11.

<sup>82</sup> Ibid, faqe 12.

<sup>83</sup> Ibid, faqe 12.

<sup>84</sup> Ibid, faqe 22.

## 3.2 Kuadri Ligjor për Gjuhën e Urrejtjes në Kontekstin e Rregullimeve të BE-së

*Kodi i Sjelljes i BE-së kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrejtjes në Internet*

*Kodi i Sjelljes i BE-së kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrejtjes në Internet*<sup>85</sup> është një instrument ligjor i nënshkruar midis Komisionit Evropian dhe kompanive të mëdha që operojnë në internet (kompani IT) si: Facebook, Microsoft, Twitter, YouTube (2016), Instagram, Snapchat & Dailymotion (2018), Jeuxvideo.com (2019) dhe TikTok (2020). Këto kompani kanë rënë dakord të mbështesin Komisionin Evropian dhe Shtetet Anëtare të BE për të siguruar që platformat online nuk ofrojnë hapësira që gjuha e paligjshme e urrejtjes të shpërndahej virtualisht.<sup>86</sup> Për momentin, ky Kod nuk ka efekt të drejtpërdrejtë mbi Shqipërinë. Megjithatë, me çeljen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ky Kod përbën jo vetëm një instrument ligjor të rëndësishëm për t'u analizuar në kuadër të këtij studimi, por edhe një dokument me rëndësi praktike i cili do të jetë automatikisht në fuqi për Shqipërinë në momentin e anëtarësimit.

Kodi i Sjelljes i BE-së kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrejtjes në Internet fillimisht jep përkufizimin e 'gjuhës së paligjshme të urrejtjes.' Ai thekson që 'Gjuha e paligjshme e urrejtjes, siç përcaktohet nga Vendimi Kuadër 2008/913/JHA i 28 Nëntorit 2008 për luftimin e formave të caktuara dhe shprehjet e racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal dhe ligjeve kombëtare nënkupton të gjitha sjelljet që nxisin publikisht dhunë ose urrejtje të drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi të tillë duke iu referuar racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare apo etnike.'<sup>87</sup> Një rol të rëndësishëm në këtë mision, ky Kod i cakton edhe organizatave të shoqërisë civile, në parandalimin e rritjes së urrejtjes online, duke promovuar mos-diskriminimin, tolerancën dhe respektin, ndër të tjera përmes ndërgjegjësimit të popullsisë.

Kompanitë IT, duke marrë përsipër drejtimin në luftimin e përhapjes së gjuhës së paligjshme të urrejtjes në internet, kanë rënë dakord me Komisionin Evropian të marrin përsipër në këtë kuadër dymbëdhjetë detyra kryesore.<sup>88</sup> Këto detyra përmbledhen si më poshtë<sup>89</sup>:

- Kompanitë IT duhet të ndjekin procedura të qarta dhe efektive për të vlerësuar njoftimet lidhur me gjuhën e paligjshme të urrejtjes në shërbimet e tyre, për të pasur mundësinë të ndalojnë aksesin në përmbajtje të tilla. Këto kompani do të udhëhiqen nga Udhëzuesit e BE-së lidhur me ndalimin e promovimit të dhunës dhe urrejtjes.
- Pas marrjes së njoftimit të fshirjes, kompanitë IT duhet të vlerësojnë me ekipe të dedikuara këto kërkesa në raport me rregullat dhe udhëzimet e BE apo të Shteteve Anëtare.
- Kompanitë IT duhet të vlerësojnë njoftimet për fshirjen e gjuhës së paligjshme të urrejtjes brenda më pak se 24 orësh dhe, nëse do e shohin të nevojshme, do të fshijnë apo pamundësojnë aksesin në këto materiale.
- Kompanitë IT duhet të edukojnë dhe rrisin ndërgjegjësimin e përdoruesve të tyre lidhur me përmbajtjet e ndaluara të gjuhës në përputhje me rregullat të tyre dhe udhëzimet e BE-së. Si mjet për të realizuar këtë mund të përdoret mekanizmi i njoftimeve.
- Kompanitë IT duhet të informojnë Shtetet Anëtare lidhur me mënyrën e marrjes së njoftimeve, në kuadër të përmirësimit të shpejtësisë dhe efektivitetit të komunikimit midis kompanive IT dhe Shteteve Anëtare. Informacioni do të përçohet nëpërmjet kanaleve kombëtare të përcaktuara nga kompanitë IT dhe Shtetet Anëtare. Kjo procedurë do t'u shërbejë Shteteve Anëtare të familjarizohen me metodat e njohjes dhe njoftimit të kompanive IT lidhur me gjuhën e paligjshme të urrejtjes.
- Kompanitë IT duhet të forcojnë marrëdhëniet e shkëmbimit të informacionit me Organizatat e Shoqërisë Civile duke zgjeruar hartën gjeografike të këtyre partneriteteve dhe, kur shihet e nevojshme, do të ofrojnë suport dhe trajnim për anëtarët e këtyre organizatave në mënyrë që ata të funksionojnë si 'raportues të besueshëm'.

<sup>85</sup> Për më shumë informacion, vizito: [https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/racism-and-xenophobia/eu-code-conduct-countering-illegal-hate-speech-online\\_en](https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/racism-and-xenophobia/eu-code-conduct-countering-illegal-hate-speech-online_en)

<sup>86</sup> Kodi i Sjelljes i BE-së kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrejtjes në Internet, paragrafi 4.

<sup>87</sup> Kodi i Sjelljes i BE-së kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrejtjes në Internet, paragrafi 2.

<sup>88</sup> Kodi i Sjelljes i BE-së kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrejtjes në Internet, paragrafi 8.

<sup>89</sup> Shënim: Përshkrimi i detyrave është një përmbledhje e detajuar por jo një përkthim literal pikave të Kodit.



- Kompanitë IT duhet të mbështeten nga Shtetet Anëtare dhe Komisioni Evropian për të aksesuar rrjetin e partnerëve të Organizatave të Shoqërisë Civile dhe 'raportuesve të besueshëm.' Njoftimet për 'raportuesit e besueshëm' duhet të paraqiten në faqet e internetit të këtyre kompanive.
- Kompanitë IT duhet të ofrojnë trajnim të vazhdueshëm për stafin e tyre dhe do të shkëmbejnë mendime për përmirësime të mëtejshme.
- Kompanitë IT duhet të intensifikojnë bashkëpunimin me platformat e mediave sociale.
- Kompanitë IT dhe Komisioni Evropian, duke njohur vlerën e fjalës së pavarur kundër retorikës së urrejtjes dhe paragjykitimit, synojnë të vazhdojnë punën e tyre në identifikimin dhe promovimin e nismave të pavarura, ideve dhe iniciativave të reja dhe mbështetjen e programeve arsimore që inkurajojnë të menduarit kritik.
- Kompanitë IT duhet të intensifikojnë punën e tyre me Organizatat e Shoqërisë Civile për të ofruar trajnime mbi praktikën më të mira të kundërshtimit të retorikës së urrejtjes dhe paragjykitimit, si dhe për t'i ndihmuar ato të ofrojnë fushata efektive kundër gjuhës së urrejtjes. Komisioni Evropian, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, kontribuon duke ndërmarrë hapa për të hartuar nevojat dhe kërkesat specifike të Organizatave të Shoqërisë Civile në këtë drejtim.
- Komisioni Evropian në koordinim me Shtetet Anëtare duhet të promovojnë aderimin në këtë Kod edhe ndaj platformave dhe kompanive të tjera të mediave. Në përfundim të këtij Kodi Sjelljeje, palët kanë rënë dakord që zbatimi i Kodit të vlerësohet në mënyrë periodike.

Që nga miratimi në vitin 2016, Kodi i Sjelljes po progreson në mënyrë të vazhdueshme: vlerësimet e fundit tregojnë se mesatarisht kompanitë konstatojnë 90% të përmbajtjes së gjuhës së paligjshme të urrejtjes brenda 24 orësh dhe 71% e përmbajtjes që konsiderohet gjuhë e paligjshme e urrejtjes, fshihet.<sup>90</sup>

*Vendimi Kuadër i Këshillit Evropian 2008/913/JHA i Nëntorit 2008 Mbi Luftimin e Formave dhe Shprehjeve të Caktuara të Racizmit dhe Ksenofobisë nëpërmjet Legjislacionit Penal*

*Vendimi Kuadër i Këshillit Evropian 2008/913/JHA i Nëntorit 2008 Mbi Luftimin e Formave dhe Shprehjeve të Caktuara të Racizmit dhe Ksenofobisë nëpërmjet Legjislacionit Penal*, luan një rol të rëndësishëm në adresimin e problemeve të lidhura ngushtë me gjuhën e urrejtjes në BE. Së pari, termi 'Vendim Kuadër i Këshillit Evropian' i referohet një vendimmarrjeje të BE-së në sferën e *policiisë dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet e drejtësisë penale* deri në momentin e hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Sipas këtij të fundit, vendimet në këtë fushë miratohen nëpërmjet procedurës së zakonshme legjislative. Në vitin e marrjes së këtij vendimi (2008), Traktati i Lisbonës nuk kishte hyrë zyrtarisht në fuqi, ndaj ky instrument ligjor emërtohet 'vendim kuadër' dhe jo për shembull 'direktivë' (si do të konsiderohej në ditët e sotme). Në periudhën kur u nënshkrua ky Vendim Kuadër, ai prezantoi një harmonizim të kufizuar të legjislacionit të Shteteve Anëtare kundër racizmit dhe ksenofobisë.<sup>91</sup>

Ashtu si u diskutua edhe në rastin e Kodit të Sjelljes së BE-së kundër Gjuhës së Paligjshme të Urrëjtjes në Internet, edhe ky Vendim Kuadër momentalisht nuk ka efekt të drejtpërdrejtë mbi Shqipërinë. Megjithatë, me çeljen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ai përbën jo vetëm një instrument ligjor të rëndësishëm për t'u analizuar në kuadër të këtij studimi, por edhe një vendim me rëndësi praktike i cili do të jetë automatikisht në fuqi për Shqipërinë në momentin e anëtarësimit. Ndaj, është me rëndësi të njihet, kuptohet dhe për sa është e mundur edhe të zbatohet, ndonëse nuk është detyrues.

Një nga qëllimet e këtij Vendimi Kuadër është përafrimi i mëtejshëm i legjislacioneve penale të Shteteve Anëtare në mënyrë që të sigurohet zbatimi efektiv i një legjislacioni gjithëpërfshirës dhe të qartë për të luftuar racizmin dhe ksenofobinë<sup>92</sup>. Para nënshkrimit të këtij Vendimi Kuadër kanë ekzistuar instrumente të tjerë ligjorë në kuadër të luftës kundër racizmit dhe ksenofobisë. Megjithatë, ashtu si përcaktohet edhe në preambulën e këtij dokumenti, është parë i nevojshëm një rregullim i ri në kushtet e zhvillimeve të reja (edhe teknologjike). Megjithatë, ky vendim është i kujdesshëm të përmendë edhe respektimin e të drejtave të tjera themelore të Shteteve Anëtare në implementimin e këtyre rregullave, sidomos lirinë e shprehjes, në përputhje edhe me parashikimet e Neni 6 të Traktatit të Bashkimit Evropian (Neni 7 i Vendimit Kuadër).

<sup>90</sup> Për më shumë informacion, vizito Raportet e Monitorimit të Komisionit Evropian: [https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/racism-and-xenophobia/eu-code-conduct-countering-illegal-hate-speech-online\\_en](https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/racism-and-xenophobia/eu-code-conduct-countering-illegal-hate-speech-online_en)

<sup>91</sup> Për më shumë informacion vizito Raportin:

<https://publications.parliament.uk/pa/cm201314/cmselect/cmeuleg/83-xxxiv/8328.htm>

<sup>92</sup> Preambula e Vendimit Kuadër i Këshillit Evropian 2008/913/JHA i Nëntorit 2008 Mbi Luftimin e Formave dhe Shprehjeve të Caktuara të Racizmit dhe Ksenofobisë nëpërmjet Legjislacionit Penal, Paragrafi 4.

Sipas këtij Vendimi Kuadër, në veprat penale që lidhen me racizmin dhe ksenofobinë sugjerohet të përfshihen:

- Nxitja publike e dhunës ose urrejtjes e drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi të tillë duke iu referuar racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes, apo origjinës kombëtare ose etnike (Neni 1(a) i Vendimit Kuadër);
- Kryerja e njërit prej veprimeve të mësipërme publikisht ose nëpërmjet shpërndarjes së trakteve, figurave apo materialeve të tjera (Neni 1(b) i Vendimit Kuadër);
- Falja, mohimi apo banalizimi i rëndë publik i genocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës siç përkufizohen në Nenet 6, 7 dhe 8 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, drejtuar kundër një grupi personash apo një anëtar të një grupi të tillë duke iu referuar racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes apo origjinës kombëtare ose etnike kur sjellja është bërë në mënyrë të tillë që të nxisë dhunë apo urrejtje kundër një grupi apo një anëtar të një grupi (Neni 1(c) i Vendimit Kuadër);<sup>93</sup>
- Falja, mohimi apo banalizimi i rëndë publik i krimeve të përcaktuara në Nenin 6 të Kartës së Tribunalit Ndërkombëtar Ushtarak bashkëngjitur Marrëveshjes së Londrës së 8 Gushtit 1945<sup>94</sup> drejtuar kundër një grupi personash apo një anëtar të një grupi të tillë duke iu referuar racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes apo origjinës kombëtare ose etnike, kur sjellja është bërë në mënyrë të tillë që të nxisë dhunë apo urrejtje kundër një grupi apo një anëtar të grupit (Neni 1(d) i Vendimit Kuadër);<sup>95</sup>
- Nxitja për të kryer veprat e përcaktuara në Nenin 1(c) dhe (d) duhet të jetë gjithashtu e dënueshme penalisht (Neni 2(1) i Vendimit Kuadër);
- Dhënia e ndihmës dhe mbështetja për të kryer secilin nga veprimet e Nenit 1 duhet të jetë e dënueshme penalisht (Neni 2(2) i Vendimit Kuadër).

Në secilin nga rastet e mësipërme, Vendimi Kuadër përcakton që Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që sjelljet e mësipërme të dënohen me ndëshkime penale prej një maksimumi së paku ndërmjet 1 dhe 3 vite burgim (Neni 3(2) i Vendimit Kuadër).<sup>96</sup> Po ashtu, edhe në rastet kur një vepër nuk përbën vepër penale në përputhje me këtë Vendim, Shtetet Anëtare duhet të marrin masat për të siguruar që motivimet raciste apo ksenofobike të konsiderohen si rrethana rënduese ose, në mënyrë alternative, të merren në konsideratë nga gjykatat në përcaktimin e dënimit (Neni 4). Në çdo rast, Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që hetimet lidhur me këto vepra nuk do të varen vetëm nga raportimi i viktimave (Neni 8).

Vendimi Kuadër adreson gjithashtu edhe përgjegjësinë e personave juridikë në luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë. Me 'person juridik' ky instrument i referohet 'çdo subjekti që ka një status të tillë sipas legjislacionit kombëtar, me përjashtim të shteteve ose organeve të tjera publike në ushtrimin e autoritetit shtetëror dhe organizatave ndërkombëtare publike' (Neni 5(4) i Vendimit Kuadër). Në rastet kur veprat penale të përcaktuara në Nenet 1 dhe 2 të këtij Vendimi Kuadër vërtetohet që janë shkaktuar nga persona juridikë, masat e marra nga Shtetet Anëtare duhet të jenë 'efektive, proporcionale dhe dekurajuese'<sup>97</sup> duke përfshirë dënime si: përjashtimi nga e drejta për përfitime ose subvencione publike, skualifikim i përkohshëm ose i përhershëm nga praktika e veprimtarisë tregtare, vendosja nën mbikëqyrje gjyqësore, apo mbyllja e aktivitetit nëpërmjet një urdhri gjyqësor (Neni 6(1) i Vendimit Kuadër).

*Rekomandimi i Komisionit Evropian (EU) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për Masat e Ndalimit të Përmbajtjes së Paligjshme Online*

*Rekomandimi i Komisionit Evropian (EU) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online*<sup>98</sup> është një akt i BE në kuptimin e një 'soft law' (nuk përmban dispozita detyruese, por Komisioni mund të kërkojë të dhëna lidhur me ndjekjen e tij nga Shtetet Anëtare). Ky Rekomandim pranon që

<sup>93</sup> Vendimi kuadër përcakton vetëm standardet minimale që duhet të përmbushin Shtetet Anëtare në luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë. Në paragrafin 10 të Preambulës Vendimi lejon Shtetet Anëtare për të zgjeruar këtë pikë në krime kundër grupesh të përkufizuara nga elementë të tjerë, përveç atyre të përmendur nga Neni 1(c) i Vendimit.

<sup>94</sup> Këtu përfshihen: krimet kundër paqes, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit me përkufizimet përkatëse.

<sup>95</sup> Vendimi kuadër përcakton vetëm standardet minimale që duhet të përmbushin Shtetet Anëtare në luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë. Në paragrafin 10 të Preambulës Vendimi lejon Shtetet Anëtare për të zgjeruar këtë pikë në krime kundër grupesh të përkufizuara nga elementë të tjerë, përveç atyre të përmendur nga Neni 1(d) i Vendimit.

<sup>97</sup> Neni 6(1) i Vendimit Kuadër

<sup>98</sup> Për t'u njohur me tekstin e këtij Rekomandimi, vizito: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32018H0334>

është e domosdoshme të merren parasysh veçantitë e trajtimit të llojeve të ndryshme të përmbajtjes së paligjshme në internet dhe të cilat kërkojnë përgjigje specifike, përfshirë këtu masa specifike ligjore.<sup>99</sup> Duke qenë se qëllimi i këtij rekomandimi është adresimi i rreziqeve që lidhen me përmbajtje të paligjshme që prekin konsumatorët në BE, ai lidhet me aktivitetet e të gjithë ofruesve të shërbimeve online, pavarësisht nëse ata janë të vendosur në BE apo në një vend të tretë, për sa kohë që këta të fundit ofrojnë shërbime në BE. Rregullat e këtij Rekomandimi ndahen në dy grupe kryesore: rregulla që aplikohen për përmbajtjen e paligjshme online në përgjithësi dhe rregulla që aplikohen për përmbajtjen e paligjshme që ka lidhje me terrorizmin.

- Për sa i përket grupit të parë (Rregulla që aplikohen për përmbajtjen e paligjshme online në përgjithësi), Rekomandimi thekson se duhet të përcaktohen rregulla precize lidhur me mekanizmat për dërgimin e njoftimeve për përmbajtjen e paligjshme online. Këto mekanizma duhet të jenë të lehta për t'u përdorur, miqësore për përdoruesit dhe të mundësojnë dërgimin e njoftimeve me mjete elektronike.<sup>100</sup> Në vijim të kësaj procedure, ky Rekomandim parashikon detyrimin e ofruesve të shërbimeve online për të informuar autorët e përmbajtjes së paligjshme për arsyen e fshirjes së përmbajtjes. Ky rregull nuk aplikohet në rastin e përmbajtjeve që indikojnë krime serioze të cilat rrezikojnë jetën apo sigurinë e njerëzve. Nga ana tjetër, autorët e kësaj përmbajtjeje mund të ankohen për fshirjen e saj nëpërmjet një kundër-njoftimi i cili i dërgohet ofruesve të shërbimit online.<sup>101</sup> Në këtë kontekst, Shtetet Anëtare duhet të marrin masa mbrojtëse efektive dhe të përshtatshme për të siguruar që ofruesit e shërbimeve veprojnë në mënyrë proporcionale në lidhje me përmbajtjen që ata ruajnë, veçanërisht kur përpunojnë njoftimet dhe kundër-njoftimet dhe kur vendosin për fshirjen e përmbajtjes të konsideruar si e paligjshme. Në çdo rast, Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin masa efektive dhe të përshtatshme për të parandaluar kryerjen e veprimeve lidhur me njoftimet ose kundër-njoftimet që dërgohen në keqbesim dhe forma të tjera të sjelljes abuzive.<sup>102</sup>
- Për sa i përket grupit të dytë (Rregulla që aplikohen për përmbajtjen e paligjshme që ka lidhje me terrorizmin), Rekomandimi thekson se ofruesit e shërbimeve online duhet të përcaktojnë shprehimisht në kushtet e tyre të shërbimit që ata nuk do të ruajnë përmbajtje terroriste.<sup>103</sup> Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve online duhet të marrin masa proporcionale dhe specifike proaktive, duke përfshirë përdorimin e mjeteve të automatizuara, në mënyrë që të zbulojnë, identifikojnë dhe heqin ose çaktivizojnë me shpejtësi aksesin në përmbajtjen terroriste.<sup>104</sup> Në rastin e adresimit të përmbajtjes së ka lidhje me terrorizmin, rëndësi të veçantë merr bashkëpunimi i ofruesve të shërbimeve online me autoritetet kompetente shtetërore. Në këtë kuadër, këto dy palë duhet të përfundojnë marrëveshje, kur është e përshtatshme edhe me Europol, për çështjet që lidhen me përmbajtjen terroriste në internet, duke përfshirë rritjen e aktiviteteve terroriste në internet, përmirësimin e mekanizmave të referimit, parandalimin e dublikimit të panevojshëm të përpjekjeve dhe lehtësimin e kërkesave ligjore për qëllimet e hetimeve penale në lidhje me terrorizmin.<sup>105</sup>

---

<sup>99</sup> Recitali 7 i Rekomandimit të Komisionit Evropian (EU) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online.

<sup>100</sup> Rekomandimi i Komisionit Evropian (EU) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online, Kapitulli II, Pika 5.

<sup>101</sup> Rekomandimi i Komisionit Evropian (EU) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online, Kapitulli II, Pika 11.

<sup>102</sup> Rekomandimi i Komisionit Evropian (BE) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online, Kapitulli II, Pika 21.

<sup>103</sup> Rekomandimi i Komisionit Evropian (BE) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online, Kapitulli III Pika 30.

<sup>104</sup> Rekomandimi i Komisionit Evropian (BE) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online Kapitulli III Pika 36.

<sup>105</sup> Rekomandimi i Komisionit Evropian (BE) 2018/334 datë 1 Mars 2018 për masat e ndalimit të përmbajtjes të paligjshme online Kapitulli III Pika 40.

### 3.3 Kuadri ligjor për Gjuhën e Urrejtjes në Këshillin e Evropës dhe KEDNJ- Praktika Gjyqësore që lidhet me të

*Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 10*

Një rol të rëndësishëm në kuadrin ligjor shqiptar luajnë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, pasi vetë Kushtetuta e RSH në Nenin 116 të saj, i vendos në hierarki menjëherë pas Kushtetutës, mbi çdo ligj apo akt nënligjor. Nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH është me rëndësi të veçohet Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), së cilës Kushtetuta e RSH, në Nenin 17 të saj, i atribuon një status të veçantë dhe superior. Ky nen, në paragrafin 2, parashikon që kufizimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese nuk mund të cenohet thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalohet kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Pra, për sa i përket **kufizimit të të drejtave kushtetuese, KEDNJ qëndron në majën e hierarkisë të burimeve të së drejtës, së bashku me Kushtetutën**. Pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të KEDNJ në sistemin ligjor shqiptar, është me rëndësi të njihen parashikimet e saj lidhur me lirinë e shprehjes.

KEDNJ rregullon lirinë e shprehjes në Nenin 10 të saj. Ky nen parashikon që:

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.'

Paragrafi 1 i Nenin 10 të KEDNJ përkufizon të drejtën për lirinë e shprehjes në disa komponentë të saj, si liria e mendimit dhe liria për të marrë ose dhënë informacione dhe ide. Ashtu si do të diskutohet më poshtë, Neni 10(1) i KEDNJ mbron edhe rastet kur informacioni ose idetë ofendojnë, shokojnë ose bezdisin Shtetin apo pjesë të caktuara të popullsisë.<sup>106</sup>

Nga ana tjetër, gjuha e urrejtjes shkon përtej informacionit që ofendon, shokon apo bezdis. Aktualisht nuk ka një përkufizim të pranuar gjerësisht të 'gjuhës së urrejtjes'. Megjithatë një përkufizim i cituar në jurisprudencë dhe doktrinën juridike është ai i dhënë nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës (ashtu si do të diskutohet më poshtë) i cili ka përcaktuar që termi 'gjuhë e urrejtjes' do të kuptohet si 'tërësia e të gjitha formave të shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, përfshirë intolerancën e shprehur nga nacionalizmi dhe etnocentrizmi agresiv, diskriminimin dhe armiqësinë ndaj pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.'<sup>107</sup>

Liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute; vetë Konventa parashikon instrumente të kufizimit të lirisë së shprehjes në rastet e abuzimit me këtë liri. Gjuha e urrejtjes është një nga rastet më tipike të abuzimit me lirinë e shprehjes. Në rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, liria e shprehjes e parashikuar nga Neni 10(1) i KEDNJ kufizohet në dy mënyra:

- së pari, kjo gjuhë e urrejtjes përjashtohet nga mbrojtja e Konventës, duke aplikuar Nenin 17 të KEDNJ (Ndalimi i Shpërdorimit të të Drejtave), kur gjuha e urrejtjes mohon vlerat themelore të Konventës. Në këtë rast, GJEDNJ nuk nis me shqyrtimin e faktit nëse ka pasur shkelje të të drejtave të parashikuara në Konventë (p.sh. liria e shprehjes), duke qenë se vetë kjo gjuhë nuk mund të jetë objekt mbrojtjeje.

<sup>106</sup> Për më shumë informacion, vizito: [https://www.echr.coe.int/documents/fs\\_hate\\_speech\\_eng.pdf](https://www.echr.coe.int/documents/fs_hate_speech_eng.pdf), faqe 1.

<sup>107</sup> Për më shumë informacion, vizito: <https://rm.coe.int/168071e53e>

Më tej, studimi parashikon një diskutim dhe një analizë më e detajuar e zbatimit të këtij neni në rastin e gjuhës së urrejtjes.

- Së dyti, në rast se gjuha e urrejtjes nuk provohet që mohon vlerat themelore të Konventës, ajo sërish kufizohet në aplikim të Nenit 10(2) të KEDNJ. Në këtë rast, gjuha nën hetim do t'i nënshtrohet 'testit me tre hapa' për të përcaktuar nëse do të kufizohet sipas Nenit 10(2) apo jo. Testi me tre hapa përfshin përgjigjen ndaj tre pyetjeve:
  1. A është parashikuar kufizimi i lirisë së shprehjes nga legjislacioni kombëtar?
  2. Kufizimi i lirisë së shprehjes a ka ndodhur për arsytet legjitime të përcaktuara në Nenin 10/2?
  3. A është kufizimi i lirisë së shprehjes i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të arritur një ose më shumë nga qëllimet legjitime të përmendura në Nenin 10?<sup>108</sup>

Nëse përgjigjet për të trija pyetjet në mënyrë kumulative janë 'Po', atëherë kufizimi i lirisë së shprehjes është legjitim. Gjuha e urrejtjes në ditët e sotme manifestohet shpesh nëpërmjet internetit. Për këtë arsye, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka konfirmuar që Neni 10 dhe 17 i KEDNJ aplikohen në mënyrë të plotë edhe për lirinë e shprehjes në internet.<sup>109</sup>

Në trajtimin e çështjeve që lidhen me gjuhën e urrejtjes dhe Nenin 10 të KEDNJ, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka mbajtur parasysh edhe elemente të tjerë. Sipas Manualit mbi Gjuhën e Urrejtjes<sup>110</sup> të referuar edhe nga Këshilli i Evropës, disa elemente të mbajtur parasysh nga Gjykata në përcaktimin e shkeljes ose jo të Nenit 10 për sa i përket kufizimit të gjuhës së urrejtjes, janë:

- **Qëllimi** i personit, liria e fjalës së të cilit ishte e kufizuar;
- **Përmbajtja** e shprehjes që është kufizuar;
- **Konteksti**, p.sh. nëse personi që e bëri deklaratën është **një gazetar apo politikan**;
- **Profili i njerëzve të dëmtuar** nga shprehja;
- **Publiciteti** dhe ndikimi i mundshëm i shprehjes, p.sh. nëse deklarata është bërë në një gazetë të shpërndarë gjerësisht apo në një poezi;
- **Natyra dhe ashpërsia e kufizimit**.

Megjithatë, jo të gjithë këto elemente kanë të njëjtën peshë në vlerësimin e Gjykatës. Sipas të njëjtit Manual, kriteri kryesor që GJEDNJ merr parasysh në trajtimin e një çështjeje të kufizimit të lirisë së shprehjes për shkak të gjuhës së urrejtjes është **nëse autori i deklaratës po përhapte qëllimisht ide raciste ose intolerante përmes përdorimit të gjuhës së urrejtjes apo po përpiquej të informonte publikun për çështje me interes të përgjithshëm**. Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje lejon të përcaktohet se cilat shprehje, megjithëse tronditëse ose fyese, mbrohen nga Neni 10, dhe cilat janë ato që nuk duhet të tolerohen në një shoqëri demokratike dhe përjashtohen nga mbrojtja e Konventës në bazë të Nenit 17.<sup>111</sup>

Gjithashtu, sipas Manualit, **profili i njerëzve që përhapin gjuhën e urrejtjes** mbahet në konsideratë nga Gjykata. Në përgjithësi, Gjykata konsideron se kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjera kur subjekti në fjalë është një politikan sesa nëse është një individ privat. Ndryshe nga ky i fundit, i pari në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije e vendoset nën shqyrtim të detajuar për çdo fjalë dhe vepër të tij nga media dhe publiku. Megjithatë, për sa i përket përhapjes së **gjuhës së urrejtjes në veçanti, Gjykata është më e rreptë me politikanët dhe këmbëngul në përgjegjësinë e tyre për të mos përdorur gjuhë që kontribuon në nxitjen e intolerancës**. Lidhur me mediat, manuali bën dallimin midis dy situatave: kur gazetarët janë autorë të deklaratave, **çka nuk është e pranueshme**, dhe kur ata janë vetëm ndërmjetës në dhënien e deklaratave të bëra nga të tjerët dhe të cilat ato nuk i bëjnë vetë ose i mbështesin. **Gjykata është e rreptë kur bëhet fjalë për kufizime të mundshme të lirisë së mediave, për shkak të rolit të rëndësishëm që ato luajnë në shoqëritë demokratike**. Ajo nënvizon që shtypi nuk duhet të kapërcejë kufijtë e vendosur, ndër të tjera, për 'mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve'. Megjithatë, mediat kanë të drejtë të japin informacione dhe ide për çështje politike dhe fusha të tjera të interesit publik. Për më tepër, jo vetëm mediat mbartin detyrën e përcjelljes së informacioneve dhe ideve të tilla, por edhe publiku gjithashtu ka të drejtë t'i marrë ato.<sup>112</sup>

<sup>108</sup> Për më tepër informacion në lidhje me Testin me Tre Hapa, vizito: <https://rm.coe.int/168071e53e>

<sup>109</sup> Për më shumë informacion, vizito: [https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Neë\\_technologies\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Neë_technologies_ENG.pdf)

<sup>110</sup> Manual mbi Gjuhën e Urrejtjes, Jaime Rodríguez, Këshilli i Evropës, 2009: <https://rm.coe.int/168071e53e>

<sup>111</sup> Ibid.

<sup>112</sup> Ibid.

*Rekomandimi Nr. R 97(20) 30.10.1997 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Gjuhën e Urrejtjes*

*Rekomandimi Nr. R 97(20) 30.10.1997 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Gjuhën e Urrejtjes (Rekomandimi Nr. R97(20) i KE)* është miratuar me qëllimin e arritjes së një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve, sidomos lidhur me ruajtjen dhe realizimin e idealeve dhe parimeve që përbëjnë trashëgimi të përbashkët.<sup>113</sup> Ky rekomandim bazohet në dënimin e të gjitha formave të shprehjes të cilat krijojnë urrejtje raciale, ksenofobi, antisemitizëm, dhe të gjitha format e intolerancës të cilat minojnë sigurinë demokratike, kohezionin kulturor dhe pluralizmin. Ai thekson që sa më sipër mund të bëhet akoma më e rrezikshme nëse përhapet nëpërmjet medias. Nga ana tjetër, Rekomandimi mban parasysh rëndësinë e respektimit të lirisë së shprehjes, sidomos referuar pavarësisë dhe autonomisë editoriale të medias.

Shqipëria është shtet anëtar i Këshillit të Evropës nga 13 Korriku 1995. Kjo do të thotë që Rekomandimi i mësipërm është direkt i aplikueshëm edhe në Shqipëri. Megjithatë, a janë Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të detyrueshme? Nga vetë terminologjia e përdorur për këtë instrument, mund të konkludohet që Rekomandimet nuk kanë karakter të detyrueshëm. Një qëndrim i tillë konfirmohet nga Statuti i Këshillit të Evropës, i cili përcakton që Rekomandimet nuk janë detyruese për Shtetet Anëtare. Sidoqoftë, Statuti lejon Komitetin e Ministrave të kërkojë nga qeveritë anëtare 'ta informojnë atë për veprimet e ndërmarra prej tyre' në lidhje me Rekomandimet.<sup>114</sup>

Ky Rekomandim, në Shtojcën e tij, e përkufizon gjuhën e urrejtjes si 'të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, përfshirë: intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimin dhe armiqësinë kundër pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.'<sup>115</sup> Pavarësisht se nuk ka një përkufizim të pranuar gjerësisht për gjuhën e urrejtjes, ky version është ndër më të cituarit në kuadër të gjuhës së urrejtjes.<sup>116</sup>

Ky Rekomandim i Këshillit të Evropës fokusohet në katër pika kryesore për t'u zbatuar nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës:<sup>117</sup>

1. Shtetet Anëtare rekomandohen të ndërmarrin hapat e duhur për të luftuar gjuhën e urrejtjes bazuar në parimet e përcaktuara në Rekomandim.
2. Shtetet Anëtare rekomandohen të sigurojnë që hapa të tillë të jenë pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse kundër fenomenit, i cili gjithashtu targeton shkaqet shoqërore, ekonomike, politike, kulturore dhe shkaqe të tjera;
3. Nëse nuk e kanë realizuar ende, Shtetet Anëtare rekomandohen të nënshkruajnë, ratifikojnë dhe zbatojnë në mënyrë efektive në legjislacionin kombëtar Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në përputhje me Rezolutën (68) 30 të Komitetit të Ministrave mbi masat që duhet të merren kundër nxitjes në urrejtjes raciale, kombëtare dhe fetare.
4. Shtetet Anëtare rekomandohen të rishikojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre të brendshme në mënyrë që të sigurojnë që këto të fundit të jenë në përputhje me parimet të përcaktuara në Shtojcën e këtij Rekomandimi, të cilat do të trajtohen më poshtë.

Parimet e përcaktuara në Shtojcën bashkëlidhur Rekomandimit të mësipërm janë të gjitha në funksion të luftës kundër gjuhës së urrejtjes, sidomos asaj të përhapur nëpërmjet medias. Shtojca përmban gjithsej shtatë parime të rëndësishme në këtë kuadër, të cilat mund të përmbledhen si vijon:

- Parimi 1: Qeveritë e shteteve anëtare, autoritetet publike dhe institucionet publike në nivel rajonal, kombëtar apo lokal, si dhe zyrtarët, kanë përgjegjësi të përmbahen nga deklaratat, në veçanti ndaj

<sup>113</sup> Rekomandimi Nr. R 97(20) 30.10.1997 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Gjuhën e Urrejtjes [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=0900001680505d5b](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900001680505d5b), faqe 1.

<sup>114</sup> Neni 15(b) i Statutit të Këshillit të Evropës.

<sup>115</sup> Shtojca e Rekomandimit Nr. R 97(20) 30.10.1997 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Gjuhën e Urrejtjes, paragrafi 1.

<sup>116</sup> Për më shumë informacion, vizito: <https://rm.coe.int/168071e53e>

<sup>117</sup> Rekomandimi Nr. R 97(20) 30.10.1997 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Gjuhën e Urrejtjes [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectID=0900001680505d5b](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900001680505d5b) faqe 2.

medias, të cilat mund të kuptohen si gjuhë urrejtjeje, ose si fjalime që mund të krijojnë efektin e legjitimitetit, përhapjes ose promovimit të urrejtjes racore, ksenofobisë, antisemitizmit ose formave të tjera të diskriminimit ose urrejtjes bazuar në intolerancë. Deklarata të tilla duhet të ndalohen dhe të dënohen publikisht sa herë që ndodhin.

- Parimi 2: Qeveritë e Shteteve Anëtare duhet të krijojnë një kuadër ligjor të përbërë nga dispozita të karakterit civil, penal dhe administrativ mbi gjuhën e urrejtjes të cilat do u mundësojnë autoriteteve administrative dhe gjyqësore të ekuilibrojnë respektimin e lirisë së shprehjes me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjen e reputacioni ose të drejtat e të tjerëve. Për këtë qëllim, qeveritë e vendeve anëtare duhet të shqyrtojnë mënyrat dhe mjetet për të: stimuluar dhe koordinuar kërkimet mbi efektivitetin e legjislacionit dhe praktikës ligjore ekzistuese; rishikuar kuadrin ekzistues ligjor në mënyrë që të sigurohet që ajo zbatohet në një mënyrën e duhur për shërbimet dhe rjetet e reja të mediave dhe komunikimit; zhvilluar një politikë të bashkërenduar të ndjekjes penale bazuar në udhëzimet kombëtare, duke respektuar parimet e përcaktuara në këtë Rekomandim; rritur mundësitë e luftimit të gjuhës së urrejtjes përmes legjislacionit civil, për shembull duke lejuar të organizatat joqeveritare të interesuara të ngrenë padi civile, duke pretenduar kompensim për viktimat e gjuhës së urrejtjes dhe duke parashikuar mundësinë që viktimat të mund t'u përgjigjen vendimeve e gjykatës; si dhe për t'i siguruar publikut dhe profesionistëve të medias informacion mbi dispozitat ligjore që zbatohen për gjuhën e urrejtjes.
- Parimi 3: Qeveritë e shteteve anëtare duhet të sigurojnë që në kuadrin ligjor të përmendur në Parimin 2, ndërhyrjet në lirinë e shprehjes të kufizohen dhe zbatohen në një mënyrë të ligjshme dhe jo arbitrare, në bazë të kriterëve objektive. Për më tepër, në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës, çdo kufizim ose ndërhyrje në lirinë e shprehjes duhet t'i nënshtrohet kontrollit të pavarur gjyqësor. Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur liria e shprehjes duhet të ekuilibrohet me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve.
- Parimi 4: Legjislacioni dhe praktika gjyqësore e shteteve anëtare duhet të lejojnë që gjykatat të mbajnë parasysh se raste specifike të gjuhës së urrejtjes mund të jenë aq fyese për individë ose grupe të caktuara, sa të mos gëzojnë nivelin e mbrojtjes së dhënë nga Neni 10 i KEDNJ. Ky është rasti kur gjuha e urrejtjes ka për qëllim cenimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose kufizimin e tyre në një masë më të madhe sesa parashikohet në të.
- Parimi 5: Legjislacioni dhe praktika gjyqësore e Shteteve Anëtare duhet të lejojë autoritetet kompetente të ndjekjes penale t'i kushtojnë vëmendje të veçantë, brenda diskrecionit të tyre, rasteve që përfshijnë gjuhë urrejtjeje. Në këtë drejtim, këto autoritete duhet, në veçanti, të shqyrtojnë me kujdes të drejtën e të pandehurit për lirinë e shprehjes duke pasur parasysh se vendosja e sanksioneve penale përgjithësisht përbën një ndërhyrje serioze në këtë liri. Gjykatat kompetente, kur vendosin sanksione penale ndaj personave të dënuar për vepra të gjuhës së urrejtjes duhet të respektojnë parimin e proporcionalitetit.
- Parimi 6: Legjislacioni dhe praktika gjyqësore e Shteteve Anëtare në fushën e gjuhës së urrejtjes duhet të marrin parasysh rolin e medias në komunikimin e informacionit dhe ideve të cilat ekspozojnë, analizojnë dhe shpjegojnë elementë të caktuar të gjuhës së urrejtjes apo fenomenin në përgjithësi si dhe të drejtën e publikut për të marrë këto informacione dhe ide. Për këtë qëllim, legjislacioni dhe praktika gjyqësore e shteteve anëtare duhet të bëjnë dallimin midis përgjegjësisë së autorit të gjuhës së urrejtjes, nga njëra anë, dhe përgjegjësisë së medias dhe profesionistëve të medias që kontribuojnë për shpërndarjen e saj si pjesë e misionit të tyre për të komunikuar informacion dhe ide mbi çështje me interes publik për ana tjetër.
- Parimi 7: Në përputhje me Parimin 6, legjislacioni dhe praktika gjyqësore e shteteve anëtare duhet të marrin parasysh faktin që: raportimi mbi racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të intolerancës mbrohet plotësisht nga Neni 10, Paragrafi 1, i KEDNJ dhe mund të ndërhyhet vetëm në kushtet e përcaktuara nga Paragrafi 2 i këtij neni; standardet e zbatuara nga autoritetet kombëtare për vlerësimin e domosdoshmërisë së kufizimit të lirisë së shprehjes duhet të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në Nenin 10, si theksohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, duke marrë parasysh, ndër të tjera, mënyrën, përmbajtjen, kontekstin dhe qëllimin e raportimit; respektimi i lirisë së gazetarisë gjithashtu nënkupton që nuk u takon gjykatave ose autoriteteve publike të imponojnë pikëpamjet e tyre në media për teknikat e raportimit që do të aplikohen nga gazetarët.

*Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (Pjesë e Këshillit të Evropës) për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*

*Rekomandimi Nr. 15 i Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*<sup>118</sup> (Rekomandimi Nr. 15) përqendrohet në luftën kundër fenomenit të gjuhës së urrejtjes dhe pasojat e dëmshme të përdorimit të saj tek individët, grupe të caktuara personash dhe shoqëria në tërësi dhe u drejtohet Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës. Pjesa operative e Rekomandimit përqendrohet në marrjen e masave nga ana e Shteteve Anëtare, si rritjen e ndërgjegjësimit publik; luftimin e çfarëdo përdorimi të gjuhës së urrejtjes; mbështetjen e personave që vihen në shënjestër nga përdorimi i kësaj gjuhe; nxitjen e vetërregullimit; marrjen e masave rregullatore; përcaktimin e përgjegjësisë administrative dhe civile; tërheqjen e mbështetjes ndaj organizatave të caktuara dhe ndalimin e të tjerave; vendosjen e sanksioneve penale në disa rrethana shumë specifike dhe të kufizuara, etj. Gjithsesi, Rekomandimi thekson se çdo përpjekje për të trajtuar gjuhën e urrejtjes nuk duhet të tejkalojë kufizimet e ligjshme të lirisë së shprehjes, si një e drejtë e njohur dhe parashikuar nga KEDNJ.<sup>119</sup> Ky Rekomandim ka ardhur në një moment deciziv për sa i përket problemeve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, të cilat janë intensifikuar me përparimin e teknologjisë. Nga monitorimet kombëtare të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, ka rezultuar se: përdorimi i tonit të vrazhdë në shumë parlamente dhe nga funksionarë shtetërorë po kontribuon në një ligjërim politik që po bëhet gjithnjë e më fyes dhe jotolerant; gjuha e koduar po përdoret gjithnjë e më shumë për të shpërndarë paragjykime dhe urrejtje; në internet tentojnë të krijohen forume që shpërndajnë gjuhën e urrejtjes ndaj grupeve të caktuara, etj.<sup>120</sup>

Ashtu si është diskutuar edhe më lart, Rekomandimet e Komisionit Evropian drejtuar Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme për secilin prej këtyre shteteve, përfshi edhe Shqipërinë. Këto rekomandime janë udhëzime pa fuqi ligjore detyruese të bëra për t'i informuar shtetet mbi mënyrat efektive të adresimit të fenomeneve të ndryshme të lidhura me racizmin dhe intolerancën. Megjithatë, ECRI i përdor këto rekomandime si parametra për monitorimin e përputhshmërisë së ligjeve dhe praktikave kombëtare me standardet e përgjithshme në fushën e luftës kundër diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes. Për më tepër, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka cituar, në mbi 100 vendime gjyqësore të saj, raportet e monitorimit të vendeve të ECRI dhe rekomandimet e politikës së përgjithshme të ECRI, si dokumente të dobishme për kuptimin e kontekstit kombëtare ose për përkufizimin e termave si gjuha e urrejtjes. Në veçanti, pjesë të caktuara të Rekomandimit të Politikës së Përgjithshme nr. 15 u cituan në vendimin gjyqësor të vitit 2018 për çështjen e Mariya Alekhina dhe të Tjerët k. Ruisë<sup>121</sup>.

Në Recitalin hyrës të Rekomandimit Nr. 15 ofrohet një version i ri përkufizimi për 'gjuhën e urrejtjes': për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së Përgjithshme, gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si avokim, inkurajim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj një personi apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha formave të mësipërme të shprehjes mbi shkaqet e racës, ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit.<sup>122</sup> Relacioni Shpjegues bashkëlidhur Rekomandimit Nr. 15 ofron një përkufizim të detajuar të termave të përdorur më sipër.<sup>123</sup> Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes sipas këtij Rekomandimi, pavarësisht se i ngjashëm me atë prezantuar në Rekomandimin Nr. R 97(20) 30.10.1997 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi Gjuhën e Urrejtjes (trajtuar më lart), duket se ofron një panoramë më të gjerë të shprehjeve që konsiderohen gjuhë e urrejtjes. Kjo mund të lidhet edhe me faktin se Rekomandimi Nr. 15 është adoptuar rreth 18 vite më vonë nga Rekomandimi Nr. R 97(20), kohë gjatë së cilës, fenomeni i gjuhës së urrejtjes ka zhvilluar dinamika të reja dhe ka marrë përmasa të tjera për shkak të zhvillimeve teknologjike, rrjedhimisht është trajtuar gjithmonë e më shumë kujdes.

<sup>118</sup> Miratuar më 8 dhjetor 2015. Për më shumë informacion lidhur me tekstin origjinal të këtij Rekomandimi, vizito: <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01>

<sup>119</sup> Për më shumë informacion lexo: Relacionin Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafi 2.

<sup>120</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafët 24-31.

<sup>121</sup> MARIYA ALEKHINA AND OTHERS v. RUSSIA (coe.int)

<sup>122</sup> Recitali i Rekomandimit të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës mbi Luftën kundër Gjuhës së Urrejtjes Nr. 15, paragrafi 6.

<sup>123</sup> Paragrafi 7, 8, 9, 10 dhe 11 i Relacionit Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes.



Ky Rekomandim, në pjesën operative të tij, fokusohet në dhjetë pika kryesore për t'u zbatuar nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës.<sup>124</sup>

1. Shtetet Anëtare rekomandohen të ratifikojnë Protokollin Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik (në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike kryer përmes sistemeve kompjuterike); Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (në lidhje me garantimin e të drejtës së barazisë para ligjit dhe mbrojtjes së barabartë të ligjit për personat që u përkasin pakicave kombëtare) dhe Protokollin Nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në lidhje me garantimin e gëzimit të çdo të drejte të përcaktuar me ligj dhe jo vetëm të drejtat dhe liritë e posaçme të garantuara nga KEDNJ), nëse nuk i kanë ratifikuar ende.
2. Shtetet Anëtare rekomandohen të tërheqin çdo rezervë lidhur me lirinë e tubimit, organizimit dhe shprehjes, parashikuar në Nenin 4 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe në Nenin 20 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe të njohin kompetencat e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor për të komunikuar me individë ose grupe individësh në përputhje me Nenin 14. Ky nen parashikon kompetencën e këtij Komiteti për të marrë dhe shqyrtuar njoftime nga individë ose grupe individësh që pretendojnë se janë viktime të shkeljes së të drejtave të parashikuara në Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, si garanci ndaj mosadresimit të gjuhës së urrejtjes në nivel kombëtar.
3. Shtetet Anëtare rekomandohen të identifikojnë kushtet që favorizojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes si fenomen dhe format e ndryshme që ajo merr, si dhe të matin shtrirjen dhe dëmin që ajo shkakton, me qëllim dekurajimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe zvogëlimin e korigjimit dhe dëmit të shkakuar. Në përputhje me sa më sipër, Shtetet Anëtare rekomandohen të marrin masa, nga të cilat më kryesoret janë: të adoptojnë mjete të besueshme për arritjen e këtyre qëllimeve, të sigurohen që ekzistojnë autoritete publike për përdorimin e këtyre mjeteve, të sigurohen që mbledhja e të dhënave mbi gjuhën e urrejtjes të mos limitohet në sektorin penal të drejtësisë, të suportojnë monitorimin e gjuhës së urrejtjes nga shoqëria civile, organet e barazisë dhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe të promovojnë bashkëpunimin midis këtyre të fundit dhe autoriteteve publike, etj.<sup>125</sup>
4. Shtetet Anëtare rekomandohen të ndërmarrin veprime për rritjen e ndërgjegjësimit publik lidhur me rëndësinë e respektimit të pluralizmit, rreziqet që vijnë nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes por edhe të demonstrojnë pavërtetësinë mbi të cilën bazohet gjuha e urrejtjes, për të dekurajuar dhe parandaluar përdorimin e saj. Shtetet Anëtare, ndër të tjera, duhet: të promovojnë nevojën për diversitet dhe dialog brenda kornizës së demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor; të promovojnë dhe ilustrojnë respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë brenda shoqërisë; të lehtësojnë dialogun ndërkulturor; të luftojnë dezinformimin, stereotipizimin dhe stigmatizimin negativ etj.<sup>126</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 sjell shembuj konkretë për rritjen e ndërgjegjësimit publik kundër gjuhës së urrejtjes, si: përkujtimi i ngjarjeve të urrejtjes së të shkuarës dhe mësimet e nxjerra (p.sh. rasti i Holokaustit); trajnimi i përshtatshëm i mësuesve dhe profesorëve lidhur me gjuhën e urrejtjes në mënyrë që të jenë në gjendje ta ofrojnë këtë lloj edukimi (në kontekstin e shkollës është e rëndësishme që ky edukim të aplikohet në mënyrën se si nxënësit e trajtojnë njëri-tjetrin); promovimi i diversitetit nëpërmjet organizimit të festivaleve të filmave, koncerteve, aktiviteteve kulinare, dramave dhe lojërave me role, ekspozitave, leksioneve dhe seminareve, projekteve të posaçme me shkollat, si dhe transmetimeve dhe publikimeve; policia dhe gjyqësori duhet ta bëjnë të ditur origjinën etnike të autorëve të dyshuar të veprave penale vetëm kur kjo është rreptësisht e nevojshme dhe kur i shërben një qëllimi legjitim, pasi nxjerrja e këtij informacioni mund të përforcojë në mënyrë të pajustificueshme paragjykimet, ndërkohë që shpallja e tyre më pas të pafajshëm mund të anashkalohet ose të mos raportohet etj.<sup>127</sup>

<sup>124</sup> Pikat më poshtë janë përmbledhje të tekstit origjinal, për te lexuar tekstin e plotë, vizito: <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01>, faqe 5-10.

<sup>125</sup> Për listën e plotë të masave, vizito Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, faqe 6.

<sup>126</sup> Ibid.

<sup>127</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafët 91-94.

5. Shtetet Anëtare rekomandohen të ofrojnë mbështetje për personat që janë në shënjestër të gjuhës së urrejtjes si individualisht ashtu edhe kolektivisht: duke u përpjekur t'i ndihmojnë përmes këshillimit dhe udhëzimit për të përballuar traumën dhe ndjenjën e turpit të pësuar; duke u siguruar që këta persona janë në dijeni të të drejtave të tyre për dëmshpërblim nëpërmjet procedurave administrative, civile ose penale dhe nuk ndalohen të praktikojnë këto mjete për shkak të frikës, mungesës së informacionit, pengesave fizike, emocionale apo mungesës së mjeteve; duke u ofruar këtyre personave mundësinë për të raportuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes, etj.<sup>128</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 sjell shembuj konkretë të mbështetjes së viktimave të gjuhës së urrejtjes, duke përmendur: konsulencën me terapistë (e cila duhet të jepet sa më shpejt të jetë e mundur); organizimi i fushatave ndërgjegjësuese që viktimat të jenë në dijeni të të drejtave të tyre, thjeshtëzimi i procedurave të ankimit nga viktimat etj.<sup>129</sup>
6. Shtetet Anëtare rekomandohen të ofrojnë mbështetje për vetë-rregullimin e institucioneve publike dhe private (përfshirë organet e zgjedhura, partitë politike, institucionet arsimore dhe organizatat kulturore e sportive) si një mjet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes, nëpërmjet veprimeve, ku nga më kryesoret mund të përmenden: të inkurajojnë miratimin e kodeve të sjelljes të përshtatshme që parashikojnë pezullimin dhe sanksione të tjera për shkelje të dispozitave të tyre si edhe kanale raportimi efektive; të inkurajojnë partitë politike që të nënshkruajnë Kartën e Partive Politike Evropiane për një Shoqëri Joraciste; të promovojnë monitorimin e dezinformimit, stereotipizimit negativ dhe stigmatizimit; të inkurajojnë dënimin në rast të shkeljeve të këtyre kodeve; etj.<sup>130</sup> Organizmat, institucionet dhe organizatat përkatëse shpesh janë konsideruar në Relacionin Shpjegues në pozitën më të mirë për të identifikuar përdorime të caktuara të gjuhës së urrejtjes dhe për të parandaluar përdorimin e tyre, qoftë me anë të dekurajimit të përdoruesve të tyre nëpërmjet bindjes, qoftë nëpërmjet dënimit të tyre nëpërmjet sanksioneve në fuqi. Në shumë raste vetërregullimi mund të jetë mënyra më e përshtatshme dhe më efektive për të adresuar gjuhën e urrejtjes. Gjithsesi, ndonëse masat vetërregulluese përjashtojnë shpesh nevojën për t'iu drejtuar formave të tjera të zgjidhjeve parashikuar me ligj, ato nuk duhet të jenë dhe nuk duhet të bëhen asnjëherë pengesë për të kërkuar forma të tjera zgjidhjesh.<sup>131</sup>
7. Shtetet Anëtare rekomandohen të përdorin pushtetin rregullator në drejtim të medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit online dhe mediat sociale) që të promovojnë veprimet në kuadër të luftës kundër gjuhës së urrejtjes, duke u siguruar njëkohësisht që masa të tilla të mos përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve si: të sigurojnë përdorim efektiv të kompetencave ekzistuese të përshtatshme për këtë qëllim, pa anashkaluar mekanizmat vetërregullatorë; të nxisin miratimin dhe përdorimin e kodeve të sjelljes të përshtatshëm dhe/ose të kushteve të përdorimit për sa i përket gjuhës së urrejtjes, si edhe të kanaleve efektive të raportimit; të inkurajojnë monitorimin dhe dënimin e përdorimit dhe përhapjes së gjuhës së urrejtjes; etj.<sup>132</sup> Termi 'media dhe interneti' përfshin median e shkruar (si gazetatat, revistat dhe librat ashtu edhe pamfletet, fletëpalosjet, posterat), por edhe mediat audiovizuale dhe elektronike (si radion, televizionin, regjistrimet dixhitale të zërit dhe figurës, faqet e internetit, aplikacionet, emailt dhe një numër të madh mediash sociale dhe videolojërë) dhe, padyshim, forma të tjera të komunikimit që mund të zhvillohen tani e tutje. Në çdo rast, Rekomandimi Nr. 15 thekson se këto masa duhet të shihen gjithmonë në dritën e respektimit të lirisë së shprehjes.
8. Shtetet Anëtare rekomandohen të specifikojnë fushën e veprimit dhe zbatueshmërinë e përgjegjësisë sipas të drejtës civile dhe administrative në rastin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes që synon apo ka pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve, ku ndër më kryesoret mund të përmenden: të përcaktojnë përgjegjësitë e veçanta të autorëve të gjuhës së urrejtjes, të ofruesve të shërbimit të internetit, të forumeve online dhe shërbimeve të hostimit, të ndërmjetësve online, të platformave të mediave sociale, të moderatorëve të blogjeve dhe të subjekteve të tjera që zhvillojnë role të ngjashme; të sigurojnë, sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohet fshirja e gjuhës së urrejtjes nga përmbajtja në internet dhe të

<sup>128</sup> Për listën e plotë të masave, vizito Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, faqe 7.

<sup>129</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafët 104-113.

<sup>130</sup> Ibid.

<sup>131</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafët 114-129.

<sup>132</sup> Ibid.

bllokohen faqet e internetit që përdorin gjuhën e urrejtjes; të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohen publikuesit e medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit online dhe platformat e medias sociale) që të publikojnë një lajmërim ku pranojnë se një material i publikuar prej tyre përbënte gjuhë të urrejtjes; të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të ndalojnë përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe të detyrojnë zbulimin e identitetit të autorëve; etj.<sup>133</sup>

9. Shtetet Anëtare rekomandohen të pezullojnë çdo mbështetje financiare dhe çdo formë ndihme nga organet publike për partitë politike dhe organizatat që përdorin gjuhën e urrejtjes apo që nuk ndëshkojnë anëtarët e tyre që e përdorin atë dhe të parashikojnë, në respektim të së drejtës së organizimit, mundësinë që të ndalojnë apo të shpërbëjnë organizatat të tilla, pavarësisht faktit nëse përfitojnë apo jo mbështetje nga organet publike, në rastet kur përdorimi prej tyre i gjuhës së urrejtjes ka për synim ose pritshmëri të arsyeshme që të nxisë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar. Pra, Pika 9 e Rekomandimit Nr. 15 parashikon një përgjigje të dyfishtë ndaj përdorimit të gjuhës së urrejtjes: *Së pari*, ndërprerja e mbështetjes ndaj organizatave që përdorin gjuhën e urrejtjes gjë shtrirje në gjithë format e përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Në këtë mënyrë mbulon jo vetëm dhënien e granteve, huave apo formave të tjera të financimit për aktivitetet e partive politike dhe organizatave të tjera të interesuara, por edhe vënien në dispozicion ndaj tyre të godinave apo hapësirave, mundësinë e përdorimit të personelit dhe çdo lloji tjetër asistence praktike.<sup>134</sup> *Së dyti*, ndalimi ose shpërbërja e këtyre organizatave është një tjetër masë kundër gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, ndalimi apo shpërndarja e një partie politike apo organizatë tjetër duhet të urdhërohet vetëm nga një gjykatë dhe urdhri në fjalë duhet të jetë subjekt i një ankimi të menjëhershëm. Respektimi i këtyre kushteve është themelor për ruajtjen e së drejtës së lirisë së tubimit dhe organizimit.<sup>135</sup>
10. Shtetet Anëtare rekomandohen të marrin masa të përshtatshme dhe efektive në të drejtën penale për luftimin e përdorimit, në sferën publike, të gjuhës së urrejtjes që ka për synim ose pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar, kur masat e tjera më pak kufizuese nuk rezultojnë efektive dhe e drejta e shprehjes dhe e fjalës të respektohet, përmes veprimeve, nga të cilat më kryesoret mund të përmenden: të sigurojnë që këto shkelje të përcaktohen qartë dhe të mbajnë parasysh nevojën për zbatimin e një sanksioni penal; të sigurojnë që fusha e veprimit e shkeljeve të tilla të përcaktohet në mënyrë që mundëson përshtatje me zhvillimet teknologjike; të sigurojnë që procedimet për këto shkelje të ngrihen mbi baza jodiskriminuese dhe të mos përdoren për të shtypur çdo kritikë ndaj politikave zyrtare, opozitën politike apo besimet fetare; të garantojnë pjesëmarrjen efektive në procedimet përkatëse të personave të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes etj.<sup>136</sup> Faktorët e rëndësishëm në një rast të posaçëm të përdorimit të gjuhës së urrejtjes të cilët tregojnë se është arritur pragu i përgjegjësisë penale evidentohen kur përdorimi në fjalë shfaq natyrë të rëndë – konkretisht, përdoret qëllimisht apo, në mënyrë të arsyeshme, parashikohet se mund të nxisë akte dhune, frikësimi, armiqësie apo diskriminimi – dhe ai zhvillohet në një kontekst publik.<sup>137</sup> Në përcaktimin dhe dhënien e penaliteteve të posaçme pas një dënimi për përdorim të gjuhës së urrejtjes, Rekomandimi identifikon dy pika të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë, konkretisht, pasojat e rënda që rrjedhin nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe parimi i proporcionalitetit.

*Rekomandimi Nr. R (97) 21 i Komitetit të Ministrave ndaj Shteteve Anëtare mbi Median dhe Promovimin e Kulturës së Tolerancës*

Rekomandimi Nr. R (97) 21 i Komitetit të Ministrave ndaj Shteteve Anëtare mbi Median dhe Promovimin e Kulturës së Tolerancës<sup>138</sup> synon të pajisë Shtetet Anëtare me shembuj jo-shtrues të praktikave profesionale

<sup>133</sup> Për listën e plotë të masave, vizito Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, faqe 8.

<sup>134</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafi 157.

<sup>135</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafi 170.

<sup>136</sup> Për listën e plotë të masave, vizito Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, faqe 9.

<sup>137</sup> Relacioni Shpjegues për Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes, paragrafi 173.

<sup>138</sup> Miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës me 30 tetor 1997..

të cilat përcjellin promovimin e kulturës së tolerancës të aplikueshme veçanërisht në sektorët e medias.<sup>139</sup> Ky rekomandim është fokusuar tek media për promovimin e kulturës së tolerancës, duke qenë se e konsideron atë si një aktor që mund të japë një kontribut pozitiv në luftën kundër intolerancës, veçanërisht ku ajo nxit një kulturë të mirëkuptimit midis grupeve të ndryshme etnike, kulturore dhe fetare në shoqërisë. Në të njëjtën kohë, Rekomandimi tregon kujdes në respektimin e parashikimeve të Nenit 10 të KEDNJ në kuadër të pavarësisë dhe autonomisë së medias.

Ky rekomandim shoqërohet nga shtojca bashkëlidhur, e cila specifikon tërësinë e veprimeve apo praktikave profesionale për t'u ndërmarrë në kuadër të promovimit të kulturës së tolerancës.

Rekomandimi Nr. R (97) 21 i drejtohet Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, lidhur me ndërgjegjësimin e subjekteve të mëposhtme brenda juridiksionit të secilit Shtet Anëtar:

- Sipërmarrjet e shtypit, radios dhe televizionit, si dhe sektorët e rinj të komunikimit dhe reklamimit;
- Trupat përfaqësuese të profesionistëve të medias në këta sektorë;
- Trupat rregullatore dhe vetë-rregullatore në këta sektorë;
- Shkollat e gazetarisë dhe institutit e trajnimit të mediave.

Gjithashtu, Shtetet Anëtare udhëzohen në kuadër të këtij rekomandimi të shqyrtojnë në një frymë pozitive çdo kërkesë për mbështetje për iniciativat e ndërmarrë në zbatim të objektivave të këtij rekomandimi.<sup>140</sup>

Lidhur me subjektet e mësipërme, Shtojca e këtij Rekomandimi përcakton praktikën profesionale të cilat nxisin promovimin e kulturës së tolerancës. Sipas kësaj Shtojce, këto praktika lidhen me:

- Trajnimet, të cilat kjo shtojcë e ndan në: Trajnim fillestar, ku shkollat e gazetarisë dhe institutet e trajnimit të medias mund të përfshijnë kurse të specializuara në kurrikulën e tyre me qëllim të zhvillimit të një sensi profesionalizmi të vëmendshëm tek përfshirja e mediave në shoqëri multietnike dhe multikulturore dhe të kontributit që mund të japë media në drejtim të mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve etnike, kulturore dhe fetare. *Trajnimit e mëtejshme*, sipërmarrjet e medias mund të sigurojnë trajnime të brendshme ose mundësi për trajnime të jashtme për profesionistët e tyre të mediave në të gjitha nivelet, lidhur me standardet profesionale mbi tolerancën dhe intolerancën.
- **Sipërmarrjet e mediave:** Problemet e intolerancës kanë nevojë për reflektim si nga publiku, ashtu edhe nga media. Sipërmarrjet e mediave mund të ndikojnë pozitivisht duke raportuar në mënyrë faktike dhe të saktë rastet e racizmit dhe intolerancës, raportuar në mënyrë të kujdesshme situatat e tensioneve ndërmjet komuniteteve të ndryshme, shmangur përshkrime stereotipizuese degraduese për anëtarët e komuniteteve kulturore, etnike apo fetare në publikime dhe programe, trajtuar një sjellje individuale pa e lidhur atë me anëtarësimin e një personi në këto komunitete, kur diçka e tillë është e parëndësishme për ngjarjen etj.<sup>141</sup>
- **Trupat përfaqësuese të profesionistëve të medias:** Trupat përfaqësuese të kategorive të ndryshme të përfaqësuesve të medias mund të iniciojnë programe apo iniciativa praktike në kuadër të promovimit të kulturës së tolerancës.
- **Kodet e sjelljes:** Iniciativat dhe veprimet e mësipërme mund të shkojnë krah për krah me kodet e sjelljes profesionale të hartuara brenda sektorëve të ndryshëm mediatikë, të cilët adresojnë problemet e diskriminimit dhe intolerancës duke inkurajuar profesionistët e medias të japin një kontribut pozitiv drejt zhvillimit të tolerancës dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet grupeve të ndryshme fetare, etnike dhe kulturore në shoqëri.
- **Transmetimet:** Ndërsa transmetuesit publike kanë një angazhim të veçantë për të promovuar kulturën e tolerancës dhe mirëkuptimit, media e transmetimit në tërësi është një forcë e fuqishme për sfidimin e intolerancës. Si shembuj duhet të shërbejnë transmetuesit të cilët: parashikojnë transmetimin e programeve, edhe gjatë kohës me shikueshmëri të lartë televizive, të cilat ndihmojnë në promovimin e integritetit të të gjithë individëve, grupeve dhe komuniteteve si dhe i dedikojnë kohë televizive proporcionale komuniteteve të ndryshme etnike, fetare dhe të tjera; kanë një qasje

<sup>139</sup> Shtojca e Rekomandimit Nr. R (97) 21 të Komitetit të Ministrave ndaj Shteteve Anëtare mbi Median dhe Promovimin e Kulturës së Tolerancës, paragrafi 1.

<sup>140</sup> Rekomandimi Nr. R (97) 21 i Komitetit të Ministrave ndaj Shteteve Anëtare mbi Median dhe Promovimin e Kulturës së Tolerancës, faqe 2.

<sup>141</sup> Për listën e plotë të praktikave që duhen ndërmarrë nga sipërmarrjet e mediave, shiko Rekomandimin Nr. R (97) 21 i Komitetit të Ministrave ndaj Shteteve Anëtare mbi Median dhe Promovimin e Kulturës së Tolerancës, faqe 2-3.

multikulturore ndaj përmbajtjes së programit duke shmangur prezantimin e shoqërisë në terma mono-kulturorë dhe mono-linguistikë etj.<sup>142</sup>

- **Reklamimet:** Shtojca e Këtij Rekomandimi thekson se megjithëse karakteri multietnik dhe multikulturor i shoqërisë konsumatore tashmë është reflektuar në reklama dhe megjithëse reklamues të caktuar bëjnë përpjekje për të përgatitur reklamat në një mënyrë e cila pasqyron një imazh pozitiv të diversitetit kulturor, fetar dhe etnik, praktika të tilla si ato të përcaktuara më poshtë mund të zhvillohen nga qarqet profesionale. Në vende të caktuara, sektori i reklamave i nënshtrohet Kodeve të Sjelljes të cilat ndalojnë diskriminimin mbi baza të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare etj.; sipërmarrje të ndryshme të medias refuzojnë të shfaqin reklama të cilat portretizojnë ndryshimet kulturore, fetare apo etnike në mënyre negative, për shembull duke përforcuar stereotipet; disa organizime publike ose private ndërmarrin fushata reklamimi për promovimin e tolerancës. Në këto raste, organet e medias mund të ftohen të bashkëpunojë në përhapjen e këtyre reklamave.

*Rekomandimi 1085 (2007) mbi blasfeminë, fyerjet fetare dhe gjuhën e urrejtjes kundër personave mbi baza të fesë*

Rekomandimi 1085 (2007) mbi blasfeminë, fyerjet fetare dhe gjuhën e urrejtjes kundër personave mbi baza të fesë<sup>143</sup> i drejtohet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me veprimtarinë e tij në kuadër të luftës kundër gjuhës së urrejtjes. Ndryshe nga rekomandimet e trajtuara më lart që i drejtoheshin në mënyrë direkte Shteteve Anëtare, ky rekomandim ka efekt të tërthortë për Shtetet Anëtare, duke qenë se i drejtohet Komitetit të Ministrave të KE. Ky i fundit, duke iu referuar rekomandimit të mësipërm, duhet të sigurohet që masat e përmendura t'u përcillen autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare. Në lidhje me blasfeminë, fyerjet fetare dhe gjuhën e urrejtjes ndaj personave për shkak të fesë së tyre, në Recitalin e tij, ky rekomandim **thekson se shteti është përgjegjës për përcaktimin e asaj që duhet të llogaritet si vepër penale brenda kufijve të vendosur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**. Në lidhje me këtë, Rekomandimi thekson se **blasfemia, si një fyerje ndaj një feje, nuk duhet të konsiderohet vepër penale**.<sup>144</sup> Gjithashtu, rekomandimi sqaron që çdo marzh vlerësimi që kanë Shtetet Anëtare lidhur me limitimin e lirisë së shprehjes dhe lirisë së ndërgjegjes e fesë, mund të jetë objekt shqyrtimi i GJEDNJ.

Rekomandimi 1805 (2007) mund të përmblihet në pikat e mëposhtme:

- Komiteti i Ministrave i KE rekomandohet të marrë në konsideratë Rezolutën 1510 (2006) mbi Lirinë e Shprehjes dhe Respektimin e Besimeve Fetare<sup>145</sup> së bashku me këtë Rekomandim dhe t'ia përcjellë të dy tekstet ministrive dhe autoriteteve përkatëse kombëtare të Shteteve Anëtare;
- Komiteti i Ministrave i KE rekomandohet që të marrë masat e duhura në mënyrë që ligjet dhe praktikat kombëtare: lejojnë debatin e hapur për çështje që lidhen me fenë dhe besimet dhe nuk privilegjojnë një fe të veçantë në këtë drejtim, çka do të ishte e papajtueshme me Nenet 10 dhe 14 të KEDNJ; kriminalizojnë deklaratat të cilat bëjnë thirrje që një person ose një grup personash t'i nënshtrohen urrejtjes, diskriminimit ose dhunës për shkak të fesë së tyre si dhe për çdo arsye tjetër; ndalojnë veprimet që prishin qëllimisht dhe rëndë rendin publik dhe bëjnë thirrje për dhunë publike duke iu referuar çështjeve fetare, për aq sa është e nevojshme në një shoqëri demokratike në përputhje me Nenin 10, paragrafi 2, të Konventës; rishikohen me qëllim që të dekriminalizojnë blasfeminë si fyerje ndaj një feje.
- Komiteti i Ministrave i KE rekomandohet të inkurajojë Shtetet Anëtare të nënshkruajnë dhe ratifikojnë Protokollin Nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS Nr. 177)<sup>146</sup>, i cili fokusohet në luftën kundër diskriminimit.
- Komiteti i Ministrave i KE rekomandohet të instruktojë komitetin drejtues kompetent që të hartojë udhëzime praktike për Ministrinë kombëtare të Drejtësisë, duke synuar të lehtësojnë zbatimin e rekomandimeve të përfshira në Pikën 2 (më lart);

<sup>142</sup> Për listën e plotë të praktikave që duhen ndërmarrë nga sipërmarrjet e mediave, shiko Rekomandimin Nr. R (97) 21 i Komitetit të Ministrave ndaj Shteteve Anëtare mbi Median dhe Promovimin e Kulturës së Tolerancës, faqe 3.

<sup>143</sup> Miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës me datë 29.06.2007.

<sup>144</sup> Paragrafi 4 i Recitalit të Rekomandimit 1085 (2007) mbi blasfeminë, fyerjet fetare dhe gjuhën e urrejtjes kundër personave, për arsye fetare.

<sup>145</sup> Për t'u njohur me tekstin e plotë të kësaj rezolute, vizito: <https://pace.coe.int/en/files/17457>

<sup>146</sup> Për t'u njohur me tekstin e plotë të Protokollit Nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vizito: [https://www.echr.coe.int/Documents/Library\\_Collection\\_P12\\_ETS177E\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Library_Collection_P12_ETS177E_ENG.pdf)

- Komiteti i Ministrave i KE rekomandohet të instruktojë komitetin drejtues kompetent që të hartojë udhëzime praktike për Ministrinë kombëtare të Arsimit që synojnë të rrisin mirëkuptimin dhe tolerancën midis studentëve me fe të ndryshme;
- Komiteti i Ministrave të KE rekomandohet të nisë, përmes Ministrive kombëtare të Jashtme, veprime në nivelin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të siguruar që: legjislacioni dhe praktika kombëtare e Shteteve Nënshkruese të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor nuk privilegjojnë persona të një feje të caktuar; si dhe Aleanca e Qytetërimeve të shmagë stereotipin e një kulture të ashtuquajtur perëndimore, duke zgjeruar fushën e veprimit të saj në fe të tjera dhe të promovojë debate më të hapura midis grupeve të ndryshme fetare dhe grupeve jo-fetare.
- Komiteti i Ministrave të KE rekomandohet të dënojë në emër të qeverive të ministrave çdo kërcënim me vdekje dhe nxitje të dhunës nga udhëheqësit dhe grupet fetare kundër personave për shkak të ushtrimit të lirisë së tyre të shprehjes lidhur me çështjet fetare.
- Komiteti i Ministrave të KE rekomandohet të **ftojë Shtetet Anëtare të marrin më shumë iniciativa për të promovuar tolerancën**, në bashkëpunim me Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës.

### 3.3.1 Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes

Autoritetet Rregullatore të Medias kanë një përgjegjësi të veçantë lidhur me shpërndarjen e gjuhës së urrejtjes. Disa nga aspektet kryesore të raportit ndërmjet këtyre autoriteteve dhe gjuhës së urrejtjes janë përmbledhur në *Publikimin Rajonal të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në kuadër të një ekspertize juridike mbi lirinë e shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore, të titulluar 'Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes'*.<sup>147</sup>

Publikimi fillimisht fokusohet në debatin e ditëve të sotme lidhur me gjuhën e urrejtjes. Theksi është vendosur në rëndësinë e lirisë së shprehjes, si një liri thelbësore jo vetëm për të shprehur ide dhe opinione, por edhe për të marrë informacion: liria e shprehjes është pjesë e demokracisë, kur ajo përfundon, nuk ka as demokraci.<sup>148</sup> Megjithatë, **liria e shprehjes**, e parashikuar nga Neni 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), **nuk është një drejtë absolute**. Ajo i nënshtrohet ndër të tjera kufizimeve të përmendura në Nenin 10(2) të KEDNJ dhe të Nenit 20 të PNDKP. Ky i fundit adreson gjuhën e urrejtjes në mënyrë më të drejtpërdrejtë, duke parashikuar ndalime ligjore për çdo propagandë për luftë apo avokimin e urrejtjes kombëtare, raciale ose fetare të cilat mund të nxisin diskriminim, armiqësi apo dhunë.<sup>149</sup> Në këtë kuadër, shoqëritë evropiane kanë përcaktuar disa limitime formale dhe jo-formale për lirinë e shprehjes duke demonstruar në këtë mënyrë angazhimin e tyre për krijimin e një stabiliteti social dhe sigurie kombëtare, pa të cilat as liria e shprehjes nuk do të ishte e mundur për t'u arritur.<sup>150</sup> Një pjesë e rëndësishme e Kodeve Penale në Evropë e trajtojnë gjuhën e urrejtjes si një vepër penale.

*Përkufizimi dhe karakteristikat e gjuhës së urrejtjes sipas Publikimit të BE dhe KE 'Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes'*

Pavarësisht se nuk ka një përkufizim të mirëpranuar gjerësisht mbi gjuhën e urrejtjes, ky publikim përmend përkufizimin e Rekomandimit R (97) 20 (diskutuar më lart), si një shembull përkufizimi gjithëpërfshirës për këtë term. Megjithatë, publikimi është i kujdesshëm të theksojë që, për shkak të kalimit të rreth 20 viteve nga miratimi i këtij rekomandimi, përkufizimit të gjuhës së urrejtjes mund t'i shtohen forma të reja. Pas analizimit të përkufizimeve të dhëna nga instrumentet të tjera dhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ, ky publikim arrin në përfundimin që gjuha e urrejtjes është "*një term që përdoret për të referuar lloje të caktuara të të shprehurit agresiv i cili shpërndan dhe justifikon urrejtjen, intolerancën dhe paragjykimin, si dhe bën thirrje dhe inkurajon*

<sup>147</sup>Për t'u njohur me tekstin e plotë të dokumentit, vizito: Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018: <https://rm.coe.int/media-regulatory-authorities-and-hate-speech/16807338f5>

<sup>148</sup>Për t'u njohur me tekstin e plotë të dokumentit, vizito: Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018.

<sup>149</sup>Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018, faqe 10.

<sup>150</sup>Ibid.

*dhunën ose diskriminimin kundër grupeve të caktuara vulnerabël apo të diskriminuara. Megjithatë, pavarësisht se prezantohet në forma të ndryshme, nga shakatë 'politikisht jokorrekte' tek thirrjet publike për linçime, verbalisht dhe joverbalisht, në të gjitha format dhe mjetet e komunikimit publik, gjuha e urrejtjes konsiderohet si një fenomen i padëshiruar i cili vendos në rrezik vlerat mbi të cilat bazohet çdo shoqëri e civilizuar dhe demokratike".<sup>151</sup>*

Që në kapitullin e parë, ky publikim thekson që, duke qenë se **çdo formë shprehjeje ndodh brenda një konteksti historik dhe kulturor, përmbajtja dhe domethënia morale e emocionale që përcjell janë të pandashme nga ky kontekst**. Për këtë arsye, një formë shprehjeje që nuk është e rrezikshme në një kontekst, mund të jetë gjuhë urrejtjeje në një kontekst tjetër. Publikimi nënvizon që gjatë analizimit të gjuhës së urrejtjes, është e rëndësishme **të përcaktohen dhe vlerësohen të gjitha rrethanat** në të cilat ka ndodhur gjuha e urrejtjes apo të cilat mendohet se do të inkurajojnë dhunë, intimidim, armiqësi apo diskriminim kundër grupeve që u drejtohet.<sup>152</sup> Është e rëndësishme të përmendet që publikimi e konsideron gjuhën e urrejtjes si një **koncept emotiv** i cili degradon, intimidon, nxit urrejtje, dhunë dhe/ose diskriminim kundër një individi a grupi. Për më tepër, gjuha e urrejtjes përpiket të përcjellë ndjenja të përbuzjes apo stereotipizimit të bazuara në konotacione negative për grupe apo individë të caktuar dhe karakteristikat e tyre.<sup>153</sup> Një nga problemet e gjuhës së urrejtjes lidhet me prezantimin e saj si gjuhë 'normale', përdoruesit e së cilës përpiqen ta trajtojnë këtë gjuhë si të pranueshme. Diçka e tillë konsiderohet **shumë e rrezikshme, duke qenë se duke toleruar gjuhën e urrejtjes, ajo mund të shndërrohet në pjesë të bisedave të pranueshme nga shoqëria**.

*Raporti i Gjuhës së Urrejtjes me Median sipas Publikimit të BE dhe KE 'Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes'*

Publikimi i mësipërm nënvizon që kur vlerësohet roli i medias në përhapjen e gjuhës së urrejtjes, më rëndësi është përcaktimi i origjinës së saj. Kjo është e vërtetë sidomos në rastet e mbulimit nga mediat të ngjarjeve të caktuara, përfshirja e shikuesve/dëgjuesve në programe, mungesa e kohës së mjaftueshme për t'u përgatitur, sidomos në rastet e ndryshimit të të ftuarve në programe në momentin e fundit etj. Gjuha e urrejtjes mund të gjendet edhe në programet e transmetuara në formën e SMS-ve, email-eve, mesazheve në Facebook dhe Twitter të dërguara nga audienca. Në rastin kur këto mesazhe transmetohen nga mediat, personat kompetentë të mediave duhet të mbajnë përgjegjësi. Sipas këtij publikimi, disa nga teknikat që një media mund të përdorë për të mos u konsideruar si përhapëse e gjuhës së urrejtjes, sipas këtij publikimi janë: përjashtimi i shikuesve/dëgjuesve të cilët përhapin gjuhën e urrejtjes, nxjerrja e një mohimi ndaj gjuhës së urrejtjes, refuzimi për t'i ofruar kohë transmetimi personave që përhapin gjuhë të urrejtjes (përfshirë politikanët dhe punonjësit publikë), publikimi i një ndjese, etj. Përgjegjësia e medias është më e drejtpërdrejtë në rastet kur në përhapjen e gjuhës së urrejtjes përfshihen vetë reporterët dhe gazetarët.<sup>154</sup> Me ritjen e përdorimit të internetit, tashmë përdoruesit mund të reagojnë publikisht duke komentuar mbi lajme apo njoftime të ndryshme. Diçka e tillë e ndërlikon edhe më shumë luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Ashtu si pohohet edhe nga ky publikim, Ballkani është përfshirë në një numër të konsiderueshëm rastesh në të cilat rregullat kundër gjuhës së urrejtjes nuk janë respektuar.

*Raste të përdorimit të gjuhës së urrejtjes në media në Shqipëri sipas Publikimit të BE dhe KE "Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes"*

Shqipëria është vendi i parë që trajtohet në këtë publikim në kuadër të rasteve të gjuhës së urrejtjes në rajon. Megjithatë, në këtë publikim, në Shqipëri është raportuar vetëm një rast i tillë, në ndryshim nga vende të tjera të rajonit të cilat, sipas këtij publikimi, kanë hasur raste më të shpeshta.<sup>155</sup>

Rasti i hasur në Shqipëri lidhet me shprehjen e drejtuesit të një program të ndjekur televiziv, i cili deklaroi se 'Çamët janë njerëz të mirë, aq të mirë sa nuk mjafton t'i vrasësh. Bëj shaka, sigurisht që ishte shaka sepse unë

<sup>151</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes , A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës,, Maj 2018, faqe 13.

<sup>152</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes , A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës,, Maj 2018, faqe 14.

<sup>153</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes , A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018, faqe 14.

<sup>154</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes , A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018, faqe 15.

<sup>155</sup> Për shembull, rastet e gjuhës së urrejtjes në media në Bosnje dhe Hercegovinë (faqe 22); Kroaci (faqe 39); Maqedonia e Veriut (faqe 45); Mali i Zi (faqe 60); Serbi (faqe 77).

vetë jam çam' si dhe 'E ke gabim, njerëzit nga Saranda nuk janë ashtu, ata janë... ok ata janë shumë të këqij, nuk të mjafton t'i vrasësh as ata, por ata nuk thonë gjë për çamët'.<sup>156</sup> Sipas këtij publikimi, monitorimi tregoi që ky program televiziv cenoi parimet ligjore që përcaktojnë se operatorët e shërbimeve audiovizuale gjatë aktivitetit të tyre nuk do të lejojnë transmetime që promovojnë intolerancë midis qytetarëve apo promovojnë dhe justifikojnë dhunën. Veprimi i drejtuesit të programit u deklarua si cenim i parimeve të mësipërme, për këtë arsye, autoriteti rregullator i medias në Shqipëri (AMA), vendosi ta trajtojë këtë çështje si 'gjuhë të urrejtjes' duke qenë se ishte e dëmshme për publikun të dëgjonte këtë lloj diskriminimi. Në kuadër të këtij vendimi, AMA caktoi një gjobë prej rreth 3000 Euro.<sup>157</sup>

*Përmbledhje e disa prej rekomandimeve dhe konkluzioneve të rëndësishme të Publikimit të BE dhe KE 'Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes'*

Ky publikim i atribuon një rëndësi të veçantë fillimisht **transparencës** së autoriteteve rregullatore të medias. Në këtë kuadër, këto autoritete duhet të jenë të kujdesshme në publikimin e rregullt dhe në kohë të vendimeve të tyre. Kjo do të nxisë publikun të besojë në efikasitetin e ankesave të tyre. Gjithashtu, publikimi i raporteve të plota dhe të detajuara nga ana e këtyre autoriteteve do të ishte në ndihmë të publikut dhe sidomos akademikëve.<sup>158</sup> **Përfshirja** është një tjetër rekomandim për autoritetet rregullatore mediatike në fund të këtij publikimi. Këto autoritete duhet të kenë komunikim direkt me qytetarët, duke trajtuar dhe iu përgjigjur çdo ankese me gatishmëri dhe respekt. Autoritetet në çdo rast duhet të informojnë ankuesit lidhur me rezultatin e ankimit të tyre, pavarësisht nëse ky rezultat është një sanksion, referim apo vendim që nuk ka shkelje. Konsultimet publike gjithashtu jo vetëm duhet të jenë të rregullta, por duhet të merren parasysh me seriozitet nga këto autoritete. Gjithashtu, për shkak të ekspertizës dhe përvojës, autoritetet rregullatore të mediave **duhet të bashkëpunojnë me institucione të tjera** në mënyrë që të kontribuojnë në adoptimin e legjislationit relevant, akteve të strategjive e politikave, raporteve ndërkombëtare në këtë fushë, etj.<sup>159</sup> Autoritetet Rregullatore të medias gjithashtu duhet të **krijojnë kushte dhe mjete** që të lejojnë çdo person që ka kontakt me informacionin të mund ta analizojë, deshifrojë dhe kuptojë atë. Në këtë kuadër, është i nevojshëm miratimi i qasjeve, politikave dhe sistemeve të reja.<sup>160</sup> Së fundmi, këto autoritete duhet të luajnë **një rol të rëndësishëm vetë-rregullator dhe bashkë-rregullator**. Këtu përfshihen kontributi që këto autoritete duhet të japin në hartimin e kodeve të sjelljes së gazetarëve, promovimi i lirisë së shprehjes së gazetarëve me kushtin që të mos kalohet në abuzim me këtë liri, rregullimi i ri që duhet aplikuar për mediat sociale, etj.

### 3.3.2 Piramida e Urrejtjes e Ligës kundër Shpifjes (ADL)

Piramida e Urrejtjes e Ligës kundër Shpifjes (ADL)<sup>161</sup> ilustron format e urrejtjes duke i vendosur në hierarki për nga rrezikshmëria që paraqesin. Ajo përqendrohet tek përhapja e paragjykimeve dhe urrejtjes në shoqëri. Piramida ofron një hierarki të niveleve të qëndrimeve dhe sjelljeve që rriten në kompleksitet nga baza në majë. Kjo piramidë është përpiluar nga Liga kundër Shpifjes (ADL) e cila është një organizatë joqeveritare hebreje e bazuar në SHBA.<sup>162</sup>

**Niveli i parë** i piramidës dhe më i ulëti për nga rrezikshmëria titullohet 'Qëndrime Paragjyuese' dhe përfshin 'stereotipizimin, frikën nga diferencat, justifikimin e paragjykimeve duke komunikuar vetëm me njerëz që mendojnë njëllë, kërkimin e informacionit për të konfirmuar besimet apo paragjykimet ekzistuese, mungesa e vetë-reflektimit ose vetëdijes për statusin e privilegjuar që gëzon dikush'.<sup>163</sup>

<sup>156</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018, faqe 21.

<sup>157</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018, faqe 21.

<sup>158</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018, faqe 85.

<sup>159</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Maj 2018, faqe 86.

<sup>160</sup> Autoritetet Rregullatore të Medias dhe Gjuha e Urrejtjes, A. Zubcevic, S. Bender, J. Vojvodic (Autorët), E. Kamenjarova, M. Todorovic, M. Tafarshiku, M. Stafa (Kontribuesit), Botimi rajonal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, Ma2018, faqe 87.

<sup>161</sup> Për të parë ilustrimin e Piramidës së Urrejtjes vizito: <https://www.adl.org/sites/default/files/documents/pyramid-of-hate.pdf>

<sup>162</sup> Për të lexuar më shumë mbi këtë organizatë, vizito: <https://www.adl.org/>

<sup>163</sup> Ibid.



**Niveli i dytë** (më lart) i kësaj piramide titullohet **'Veprime Paragjyuese'** dhe përfshin 'përdorimin e gjuhës përjashtuese, vërejtje të pandjeshme, mikroagresionet, shakatë e njëanshme dhe përçmuese, përvetësimin kulturor, shmangien dhe përjashtimin social, përdorimin e emrave ofendues, talljet, ngacmimet, përgojimet dhe epitetet, dehumanizimin'.<sup>164</sup>

**Niveli i tretë** (më lart) i kësaj piramide titullohet **'Diskriminimi Sistemik'** dhe përfshin 'Pabarazitë në drejtësinë penale, shpërndarjen e pabarabartë të burimeve të shkollave, mungesën e aksesit të barabartë në lagje apo banesa të caktuara, mundësi të pabarabarta punësimi, pabarazitë në paga, kufizimet dhe ndrydhjen e votuesve dhe përfaqësimin e pabarabartë në media'.<sup>165</sup>

**Niveli i katërt** (më lart) i kësaj piramide titullohet **'Dhuna e bazuar në paragjykim'** dhe përfshin 'kërcënimet, përdhosjen, vandalizmin, zjarrvënien, sulmet, përdhunimet, vrasjet dhe terrorizmin'.<sup>166</sup>

**Niveli i pestë** (maja e piramidës) titullohet **'Genocidi'**, përbën formën më ekstreme të manifestimit të urrejtjes bazuar në paragjykim, dhe përfshin 'aktin ose qëllimin për të asgjësuar qëllimisht dhe sistematikisht një popull të tërë.'

Ashtu si një piramidë, nivelet e sipërme mbështeten nga nivelet e ulëta. Paragrafi shpjegues i kësaj piramide sqaron se paragjykimi në çdo nivel ndikon negativisht tek individët, institucionet dhe shoqëria dhe bëhet gjithnjë e më e vështirë të sfidohet e shpërbëhet me përshkallëzimin e sjelljeve dhe ngjitjen lart në piramidë. Kur paragjykimi nuk shpërbëhet, ai "normalizohet" dhe kontribuon në pranimin e diskriminimit, urrejtjes dhe padrejtësisë në shoqëri. Edhe pse jo çdo qëndrim apo veprim i njëanshëm çon në genocid, çdo genocid është ndërtuar mbi pranimin e qëndrimeve dhe veprimeve të përshkruara në nivelet më të ulëta të piramidës. Në paragrafin shpjegues të Piramidës së Urrejtjes është theksuar se nëse kundërshtohen qëndrimet dhe sjelljet e njëanshme tonat, të të tjerëve dhe të institucioneve, mund të ndërpresim paragjykimet dhe të vështirësojmë përshkallëzimin e diskriminimit dhe urrejtjes.

### 3.3.3 Praktika Gjyqësore e GJEDNJ lidhur me gjuhën e urrejtjes

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) i ka kushtuar një rëndësi të veçantë çështjeve të lidhura me lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes nëpërmjet jurisprudencës së saj voluminoze. Në rastet kur është konstatuar përdorimi i gjuhës së urrejtjes, GJEDNJ ka justifikuar kufizimin e lirisë së shprehjes nëpërmjet dy formave (ashtu si është analizuar në këtë studim). Në rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, liria e shprehjes e parashikuar nga Neni 10(1) i KEDNJ kufizohet nga GJEDNJ në dy mënyra: *Së pari*, kjo gjuhë e urrejtjes përjashtohet nga mbrojtja e Konventës, duke aplikuar Nenin <sup>167</sup> të KEDNJ (Ndalimi i Shpërdorimit të të Drejtave), kur gjuha e urrejtjes mohon vlerat themelore të Konventës. *Së dyti*, në rast se gjuha e urrejtjes nuk provohet që mohon vlerat themelore të Konventës, ajo sërish kufizohet në aplikim të Nenit 10(2) të KEDNJ<sup>168</sup>. Në këtë rast, gjuha nën hetim në shumë raste i është nënshtruar 'testit me tre hapa' të përdorur nga GJEDNJ për të përcaktuar nëse do të kufizohet sipas Nenit 10(2) apo jo. Ky test do të diskutohet më poshtë.

GJEDNJ ka pranuar se ekziston **detyrimi pozitiv** për Shtetet Anëtare që të mbrojnë personat e shënjestruar nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj çdo dhune apo cenimi të të drejtave të tyre që mund të nxiten te të tjerët.<sup>169</sup> Ndër të tjera, Gjykata ka pranuar se mospërgjigjja për shprehjet fyese, veçanërisht në formën e stereotipizimit negativ ndaj një grupi të caktuar personash mund të përbëjë shkelje të detyrimit pozitiv edhe

<sup>164</sup> Ibid.

<sup>165</sup> Ibid.

<sup>166</sup> Ibid.

<sup>167</sup> Neni 17 i KEDNJ parashikon që: Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

<sup>168</sup> Neni 10(2) i KEDNJ parashikon që: 'Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.'

<sup>169</sup> Ouranio Toxo dhe të tjerë kundër Greqisë, Vendimi Nr. 74989/01, datë 20.10.2005.

sipas Nenit 8 për të siguruar respektimin efektiv të së drejtës së jetës private të një pjesëtari të këtij grupi.<sup>170</sup>

Lista e gjykimeve të mëposhtme që do të trajtohen në kuadër të këtij studimi është joshteruese, megjithatë, studimi synon të identifikojë disa nga standardet më të rëndësishme të vendosura nga GJEDNJ lidhur me gjuhën e urrejtjes.

#### *Përfashtimi gjuhës së urrejtjes nga mbrojtja e KEDNJ në përputhje me Nenin 17*

Zakonisht, GJEDNJ ka gjetur të aplikueshëm Nenin 17 të KEDNJ në rastet kur gjuha e urrejtjes ka qenë haptazi flagrante dhe e rrezikshme. Një shembull tipik i aplikimit të nenit 17 të KEDNJ është rasti kur gjuha e përdorur **promovon terrorizmin**. Kështu, në çështjen *ROJ TV A/S kundër Danimarkës*<sup>171</sup>, një media daneze ishte ndëshkuar me gjobë dhe heqje të licencës për shkak se përgjatë disa viteve kishte promovuar Partinë e Punëtorëve të Kurdistanit, e cila sipas legjislacionit danez dhe qëndrimeve të mëparshme të GJEDNJ konsiderohej një organizatë terroriste. Gjykata, në vlerësimin e saj, mori parasysh këto elemente: së pari, *natyrën e programeve në fjalë*, të cilat përfshinin nxitje të dhunës dhe mbështetje të veprimtarisë terroriste, elemente të shqyrtuara gjerësisht nga gjykatat kombëtare, së dyti, faktin që pikëpamjet e shprehura atje *u shpërndanë në një audiencë të gjerë* përmes transmetimit televiziv dhe, së treti, faktin që programet lidheshin drejtpërdrejt me një çështje që është thelbësore në shoqërinë moderne evropiane - parandalimin e terrorizmit dhe shprehjet e lidhura me terrorizmin që mbrojnë përdorimin e dhunës. Për këtë arsye, Gjykata vendosi rrëzimin e aplikimit bazë të Nenit 17 të Konventës, duke përjashtuar mbrojtjen e dhënë nga Neni 10 i saj.<sup>172</sup>

**Përhapja e shprehjeve të urrejtjes etnike** është gjithashtu një rast tipik i përjashtimit nga mbrojtja e Konventës. Në çështjen *Ivanov kundër Rusisë*<sup>173</sup>, ankuesi kishte shkruar dhe publikuar artikuj të cilët konsideronin hebretë si burimin e së keqes në Rusi, duke bërë thirrje për përjashtimin e tyre nga jeta sociale. Lidhur me këtë çështje, gjykata kombëtare ruse e deklaroi ankuesin fajtor për nxitje të urrejtjes racore, kombëtare dhe fetare dhe e ndaloi të merrej me gazetari, botim dhe shpërndarje në masmedia për një periudhë tre-vjeçare. Lidhur me sa më sipër, GJEDNJ vendosi që liria e tij e fjalës në këtë rast ishte përjashtuar nga mbrojtja e Konventës, duke qenë se ky sulm kaq i drejtpërdrejtë dhe i ashpër i drejtuar kundër një grupi etnik bie ndesh me vlerat e Konventës, si toleranca, paqja sociale dhe mosdiskriminimi.<sup>174</sup>

Gjykata ka konsideruar të përjashtuar nga mbrojtja e Konventës edhe çdo formë shprehjeje që ka në thelb urrejtjen racore. Në çështjen *Glimmerveen dhe Hagenbeek kundër Holandës*,<sup>175</sup> ankuesit ishin dënuar nga autoritetet kompetente të Holandës për shkak se kishin shpërndarë fletëpalosje të adresuara kundrejt 'holandezëve të bardhë' duke u shprehur se: 'Pjesa më e madhe e popullsisë sonë prej kohësh është lodhur nga prania në vendin tonë e qindra mijëra shtetasish Surinamë, Turq dhe të tjerë të ashtuquajtur 'punëtorë të ftuar', të cilët për më tepër nuk janë aspak të nevojshëm këtu, dhe... autoritetet duhet të kujdesen që këta të huaj të padëshiruar të largohen vendi ynë sa më shpejt të jetë e mundur'. Edhe në këtë rast, aplikimi u konsiderua i papranueshëm, duke qenë se Neni 17 i KEDNJ nuk lejon përdorimin e Nenit 10 të KEDNJ (Liria e Shprehjes) për të shpërndarë ide të cilat janë diskriminuese për shkak të racës.<sup>176</sup>

**Urrejtja fetare**, për të njëjtat arsye si më lart, nuk do të konsiderohet gjuhë e mbrojtur, në përputhje me Nenin 17 të KEDNJ. Në çështjen *Noorwood kundër Mbretërisë së Bashkuar*,<sup>177</sup> ankuesi kishte shfaqur jashtë dritares së tij një poster me Kullat Binjake në flakë, shoqëruar me shprehjen 'Islami jashtë Britanisë-Mbroni popullin britanik'. Si rezultat, ishte dënuar nga autoritetet kompetente britanike për urrejtje fetare. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata deklaroi ankimin e tij të papranueshëm, duke qenë se 'një sulm i tillë i përgjithshëm, i ashpër kundër një grupi fetar, që lidh grupin në tërësi me një akt të rëndë terrorizmi, është i papajtueshëm me vlerat e proklamuar dhe të garantuara nga Konventa, veçanërisht me tolerancën, paqen shoqërore dhe

<sup>170</sup> Për më shumë informacion, vizito Rekomandimin Nr.15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes miratuar më 8 dhjetor 2015, paragrafi 40:

: <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech-alba/16809eb58e>

<sup>171</sup> Vendimi rr. 24683/14 date 24 maj 2018: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-183289%22%7D>

<sup>172</sup> Ibid. Paragrafi 47 i vendimit.

<sup>173</sup> Vendimi nr. 35222/04, datë 20.02.2007: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-79619%22%7D>

<sup>174</sup> Ibid. paragrafi 1.

<sup>175</sup> Vendimi nr. 8348/78 dhe 8406/78, datë 11.10.1979: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-74187%22%7D>

<sup>176</sup> Ibid. Faqe 10.

<sup>177</sup> Vendimi nr. 23131/03 datë 16.11.2004:

<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22dmdocnumber%22:%5B%22708788%22%7D%22itemid%22:%5B%22001-67632%22%7D%7D>

mosdiskriminimin. Shfaqja e posterit në dritaren e ankuesit përbën një akt në kuptimin e Nenit 17, dhe për këtë arsye, nuk gëzon mbrojtjen e Neneve 10 ose 14<sup>178</sup>

**Veprimet e urrejtjes që përbëjnë kërcënime ndaj rendit demokratik** gjithashtu janë objekt i Nenit 17 të KEDNJ. Kështu, në çështjen *Schimanek kundër Austrisë*,<sup>179</sup> ankuesi, si drejtues i një shoqate, midis të tjerash, kishte realizuar këto aktivitete: organizim eventesh të veçanta ku anëtarët e shoqatës njiheshin me një pamje historike që glorifikonte diktatorët e Rajhut të Tretë, ushtrinë e tij, forcat SA dhe SS, duke mohuar në të njëjtën kohë vrasjen sistematike me përdorimin e gazit toksik nën regjimin Nacional Socialist. Gjithashtu ankuesi kishte organizuar shpërndarjen e pamfleteve me përmbajtje të ngjashme. Më tej, u zbulua se ankuesi kishte organizuar në fund të vitit 1987 kampe trajnimi paraushtarake duke mobilizuar anëtarë të shoqatave të ndryshme të organizuara në të djathtën ekstreme për të forcuar ndjenjën e solidaritetit midis pjesëmarrësve, për t'i përgatitur taktikisht për konflikte të dhunshme dhe për të ngritur një kuadër ushtarak që mund të impononte, nëse do ishte e nevojshme me përdorimin e forcës, qëllimet e tij, përkatësisht marrjen e pushtetit në Austri dhe inkorporimin e Austrisë në një Gjermani të Madhe. Sa më sipër, ankuesi pretendoi (ndër të tjera) edhe shkeljen e lirisë së fjalës nga autoritetit austriake. Lidhur me këtë rast, Gjykata vendosi që Neni 10 i Konventës nuk mund të thirret në një kuptim në kundërshtim me Nenin 17, i cili avokon për tolerancë, paqe shoqërore dhe mosdiskriminim.<sup>180</sup>

#### *Kufizimi i gjuhës së urrejtjes në bazë të Nenit 10(2) të KEDNJ*

Neni 10(2) i KEDNJ parashikon rastet e përjashtimeve të mbrojtjes së lirisë së shprehjes, dhe aplikohet në rastet të cilat, edhe pse nuk konsiderohen 'jashtë sferës së mbrojtjes së Konventës' në përputhje me Nenin 17 të saj, sërish janë problematike. Ashtu si GJEDNJ është shprehur në shumë raste, për të përcaktuar nëse ky paragraf është i aplikueshëm, duhet të kalohet nëpër 'testin me tre hapa'. Testi me tre hapa përfshin përgjigjen ndaj tre pyetjeve: 1. A është parashikuar kufizimi i lirisë së shprehjes nga legjislacioni kombëtar? 2. Kufizimi i lirisë së shprehjes ka ndodhur për arsyet legjitime të përcaktuara në Nenin 10? 3. A është kufizimi i lirisë së shprehjes i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të arritur një ose më shumë nga qëllimet legjitime të përmendura në nenin 10?<sup>181</sup> Nëse përgjigjet për të trija pyetjet në mënyrë kumulative janë 'Po', atëherë kufizimi i lirisë së shprehjes është legjitim.

Kufizimi i lirisë së shprehjes është gjetur legjitim në rastet e **justifikimit të dhunës apo nxitjes së armiqësisë**. Në çështjen *Altıntaş kundër Turqisë*<sup>182</sup> ankuesi kishte publikuar një artikull në gazetën e tij në vitin 2007 duke i përshkruar autorët e 'ngjarjeve të Kizildere' ndërmjet të tjerash si 'idhuj të rinisë'. Ngjarjet në fjalë kanë ndodhur në Mars 1972, kur tre shtetas britanikë që punonin për NATO-n u rrëmbyen dhe ekzekutuan nga rrëmbyesit e tyre. Gjykatat kombëtare e gjetën ankuesin fajtor për glorifikimin e autorëve të këtij krimi. Lidhur me këtë çështje, GJEDNJ nuk gjeti shkelje të Nenit 10 nga ana e Turqisë. Shprehjet e artikullit lidhur me autorët e 'ngjarjeve të Kizildere' dhe veprimet e tyre, mund të kuptohet që glorifikojnë ose të paktën justifikojnë dhunën. Gjykata mori parasysh edhe masën e marrë ndaj ankuesit e cila ishte gjobë. Për më tepër, Gjykata theksoi se është e rëndësishme të mos anashkalohet rreziku që shkrime të tilla mund të inkurajojnë ose nxisin të rinjtë, sidomos anëtarët dhe simpatizantët e organizatave të jashtëligjshme, të kryejnë akte të ngjashme dhune me qëllimin për t'u kthyer në 'idhuj të rinisë'.<sup>183</sup>

**Gjuha homofobe e urrejtjes** gjithashtu konsiderohet si një rast abuzimi me lirinë e shprehjes, duke legjitimuar aplikimin e Nenit 10(2). Në çështjen *Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë*, ankuesit ishin ndëshkuar nga autoritetet kombëtare për shpërndarjen e fletëpalosjeve ofenduese për homoseksualët pranë një shkolle të mesme. Deklaratat në fletëpalosje përfshinin pretendimet se homoseksualiteti ishte një 'prirje seksuale deviante', kishin 'efekti moralisht shkatërrues për shoqërinë' dhe ishte 'përgjegjës për përhapjen e HIV dhe AIDS'. GJEDNJ fillimisht përcaktoi se kushti i, parashikimit në legjislacion të kufizimit' aplikohet në këtë rast, duke qenë se Kodi Penal i Suedisë parashikonte shprehimisht një vepër të tillë si vepër penale. Lidhur me kushtin e 'nevojës së kufizimit në një shoqëri demokratike', Gjykata mori parasysh disa elementë. Së pari, ajo ritheksoi se liria e shprehjes është e zbatueshme jo vetëm për "informacionin" ose "idetë" që janë pranuar në

<sup>178</sup> Ibid, faqe 2.

<sup>179</sup> Vendimi nr. 32307/96 datë 01.02.2000: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-24075%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-24075%22]})

<sup>180</sup> Ibid.

<sup>181</sup> Për më tepër informacion në lidhje me Testin me tre hapa, vizito: <https://rm.coe.int/168071e53e>

<sup>182</sup> Vendimi nr. 50495/08 datë 10.07.2020: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-201897%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-201897%22]})

<sup>183</sup> Ibid.

shoqëri ose konsiderohen si jo fyese, por gjithashtu edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë.<sup>184</sup> Megjithatë, Gjykata nënvizoi se '...megjithëse këto deklarata nuk rekomandojnë drejtpërdrejt që individët të kryejnë veprime të urrejtjes kundër homoseksualëve, ato janë akuza serioze dhe paragjyquese.'<sup>185</sup>

Sipas Gjykatës, **nxitja e urrejtjes nuk do të thotë domosdoshmërisht thirrje për të kryer një akt dhune ose veprime të tjera kriminale**. Sulmet ndaj personave të kryera nëpërmjet fyerjes, përqeshjes ose shpifjes kundër grupeve specifike të popullsisë mund të jenë të mjaftueshme që autoritetet të favorizojnë luftën kundër shprehjeve raciste përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në një mënyrë të papërgjegjshme.<sup>186</sup> Proporcionaliteti i ndëshkimit është gjithashtu një tregues i rëndësishëm në analizën e kufizimit të lirisë së shprehjes. Duke qenë se ankuesit nuk ishin dënuar me burgim, masa administrative e marrë ndaj tyre ishte proporcionale.

**Nxitja e urrejtjes etnike** është konsideruar si një rast tipik i legjitimitetit të kufizimeve ndaj lirisë së shprehjes. Në çështjen *Balsytė-Lideikienė kundër Lituaniės*<sup>187</sup> ankuesja kishte publikuar dhe shpërndarë 'Kalendarin Lituanez 2000', i cili, sipas konkluzioneve të ekspertëve të shkencave politike, promovonte urrejtje etnike. Kalendarit përshkruante në shumë data të tij ngjarje vrasjesh ndaj lituanezëve për të cilat fajësonte shtetasit polakë, rusë dhe hebre. Kopertina e pasme e 'Kalendarit Lituanez 2000' përmbante një hartë të Republikës së Lituaniės. Territoriet fqinje të Republikës së Polonisë, Federatës Ruse dhe Republikës së Bjellorusisë ishin shënuar si 'toka etnike Lituaneze nën okupim të përkohshëm'. Autoritetet kompetente kombëtare kishin konfiskuar kopjet e mbetura dhe nuk kishin lejuar shpërndarjen e mëtejshme të kalendarit. Lidhur me këtë çështje, Gjykata gjeti se ankuesja kishte shprehur një nacionalizëm dhe etnocentrizëm agresiv, si dhe shprehje urrejtjeje kundër polakëve dhe hebrenjve që mund të përbënin shkak për shqetësim të autoriteteve lituaneze. GJEDNJ fillimisht përcaktoi se kushti i 'parashikimit të kufizimit me ligj' aplikohet në këtë rast, duke qenë se Kodi i Kundërvajtjeve Administrative të Lituaniės parashikonte shprehimisht një vepër të tillë si kundërvajtje administrative.<sup>188</sup> Për sa i përket kushtit të ekzistencës së një qëllimi legjitim në kufizimin e lirisë së shprehjes, Gjykata nënvizoi se ndëshkimi është vendosur për të mbrojtur vlerat e përcaktuara në Nenin 10(2) të Konventës, në veçanti reputacionin dhe të drejtat e grupeve etnike që jetojnë në Lituani.<sup>189</sup> Lidhur me kushtin e 'nevojës së kufizimit në një shoqëri demokratike', Gjykata nënvizoi që gjykatat kombëtare vunë re reagimin negativ që mori publikimi nga një pjesë e caktuar e shoqërisë lituaneze dhe disa ambasada të huaja. Ato gjithashtu morën në konsideratë konkluzionet e ekspertëve se deklaratat e ankueses mund t'i atribuoheshin "ideologjisë së nacionalizmit ekstrem", e cila promovonte urrejtjen kombëtare, ksenofobinë dhe pretendimet territoriale.<sup>190</sup> Në përfundim, masa e marrë nga autoritetet kombëtare lituaneze u pranua si në përputhje me parashikimet e nenit 10 të Konventës.

Gjykata ka trajtuar me kujdes edhe rastet e **gjuhës së urrejtjes në internet**. Në çështjen *Delfi AS kundër Estoniės*<sup>191</sup>, shoqëria ankuese, një nga portalet më të mëdha të lajmeve në Estoni që i bazon të ardhurat nga reklamat, në lajmet që postonte, ofronte mundësinë e komenteve anonime apo duke përdorur pseudonime. Megjithatë, ekzistonte një sistem njoftimi: çdo lexues mund të shënonte një koment si fyes dhe komenti do të fshihej nga portali. Për më tepër, komentet që përfshinin fjalë vulgare fshiheshin automatikisht. Përveç kësaj, viktimat e komenteve shpifëse mund të njoftonin drejtpërdrejt shoqërinë që menaxhonte portalin (shoqëria ankuese) dhe në këtë rast komenti fshihej. Shoqëria ankuese kishte bërë përpjekje për të këshilluar përdoruesit se komentet nuk pasqyronin mendimin e saj dhe se autorët e komenteve ishin përgjegjës për përmbajtjen e tyre. Më 24 janar 2006, shoqëria ankuese publikoi një artikull në portalin Delfi nën titullin "SLK shkatërroi Rrugën e Akullit të Planifikuar". Rrugët e akullit janë rrugë publike mbi detin e ngrirë të cilat lidhin territorin Estonez me disa ishuj në dimër. SLK është një shoqëri që ofron shërbime të transportit publik nëpërmjet trageteve midis tokës estoneze dhe ishujve të caktuar. Në kohën që u publikua, artikulli gjeneroi 185 komente, rreth 20 prej tyre përmbanin kërcënime personale dhe gjuhë fyese drejtuar njërit prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të SLK. Me kërkesën e skuadrës së avokatëve të SLK, portali fshiu komentet gjashtë javë nga publikimi i tyre. Së pari GJEDNJ vuri në dukje realitetet kontradiktore midis përfitimeve të internetit, si platforma e paprecedentë për lirinë e shprehjes dhe nga ana tjetër rreziqet, si për shembull mundësia që gjuha

<sup>184</sup> Ibid. Paragrafi 53.

<sup>185</sup> Ibid. Paragrafi 54.

<sup>186</sup> Ibid. Paragrafi 55.

<sup>187</sup> Vendimi nr. 72596/01 datë 04.02.2009: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-89307%22%5D%7D>

<sup>188</sup> Ibid. Paragrafi 72.

<sup>189</sup> Ibid. Paragrafi 73.

<sup>190</sup> Ibid. Paragrafi 80.

<sup>191</sup> Vendimi nr. 64569/09 datë 16.06.2015: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-155105%22%5D%7D>

e urrejtjes dhe gjuha që nxit dhunë mund të shpërndahen në të gjithë botën brenda sekondash dhe të qëndrojnë gjatë online. Gjykata theksoi se natyra e paligjshme e komenteve në fjalë kishte të bënte me faktin se këto komente nxisnin urrejtje ose dhunë ndaj pronarit të shoqërisë së trageteve. Në raste të tilla kur komentet e përdoruesve si palë të treta janë në formën e gjuhës së urrejtjes dhe kërcënimeve të drejtpërdrejta ndaj integritetit fizik të individëve, Gjykata nënvizoi se **për të respektuar të drejtat dhe interesat e të tjerëve dhe të shoqërisë si një e tërë, Shtetet Anëtare mund të bëjnë përgjegjës portalet e lajmeve në Internet, pa kundërshtuar Nenin 10 të Konventës, nëse ata nuk arrijnë të marrin masa për të hequr komente qartësisht të paligjshme pa vonesë, edhe pa njoftim nga viktimat e pretenduar ose nga palët e treta.** Sa më sipër, pamjaftueshmëria e masave të marra nga shoqëria ankuese për të hequr pa vonesë komentet e publikimit që përbëjnë gjuhë urrejtjeje dhe gjuhë që nxit dhunën si dhe proporcionaliteti i sanksionit (320 euro) i vendosur ndaj kompanisë aplikuese, bënë Gjykatën të konkludojë se konstatimi i përgjegjësisë ndaj shoqërisë aplikuese kishte qenë një kufizim i justifikuar dhe proporcional i lirisë së shprehjes.

Në çështjen *Aksu kundër Turqisë*<sup>192</sup>, dy ankuesit (në ankime të ndara) iu drejtuan GJEDNJ-së lidhur me disa veprime të autoriteteve publike të shtetit turk. Në rastin e ankimit të parë, Ministria e Kulturës e Turqisë kishte publikuar dhe shpërndarë librin, *Ciganët e Turqisë*, në të cilin, ndër të tjera, shkruhej se ciganët ishin të përfshirë në aktivitete të paligjshme dhe jetonin si 'hajdutë, grabitës, fajdexhinj, lypës, shpërndarës droge, prostituta' etj. Ankuesi, një shtetas Rom, e gjeti këtë informacion diskriminues. Në rastin e ankimit të dytë, një tjetër shtetas Rom i Turqisë akuzoi shtetin turk për botimin e dy fjalorëve të gjuhës turke i cili përfshinte ndër të tjera këto përkrahje: *Tendë cigane- një vend i varfër dhe i pisët; dasmë cigane-një takim i zhurmshëm dhe shumë i populluar; luftim cigan-një shkëmbim fjalësh vulgare, etj.* Lidhur me këto ankime, GJEDNJ u shpreh (ndër të tjera) edhe për gjuhën e urrejtjes, duke përcaktuar se në këtë rast, Gjykata duhet të balancojë të drejtën e ankuesit për jetë private (Neni 8) përballë interesit publik për mbrojtjen e lirisë së shprehjes (Neni 10), duke mbajtur parasysh që nuk ka një hierarki ndërmjet këtyre dy neneve. Sipas Nenit 10 të Konventës, Shtetet Anëtare kanë një marzh të caktuar vlerësimi për të përcaktuar nëse një ndërhyrje në lirinë e shprehjes është "e nevojshme në një shoqëri demokratike." Sidoqoftë, kjo diferencë shkon paralelisht me një mbikëqyrje evropiane, duke përqafuar Konventën dhe vendimet që zbatohen atë.<sup>193</sup> Në këtë rast, duke respektuar marzhin e vlerësimit të shtetit, Gjykata vendosi që nuk kishte cenim të Nenit 8.

## 3.4 Konteksti Kombëtar mbi gjuhën e urrejtjes në Shqipëri

### 3.4.1 Legjislacioni Shqiptar mbi Gjuhën e Urrejtjes

#### *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (KRSH)<sup>194</sup> nuk parashikon në mënyrë të shprehur termin 'gjuhë e urrejtjes'. Megjithatë, nëpërmjet **parimeve** që përcakton, është e qartë që gjuha e urrejtjes është e papranueshme dhe e patolerueshme në nivel parimesh kushtetuese në Shqipëri. Që në Preambulë kjo Kushtetutë shprehet për *'garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, për paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror... me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit.'*

Në vijim të këtij qëndrimi, Kushtetuta parashikon në **Pjesën e Parë (Parime Themelore)** se: *"...dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, ... bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë."*<sup>195</sup> Në këtë nen përcaktohet **detyrimi pozitiv** i shtetit në mbrojtje të dinjitetit, të drejtave të njeriut, bashkëjetesës dhe mirëkuptimit të shqiptarëve. Sërish në Pjesën e Parë, kjo Kushtetutë thekson se **urrejtja apo nxitja e saj është e papranueshme**, duke parashikuar që partitë politike dhe organizatat e tjera, programet dhe veprimtaria e të cilave mbështeten në metoda totalitariste, që nxitin e përkrahin **urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike...** janë të ndaluara sipas ligjit.<sup>196</sup>

<sup>192</sup> Vendimi nr. 4149/04 dhe 41029/04 datë 15.03.2015.

<sup>193</sup> Ibid. Paragrafi 65.

<sup>194</sup> Ligji Nr. 8417, datë 22.11.1998 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë'.

<sup>195</sup> Neni 3 i KRSH.

<sup>196</sup> Neni 9(2) i KRSH.

**Pjesa e dytë e Kushtetutës së RSH** i dedikohet të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Një dispozitë me rëndësi për t'u përmendur në këtë kuadër është **Neni 17 i Kushtetutës**, i cili i atribuon një **status të veçantë dhe superior KEDNJ-së** në krahasim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Ky nen, në paragrafin 2, parashikon që kufizimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese **nuk mund të cenohet thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalohet kufizimet e parashikuara në KEDNJ**. Pra, për sa i përket kufizimit të të drejtave kushtetuese, KEDNJ qëndron në majën e hierarkisë të burimeve të së drejtës, së bashku me Kushtetutën. Pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të KEDNJ në sistemin ligjor shqiptar, edhe praktika gjyqësore e GJEDNJ lidhur me trajtimin e gjuhës së urrejtjes apo me rastet kur kufizimi i kësaj gjuhe përbën cenim apo jo të lirisë së shprehjes, është esenciale për t'u referuar nga autoritetet kombëtare shqiptare. Në të njëjtën Pjesë, Kushtetuta e RSH parashikon parimin e mosdiskriminimit,<sup>197</sup> parimin e barazisë së pakicave kombëtare,<sup>198</sup> liria e ndërgjegjes dhe fesë<sup>199</sup> etj.

Të gjitha këto parime të mbrojtura nga Kushtetuta do të binin ndesh me çfarë përcjell gjuha e urrejtjes. Për këtë arsye, pavarësisht se termi 'gjuhë e urrejtjes' nuk përmendet shprehimisht në këtë Kushtetutë, kjo e fundit përcakton të gjitha parimet për të luftuar fenomene si gjuha e urrejtjes. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërdrejt, me përjashtim të rasteve kur kjo Kushtetutë parashikon ndryshe.<sup>200</sup> Për këtë arsye, autoritetet shqiptare mund t'i referohen drejtpërdrejt (edhe) parimeve kushtetuese të mësipërme në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.

Nga ana tjetër, një parim me rëndësi që duhet pasur parasysh në shqyrtimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes është liria e shprehjes. Ajo parashikohet nga Neni 22 i KRSH, nën kapitullin e 'Lirive dhe të drejtave vetjake'. Ky nen parashikon që: "1. Liria e shprehjes është e garantuar. 2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. 3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohej." Liria e shtypit, radios dhe televizionit është vetëm një nga nënlojet e lirisë së shprehjes. Megjithatë, Kushtetuta e RSH i jep rëndësi të veçantë duke e përmendur në mënyrë specifike në Nenin 22(2) të saj. Pavarësisht se Neni 22(3) nuk parashikon raste kufizimi të kësaj të drejte, Neni 22 i nënshtrohet rregullit për kufizimet e parashikuara në Nenin 17(2), siç u diskutua më lart. Liria e shprehjes lidhet ngushtë edhe me të drejta të tjera kushtetuese, si liria e informimit, e konsideruar nga GJEDNJ edhe si pjesë përbërëse e lirisë së shprehjes. Kjo liri është parashikuar në Nenin 23 të Kushtetutës së RSH. Ky nen parashikon që: "1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive".

#### *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*

*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (KP)*<sup>201</sup> adreson veprat penale që lidhen me gjuhën e urrejtjes në disa nene të tij. Ky kod **nuk bën një përkufizim të 'gjuhës së urrejtjes'**, për këtë arsye, në përmbledhjen më poshtë janë përfshirë nenet të cilat adresojnë gjuhën e urrejtjes nëpërmjet një interpretimi literal, por edhe nene të tjera të cilat nëpërmjet një interpretimi më të zgjeruar dhe kontekstual të termit 'gjuhë e urrejtjes' janë me rëndësi të analizohen.

Së pari, **Neni 74/a i KP** parashikon që **ofrimi në publik ose shpërndarja** e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, **e materialeve, që mohojnë, minimizojnë, në mënyrë të ndjeshme, miratojnë ose justifikojnë akte, që përbëjnë genocid ose krim kundër njerëzimit**, dënohet me burgim tre deri në gjashtë vjet. Pavarësisht se vetë kjo dispozitë nuk përdor termin 'gjuhë urrejtjeje', nga një interpretim i këtij neni dhe i përkufizimeve që ekzistojnë për gjuhën e urrejtjes, është e qartë që kuptimet mbivendosen. Megjithatë, koncepti i 'gjuhës së urrejtjes' është më i gjerë se objekti i veprës penale të parashikuar në këtë nen. Masa e dënimit e parashikuar për këtë veprë penale dëshmon për nivelin e lartë të rrezikshmërisë sociale që paraqet përdorimi i gjuhës së urrejtjes, sidomos në rastet e miratimit apo justifikimit të genocidit apo krimeve kundër njerëzimit.

Gjuha e urrejtjes, për shkak të rrezikshmërisë sociale që mbart, trajtohet edhe në seksionin e veprave penale kundër rendit dhe sigurisë publike të KP. **Neni 265** i këtij Kodi, nën titullin 'Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve', parashikon që **nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve**, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe **përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla**, e kryer me çdo

<sup>197</sup> Neni 18 i KRSH.

<sup>198</sup> Neni 20 i KRSH.

<sup>199</sup> Neni 24 i KRSH.

<sup>200</sup> Neni 4(3) i KRSH.

<sup>201</sup> Ligji Nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Nisur edhe nga masa ashpër e dënimit, KP pasqyron rrezikshmërinë e lartë sociale që ka konsumimi i kësaj vepre penale. Një element i rëndësishëm lidhur me parashikimin e Nenit 265 të KP është fakti që mjafton të provohet një nga elementët si: përgatitje, përhapje madje edhe vetëm ruajtje e gjuhës së urrejtjes, dhe vepra penale do të konsiderohet e konsumuar. Gjithashtu, vetë neni thekson se forma e shprehjes së kësaj gjuhe nuk është e rëndësishme në përcaktimin e kësaj vepre penale. Pra, jo domosdoshmërisht një thirrje e tillë duhet të jetë e shkruar, në mënyrë që të zbatohet Neni 265 i KP. Gjatë viteve ky nen i është nënshtruar ndryshimeve,<sup>202</sup> duke rritur masën e dënimit në përputhje me rritjen e rrezikshmërisë sociale të kësaj vepre penale.

Gjuha e urrejtjes adresohet edhe në Nenin 266 të KP (nën të njëjtin seksion si neni 265 i KP), i cili nën titullin 'Thirrja për urrejtje nacionale', parashikon që **vënia në rrezik e paqes publike duke bërë thirrje për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë**, duke i fyer ose shpifur për to, **duke kërkuar përdorimin e dhunës ose të veprimeve arbitrare kundër tyre**, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.' Sërish edhe ky nen ka për qëllim kufizimin e abuzimit me lirinë e shprehjes, dhe parashikon ndër të tjera thirrjen për urrejtje kundër pjesëve të popullsisë apo kërkesat për përdorim dhune ose të veprimeve arbitrare ndaj pjesëve të caktuara të popullsisë, si forma të këtij abuzimi.

Një tjetër vepër penale e cila (megjithëse në formë jo të drejtpërdrejtë) lidhet me gjuhën e urrejtjes është fyerja, e parashikuar nga Neni 119 i Kodit Penal. Ky nen parashikon që fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në tre milionë lekë. Ky nen i është nënshtruar dy amendimeve nga momenti i hyrjes në fuqi të KP. Amendimi i parë lidhej me shtimin e rrethanave rënduese të kësaj vepre, pikërisht rastet kur vepra kryhet **'në dëm të disa personave ose më shumë se një herë'**, çka e afron akoma më shumë fyerjen e përdorimin e gjuhës së urrejtjes. Amendimi i dytë përjashtoi dënimin me burgim për këtë vepër penale, duke parashikuar gjobën (me limitet e mësipërme minimale dhe maksimale) si formën e vetme të dhënies së dënimit. Ky amendim shërben si tregues që gjithsesi fyerja karakterizohet nga një **rrezikshmëri shoqërore më e ulët në krahasim me gjuhën e urrejtjes**.

Një tjetër vepër penale e cila vlen të përmendet në kuadër të diskutimit të gjuhës së urrejtjes është **'Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik'** e parashikuar nga Neni 119/a i KP<sup>203</sup> Ky nen parashikon që ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobike përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Pavarësisht se në këtë nen nuk përmendet termi 'gjuhë e urrejtjes', nga një këndvështrim krahasimor ndërmjet kësaj dispozite dhe përkufizimeve më të njohura të gjuhës së urrejtjes, mund të arrihet në përfundimin që Neni 119/a i KP është i aplikueshëm për gjuhën e urrejtjes online. Një tjetër tregues për sa më sipër është edhe parashikimi për masën e dënimit me burgim, që është tregues i rrezikshmërisë të konsiderueshme shoqërore që ka kjo vepër penale.

Në të njëjtën linjë, një tjetër vepër penale për t'u diskutuar në kuadër të këtij kapitulli është edhe **Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik**, parashikuar nga Neni 119/b i KP<sup>204</sup>. Ky nen parashikon që fyerja e qëllimshme publike, nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Edhe në këtë rast, pavarësisht se nuk përmendet drejtpërdrejt termi i 'gjuhës së urrejtjes', mund të konkludohet që ky nen është i aplikueshëm në adresimin e kësaj gjuhe. Një tregues për këtë përfundim është edhe parashikimi për masën e dënimit me burgim, që është tregues i rrezikshmërisë të konsiderueshme shoqërore që ka kjo vepër penale.

Neni 120 i KP, nën titullin **'Shpifja'**, parashikon që përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në një milion e pesëqind mijë lekë. Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me

<sup>202</sup> Ndryshimet janë realizuar nëpërmjet ligjit 144/201 'Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7895, datë 27.1.1995 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar'.

<sup>203</sup> Ky nen është shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008 'Për disa ndryshime të ligjit Nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë'

<sup>204</sup> Ky nen është shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008 'Për disa ndryshime të ligjit Nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë'

gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në tre milionë lekë. Ky nen i është nënshtruar dy amendimeve pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi. Kështu paragrafi i dytë i këtij neni u ndryshua, duke iu shtuar edhe rrethana të tjera cilësuese të veprës penale, që përfshinin **kryerjen e shpifjes në dëm të disa personave, ose më shumë se njëherë**. Edhe në këtë rast, në mënyrë të ngjashme me fyerjen, shtimi i këtyre rrethanave cilësuese e afrojnë më shumë këtë vepër me gjuhën e urrejtjes. Amendimi i dytë i këtij neni zëvendësoi dënimin maksimal me burgim për kryerjen e kësaj veprë penale, me vlerat aktuale të dënimin me gjobë për këtë vepër, çka dëshmon për rrezikshmërinë më të ulët shoqërore të shpifjes në krahasim me format më të drejtpërdrejta të përdorimit të gjuhës së urrejtjes.

#### *Përgjegjësia Civile për Gjuhën e Urrejtjes në Shqipëri*

Ashtu si u përmend më lart, gjuha e urrejtjes në Shqipëri adresohet kryesisht nga legjislacioni penal. *Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (KC)*<sup>205</sup> dhe *Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë (KPrC)*<sup>206</sup> nuk adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë rregullimin e procedurës së shpërblimit të dëmit të shkaktuar specifikisht nga gjuha e urrejtjes. Gjykatat civile shqiptare ende nuk kanë trajtuar raste shpërblimi dëmi që lidhen me gjuhën e urrejtjes. Megjithatë ky mbetet një shqetësim konstant sidomos në publikimin e lajmeve në mediat online, që është adresuar nga institucione të ndryshme të pavarura si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, nga komunitetet e gazetarëve, nga organizatat e shoqërisë civile, nga komuniteti i donatorëve në Shqipëri si dhe nga vetë qytetarët shqiptarë, gjë që do të passjellë edhe paraqitjen e rasteve në gjykatat tona në një të ardhme jo të largët.

Pavarësisht sa më sipër, në momentin që një individ i janë shkaktuar dëme pasurore ose jopasurore (edhe nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes), ky legjislacion parashikon mundësinë që pala e dëmtuar t'i drejtohet gjykatave kompetente për të kërkuar shpërblimin e këtij dëmi. Duke qenë se ende nuk ka ende një praktikë gjyqësore civile për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes, praktika gjyqësore lidhur me veprat të tjera të abuzimit me lirinë e shprehjes (si p.sh. fyerja ose shpifja) mund të ndihmojë në krijimin e një ideje të përgjithshme lidhur me standardet e procesit civil të shpërblimit të dëmit në këto raste.

Në procedurat gjyqësore civile të shkaktimit të dëmit (jashtëkontraktor) bazuar në nenin 608 e vijues të KC, në rastet cenimit të figurës së paditësit apo dëmeve që rrjedhin prej saj, gjykatat shqiptare kanë përmendur në vazhdimësi që **liria e shprehjes garantohej nga Kushtetuta por deri në kufirin e paprekshmërisë së dinjitetit dhe personalitetit të individit**.

Në trajtimin e shpërblimit të dëmit për shkak të abuzimit me lirinë e shprehjes, **gjykatat shqiptare i kanë kushtuar rëndësi katër elementëve**: sjelljes së paligjshme, ekzistencës së dëmit, ekzistencës së fajit, dhe lidhjes së drejtpërdrejtë shkakësore midis dëmit dhe fajit.

Për sa i përket **ekzistencës së sjelljes së paligjshme**, Gjykata është shprehur se për të vlerësuar nëse ky veprim i palës së paditur është apo jo i kundërligjshëm, gjykata analizon njëkohësisht dy aspekte: *aspekti objektiv*, pra nëse deklaratimet e palës së paditur janë në kundërshtim me ndonjë normë konkrete të rendit juridik dhe aspekti subjektiv, pra kundërligjshmëria ose jo e deklaratimeve, duke u nisur nga cenimi ose jo i të drejtave dhe interesave të të tretëve, që legjitimojnë kufizimin e lirisë së bërjes së këtyre deklaratimeve (vendimi nr. 6616 datë 27.03.2019, çështja V. kundër V.).

Lidhur me kushtin e **ekzistencës së dëmit**, gjykatat shqiptare kanë konsideruar si dëm në rastet e tejkalimit të lirisë së shprehjes, zakonisht **dëmin jopasuror**, që vjen nga shkaktimi i vuajtjes për shkak të veprimeve të paligjshme të të paditurit. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë përfshirë në kuptim të dëmit jopasuror: **dëmtimin e shëndetit ose dëmin biologjik** (i cili përbën, në thelb, cenimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e Nenit 625 të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm)<sup>207</sup>; **dëmin moral** (i cili është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë (non iure perturbatio) të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasojë e faktit të paligjshëm. Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a

<sup>205</sup> Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

<sup>206</sup> Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 'Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë' (i ndryshuar).

<sup>207</sup> Vendimi Nr. 12 datë 13.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë faqe 15.



mosveprimet e paligjshme dhe me faj të një të treti ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar. Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht (*ius proprius*) edhe secilit prej familjarëve të afërt të personit që ka humbur jetën apo të cenuar në shëndetin e tij nga fakti i paligjshëm, nëse vërtetohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës. Demi moral i pësuar nga vetë të afërmit konsiderohet si pasojë, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtit fakt të paligjshëm)<sup>208</sup> si dhe **dëmin ekzistencial** (i cili shkaktohet kur fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në mënyrë të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtaritë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësime të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivist qenien e tij apo mund ta karakterizojnë pozitivist në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm. Demi ekzistencial, duke mos pasur natyrë thjesht ndjesore e të brendshme, është objektivisht i vërtetueshëm).<sup>209</sup>

Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që në këto padi të kërkohej edhe shpërblimi i **dëmit pasuror** nëse paditësi provon që nga thëniet apo fjalët e të paditurit, i ka ardhur një dëm ekonomik direkt. Lidhur me demin pasuror, nenet 486 dhe 640 të K.Civil dallojnë humbjen e pësuar nga pakësimi i pasurisë, që njihet si dëmi aktual apo dëmi emergjent (*damnum emergens*) dhe fitimin e munguar (*lucrum cessans*).<sup>210</sup> Në vendimet e tyre, gjykatat shqiptare kanë pranuar padinë për shpërblim dëmi vetëm në lidhje me atë pjesë të dëmit që paditësi ka mundur të provojë (vendimi nr. 1502 datë 18.02.2013, çështja V. kundër G.).

**Ekzistenca e fajit, në** paditë e shkakimit të dëmit për shkak të abuzimit me lirinë e shprehjes, ka një rol themelor në vendimin përfundimtar të gjykatës. E veçanta e proceseve civile të këtij lloji është zhvendosja e barrës së provës për të provuar fajësinë: nga paditësi tek i padituri. Në vendimin Nr. 5245 datë 13.05.2013, në çështjen B. kundër B., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë u shpreh se 'në dallim nga e drejta penale që bazohet në prezumimin e pafajësisë, e drejta e detyrimeve në lidhje me shkaktimin e dëmit bazohet në prezumimin e fajësisë duke pasur paditësi detyrimin për të provuar vetëm që deklaratimet e të paditurit i kanë cenuar nderin dhe personalitetin dhe barra e provës kalon tek i padituri për të provuar faktet që janë në themel të deklaratave të tij'. Pra, barra e provës për të vërtetuar ose hedhur poshtë elementin e tretë (fajin) zhvendoset tek i padituri.

Gjykatat shqiptare i kanë kushtuar rëndësi të veçantë **lidhjes direkte shkakësore ndërmjet fajit dhe dëmit të ardhur**. Në rast se nuk provohet që kjo lidhje të jetë direkte, paditësi nuk legjitimohet në kërkesën e tij. Kështu, në vendimin 6187 datë 04.06.2013, çështja T. kundër shoqërisë S. sh.p.k., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rrëzoi padinë për shkaktim dëmi, me arsyetimin se shkrimi i publikuar në gazetë nuk kishte sjellë dëme të menjëhershme për paditësin.

*Përgjegjësia administrative (Ligji për Median, Ligji për Tregtinë Elektronike, Ligji për Komunikimet Elektronike)*

**Ligji 'Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë'**<sup>211</sup> (ish-ligji për mediat audiovizive në RSH) është ligji i cili rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre (me përjashtim të medias së shkruar). Ky ligj adreson problemin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në disa dispozita. Së pari, ai sanksionon parime si: veprimtaria e transmetimeve audiovizive **respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut** (Neni 4(1)(b) i ligjit); Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga parimi i **moslejimit të transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve** (Neni 4(2)(d) i ligjit); nga parimi i moslejimit të transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën (Neni 4(2)(dh) i ligjit); etj.

Gjithashtu, ky ligj parashikon se një nga rregullat e përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive është **detyrimi për të mos transmetuar programe me përmbajtje që nxisin urrejtjen**

<sup>208</sup> Ibid. faqe 17.

<sup>209</sup> Ibid. faqe 18.

<sup>210</sup> Ibid. faqe 10.

<sup>211</sup> Ligji Nr. 97/2013 Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë (ndryshuar titulli i ligjit në vitin 2019).

mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, fetare dhe çdo lloj forme tjetër diskriminimi (Neni 32/4). Në të njëjtën linjë, ligji parashikon që ofruesit e shërbimit mediatic audioviziv duhet të respektojnë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe **të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale** (Neni 33(1)(d) i ligjit). Në rast se sa më sipër nuk zbatohet nga ana e Operatorëve të Mediave Audiovizive në programet e transmetuara prej tyre, cilado palë e interesuar mund t'i drejtojë ankesa të arsyetuara me shkrim, të cilat Operatorët janë të detyruar t'i shqyrtojnë (Neni 51(3) i ligjit). Gjithashtu, lidhur me programet e transmetuara, ankesat mund t'i drejtohen Këshillit të Ankesave (i caktuar nga AMA), i cili i vendos lidhur me zgjidhjen e ankesës brenda një afati sa më të shkurtër. Gjatë procedurave të zgjidhjes së ankesës, Këshilli i Ankesave mund të vendosë organizimin e seancave dëgjimore me palët (Neni 52(6) i ligjit).

Po ashtu, duke listuar kushtet për ofrimin e shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv sipas kërkesës së përdoruesit, ligji parashikon se **shërbimet e ofruara sipas kërkesës së përdoruesit nuk lejohen të përfshijnë programe që nxisin urrejtjen** mbi baza racore, etnike, gjinore, kombëtare ose fetare (Neni 76).

Ligji 'Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë' është në proces rishikimi, rrjedhimisht, në të ardhmen mund të përfshihen edhe dispozita të reja apo të ndryshuara lidhur me adresimin e një problemi gjithnjë e më shumë në rritje si përdorimi dhe shpërndarja e gjuhës së urrejtjes.

**Ligji 'Për Tregtinë Elektronike'**<sup>212</sup> pavarësisht se nuk adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë problemin e gjuhës së urrejtjes, rregullon një element të rëndësishëm që lidhet edhe me këtë fenomen për sa i përket përgjegjësisë së shpërndarjes së informacionit në internet. Sipas këtij ligji, kur ofrimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit konsiston në transmetimin një rrjet komunikimi të **informacionit të siguar nga marrësi i shërbimit**, ose në ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi, **ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës** për informacionin e transmetuar nëse ofruesi i shërbimit: nuk inicion transmetimin; nuk zgjedh ose modifikon përmbajtjen e informacionit të transmetuar ose nuk zgjedh marrësin e transmetimit (Neni 15(1) i ligjit). Një tjetër nen i këtij ligji i cili është i aplikueshëm edhe në rastin e transmetimit të informacioneve që transmetojnë urrejtje, parashikon që ofruesi i shërbimit **është i detyruar të ndërpresë ose të parandalojë një shkelje**, nëse kjo kërkohet nga **gjykata ose nga autoritetet përgjegjëse**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Ligji 'Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë'**<sup>213</sup> ka si qëllim promovimin e konkurrencës dhe infrastrukturës efçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike. Në autorizimin e përgjithshëm të sipërmarrësve që parashikojnë të ofrojnë një rrjet apo shërbim të komunikimeve elektronike, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) vendos kushte për (ndër të tjera) respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi (Neni 15(e) i ligjit). Megjithatë, Neni 18 i këtij ligji parashikon rastet kur autorizimi i mësipërm mund të revokohet. Një nga rastet objektivisht të justifikuar është dhe **interesi publik**. Ky i fundit është një kufizim klasik edhe i lirisë së shprehjes në përgjithësi që mund të aplikohen në rastet e abuzimit me këtë liri, siç është rasti i gjuhës së urrejtjes. Duke qenë se shërbimet e komunikimeve elektronike lidhen me gëzimin e lirisë së shprehjes dhe asaj për t'u informuar, ligji i mësipërm parashikon që duhet të kenë një natyrë universale. Kjo do të thotë që shërbimet e përfshira në shërbimin universal duhet të jenë të disponueshme për përdoruesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, me cilësinë dhe kushtet e përcaktuara në aktin rregullator të nxjerrë nga AKEP-i.

Disa nga institucionet e tjera të angazhuara në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri janë Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi etj. Këto institucione ndikojnë në minimizimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes nëpërmjet vendimeve dhe rekomandimeve të tyre, në mbrojtje të personave të cilët janë cenuar nga përdorimi abuziv i lirisë së shprehjes dhe kalimi në gjuhë të urrejtjes. Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të shqyrtohen në nënkapitullin II të kësaj Pjese. Ndërsa në Raportin vjetor të vitit 2017, Avokati i Popullit është ndalur gjerësisht tek problemi i intensifikimit të gjuhës së urrejtjes në Shqipëri. Në këtë raport, Avokati i Popullit konsideron gjuhën e urrejtjes si iniciatore të drejtpërdrejtë të krimeve të tjera kundër një personi apo një grupi personash. Gjithashtu, në këtë raport Avokati i Popullit nënvizon se '...kjo gjuhë urrejtjeje kultivohet në trajtë piramidale nga lart poshtë, modelon sipas shëmbëlltyrës së saj edhe ata që e marrin për referencë. Gjuha e rëndë e urrejtjes në fushatat politike, në Kuvend e në

<sup>212</sup> Ligji Nr. 10128 datë 11.05.2009 'Për tregtinë elektronike'(i ndryshuar).

<sup>213</sup> Ligji Nr.9918, datë 19.5.2008 'Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë'(i ndryshuar).

institucione, transferohet e pandryshuar, edhe në zyrat vartëse...Gjuha e urrejtjes, ndërgjegjësimi dhe shërimi prej saj, mbetet një nga sfidat tona më të mëdha të viteve që vijnë.’

### 3.4.2 Kodi i Etikës së Gazetarit

Kodi i Etikës së Gazetarit<sup>214</sup> është një instrument vetërregullues që synon të forcojë dhe përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së gazetarëve në Shqipëri. Parimet e këtij Kodi aplikohen në mënyrë të barabartë ndaj të gjitha platformave mediatike dhe gazetareske, offline dhe online, përfshi gazetarinë e shpërndarë nëpërmjet medias sociale dhe portaleve në internet.<sup>215</sup> Botuesi dhe redaktori janë përgjegjës për botimin e lajmeve dhe artikujve, ashtu edhe të letrave për redaktorin, komenteve apo përgjigjeve në faqen e internetit të medias, përfshi rastet ku emri i autorit është hequr apo është nënshkruar me një pseudonim.<sup>216</sup> Media dhe stafi editorial duhet të bien dakord dhe të publikojnë kushte të përcaktuara qartë për përzgjedhjen dhe publikimin e komenteve nga publiku. Media duhet t’i monitorojë dhe shqyrtojë këto komente dhe të ndër marrë hapa për t’u siguruar që kushtet e publikimit të respektohen.

Ky Kod Etike adreson problemin e gjuhës së urrejtjes në një nen më vete, ku thekson që Media duhet **të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë** ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës. **Çdo botim duhet të mos specifikojë origjinën, etnicitetin, kombësinë, racën, fenë apo orientimin seksual të një grupi apo individ, përveç rasteve kur gjykohet e rëndësishme dhe e nevojshme** për të kuptuar më mirë faktet dhe opinionet e paraqitura në publikim.

*Udhëzime etike për gazetarinë online dhe rëndësia e tyre për adresimin e gjuhës së urrejtjes*

Në kuadrin e rregullimeve të çështjeve të etikës, sidomos në kushtet kur media online ka marrë zhvillim të jashtëzakonshëm me zhvillimin e teknologjisë së informacionit, një grup ekspertësh si dhe Këshilli Shqiptar i Medias kanë hartuar një dokument që titullohet ‘Udhëzime etike për gazetarinë online’. Udhëzimet janë bazuar në standardet ndërkombëtare si dhe në praktika të mira për çështjet e etikës, duke përfshirë edhe adresimin e gjuhës së urrejtjes. Udhëzimet përfshijnë rregullime orientuese dhe sugjeruese, në kuadrin e një ‘soft law’ - ato **nuk janë të detyrueshme por rekomandohet të mbahen në konsideratë** nga gazetarët dhe botuesit e mediave online sa herë që hartojnë, publikojnë apo shpërndajnë informacione.

Si parim i përgjithshëm, gazetaria online duhet të respektojë të gjitha rregullat e etikës profesionale dhe vlerat themelore të gazetarisë, pavarësisht nga forumi apo formati në të cilën ushtrohet. Lidhur me shmangien e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, këto udhëzime parashikojnë disa parime lidhur me informacionin e botuar nga mediat online, i cili duhet të jetë **i verifikuar dhe jo-sensacionalist si dhe i botuar pa qëllim për të dëmtuar të tretët.**

Sipas këtyre udhëzimeve, redaksia ose operatorët e faqes nuk duhet të publikojë online **shkrime apo komente që nxisin urrejtjen dhe dhunën, ose shkaktojnë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë** në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, bindjes politike, besimit fetar, përkatësisë etnike apo sociale. Në disa faqe online nuk mund të flitet për redaksi të mirëfillta, megjithatë personi përgjegjës ligjërisht dhe etikisht është operatori/ët i faqes.

Këto udhëzime theksojnë faktin që redaksia duhet të jetë e ndërgjegjshme se ajo mban përgjegjësi etike dhe ligjore edhe për përmbajtjen e gjeneruar nga palët e treta dhe të botuar në faqen e saj. Duhet pasur kujdes që hyperlink-et (lidhjet) që një media online vendos në faqen e saj mund ta dërgojnë përdoruesin në faqe që përmbajnë materiale të rreme dhe me qëllime keqdashëse ose që nuk respektojnë Kodin e Etikës së Gazetarit. Udhëzimet adresojnë gjithashtu çështje që lidhen me përmbajtjen e gjeneruar nga të tretët. Redaksia ose operatorët duhet të **monitorojë** faqen e vet online (si dhe faqet përkatëse në rrjetet sociale) dhe **të marrë masa të parandalojë ose të ndërpresë publikimin e materialeve të paligjshme**, të cilat dhunojnë privatësinë dhe dinjitetin njerëzor, **ose përbëjnë gjuhë të urrejtjes**. Kurdo që të jetë e mundur, monitorimi duhet të bëhet para publikimit. Redaksia ose operatorët duhet të miratojnë dhe publikojnë dukshëm në faqen e vet politikën e administrimit të përmbajtjes së gjeneruar nga të tretët dhe rregullat që këta duhet të ndjekin

<sup>214</sup> Për t’u njohur me tekstin e plotë të Kodit, vizito: <https://kshm.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>

<sup>215</sup> Ibid.

<sup>216</sup> Ibid, Neni 7.

për të bërë komente apo shtuar përmbajtje ne faqe - rregullat duhet të përcaktojnë qartë çfarë është e lejueshme të botohet në faqe, trajtimin e komenteve anonime, si dhe procedurat e ankimit të publikut për shkelje të këtyre rregullave ose të ligjit.

Politikat e administrimit të përmbajtjes duhet të përcaktojnë qartë se çfarë lloj monitorimi i përmbajtjes së të tretëve zbatohet në faqe (paraprak, ex post etj.) dhe çfarë teknologjish dhe teknikash përdoren për monitorimin e faqes. Redaksia ose operatorët rekomandohet të përdorin teknologjitë standarde të sektorit (filtra, softuerë etj.) për të bllokuar përmbajtje banale ose lehtësisht të kontrollueshme si dhe të venë në dispozicion të përdoruesve **një mekanizëm të thjeshtë për të raportuar komentet e të tretëve që pretendohet se janë të paligjshme** apo në shkelje të politikave të faqes. Për komente që përbëjnë gjuhë të urrejtjes, rrezik për sigurinë dhe integritetin fizik të personave apo shkelje të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, dhe sidomos të të miturve duhet të ketë një mekanizëm për identifikimin dhe heqjen e tyre sa me të shpejtë. Redaksia dhe operatorët duhet të marrin hapa të menjëhershme për të hetuar dhe hequr materialet e papranueshme sapo të marrin dijeni për to, duke vepruar kryesisht (edhe në mungesë të një ankimi nga personat e cenuar apo të tretët) apo duke marrë masa të shpejta pas marrjes së një ankimi legjitim. **Në disa raste të caktuara, komentet dhe materialet e të tretëve mund të ndalohen tërësisht.**

Udhëzimet përmbajnë gjithashtu rregullime të detajuara edhe për **procedurat e ankimit dhe heqjes së komenteve**, rregulla për përdorimin e materialeve të marra nga rrjetet sociale ose të vendosura në dispozicion nga publiku, arkivat online dhe ripublikimi i materialeve të të tretëve.

### 3.5 Praktika e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të luftës kundër gjuhës së urrejtjes

*Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)* parashikohet nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi <sup>217</sup> si personi juridik publik i pavarur që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin (Neni 21). Në kompetencat e Komisionerit përfshihet shqyrtimi i ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, edhe në kuadër të gjuhës së urrejtjes. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave Komisioneri shprehet me vendim, i cili u njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e marrjes së ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre (Neni 33). Masat e marra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të jenë detyrimi për të kërkuar ndjesë publike dhe/ose gjoba, në përputhje me parashikimet e Nenit 33(13) të ligjit. Disa nga vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të trajtohen në vijim.

Komisioneri ka trajtuar **problematikat e gjuhës homofobike të urrejtjes** në vendimin e tij Nr. 125 datë 01.08.2014. Në përputhje me ankesën e depozituar pranë Komisionerit nga dy organizata në mbrojtje të komunitetit LGBT, subjekti i ankimit (subjekti AK) kishte postuar në faqen e rrjetit Facebook publikime si: *“Të gjithë në protestë kundër iniciativës socialiste për martesat burrë me burrë. Pro familjes, pro morali, pro jetës”; „Stop Gay Parade në Shqipëri! Çdo sugjerim për parandalimin e këtij fenomeni është i mirëpritur!”* etj. Postimi ishte pasuar nga shumë komente nga përdoruesit e platformës Facebook si: *“Vetëm tritoli mbaron punë”; ‘Digjini të gjallë këto poshtërsira’; ‘Duhet me i vra krejt homoseksualët në botë’* etj. Lidhur me këtë çështje, KMD u shpreh se orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë shkaqe për të cilat ligji ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’ ofron mbrojtje nga sjelljet diskriminuese.<sup>218</sup> Për më tepër, Komisioneri iu referua Nenit 3 të KRSH lidhur me mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave e lirive të njeriut, si dhe detyrimin pozitiv të shtetit për t’i mbrojtur këto të drejta, si dhe Rekomandimit CM/Rec (2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës ‘Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor’. Në këtë kuadër, duke cituar këtë Rekomandim, Komisioneri ka theksuar që **gjuha e urrejtjes kundër homoseksualëve ka të bëjë me të gjitha format e shprehjes të përhapura nëpërmjet medias dhe internetit të cila përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj personave LGBT**. Komisioneri u shpreh se pikërisht shprehjet e mësipërme krijojnë në radhët e publikut dhe veçanërisht të personave që nuk janë të mirinformuar **ndjenja keqkuptimi, refuzimi e tek disa ndjenja urrejtjeje ndaj komunitetit LGBT**. Komisioneri i konsideroi postimet në Facebook dhe komentet pasuese ishin **flagrante**

<sup>217</sup> Vendimi i KMD Nr. 125 datë 01.08.2014, faqe 3.

<sup>218</sup> Vendimi i KMD Nr. 125 datë 01.08.2014, faqe 3.

**dhe përcillnin një gjuhë të urrejtjes së pajustificuar...** Mosndëshkimi i një sjelljeje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit 'Për mbrojtjen nga diskriminimi'.<sup>219</sup> Në vendimin e tij, Komisioneri mbajti parasysh faktin që subjekti në qendër të ankesës kishte fshirë postimet në Facebook, por nga ana tjetër edhe faktin që ai nuk kishte bërë përpjekje për të bashkëpunuar me Komisionerin. Për të gjitha këto arsye, KMD vendosi kontraktimin e diskriminimit të Komunitetit LGBT për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor rekomandimin që subjekti AK të kërkonte publikisht ndjesë dhe gjobitjen e subjektit AK me një gjobë prej 60,000 Lekësh. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë<sup>220</sup>.

Gjithashtu çështja e **gjuhës homofobike të urrejtjes** është trajtuar nga Komisioneri edhe në një tjetër rast. Komisioneri, duke marrë të dhëna lidhur me deklaratat e shtetasit P.B. në një program të transmetuar në një nga kanalet televizive shqiptare, ka vendosur të ndjekë ex officio çështjen. Deklaratat e P.B. mund të përmbliken si më poshtë: "*Martesa ndërmjet personave të të njëjtës gjini nuk është normale... bota po devijon aq shumë sa pas disa vitesh do të quhet normale pranimi i personave që kryejnë marrëdhënie seksuale me fëmijët*" si dhe "*Nuk do të doja që pjesë e Miss Shqipëria apo Miss Globe të ishte pjesë një person që i përket komunitetit LGBTI apo më saktësisht të ishte lezbikë*". Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vendosi që gjuha e përdorur nga P.B është një rast **flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit** të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjelljeje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Ligjit Nr. 10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi".<sup>221</sup> Lidhur me sa më sipër, Komisioneri konstatoi se shprehjes e përdorura ishin diskriminuese pasi ato prodhonin **efektin e paragjykit, nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes** ose formave të tjera të diskriminimit kundër personave për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual. KMD vendosi detyrimin e P.B. **të kërkojë publikisht ndjesë** brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e vendimit për këtë vendim dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e paragjykit, nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër personave për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.<sup>222</sup>

Çështja e gjuhës **së urrejtjes për shkak të etnisë dhe gjuhës** është trajtuar nga KMD në vendimin e tij Nr. 28 datë 04.04.2013. Ankesa drejtuar Komisionerit denonconte rastin e deklaratave të subjektit AK në faqen zyrtare të saj. Këto deklarata përmbanin shprehje si: "*AK e konsideron të papranueshëm faktin që në Komunën Liqenas në Qarkun e Korçës, tabelat informuese në rrugë dhe institucione nuk përbëjnë gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë, gjuhën shqipe. Pas konstatimit të këtij fakti aspak të drejtë dhe ligjor, AK u nis drejt Komunës Liqenas për të vendosur në vendin e duhur dinjitetin e simboleve kombëtare*" si dhe "*Dhjetëra aktivistë të AK kanë qarkulluar në Komunën Liqenas dhe kanë vendosur në tabelat e rrugëve dhe institucioneve të kësaj Komune simbolin kombëtar të Republikës së Shqipërisë si dhe tabelat "këtu është tokë shqiptare."*" AK zotohet përpara mbështetësve të saj dhe mbarë popullit shqiptar se do të udhëtojë në çdo qytet të Republikës së Shqipërisë për të vendosur simbolin kombëtar dhe dinjitetin e shqiptarëve në vendin e merituar dhe legjitim. Lidhur me sa më sipër, KMD vendosi që veprime të tilla janë shfaqje tipike të një **nacionalizmi agresiv dhe diskriminimi të minoritarëve** përmes mohimit të të drejtave të tyre që ju garantohen nga aktet ndërkombëtare dhe legjislativi i brendshëm. Për këtë arsye, Komisioneri vendosi konstatimin e diskriminimit në këtë rast, detyrimin e subjektit AK të kërkojë falje publike dhe të evitojë në të ardhmen qëndrimet që nisin dhunën apo forma të tjera të sjelljeve diskriminuese ndaj pakicave kombëtare. Në momentin e kalimit të afatit për të realizuar veprimet e mësipërme, subjekti AK është gjobitur nga Komisioneri. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.<sup>223</sup>

<sup>219</sup> Vendimi i KMD Nr. 125 datë 01.08.2014, faqe 7.

<sup>220</sup> Vendimi Nr. 3127 datë 09.06.2015.

<sup>221</sup> Vendimi i KMD Nr. 108, datë 21.08.2019.

<sup>222</sup> Vendimi Nr. 4319 datë 18.12.2019.

<sup>223</sup> Vendimi nr. 2337 datë 13.05.2014.

## 4. Rekomandime lidhur me gjuhën e urrejtjes në Shqipëri<sup>224</sup>

---

Në përfundim të studimit mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat shqiptare lidhur me luftën kundër gjuhës së urrejtjes, është vënë re se në Shqipëri kohët e fundit ka përpjekje për të adresuar rastet më ekstreme të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, të cilat parashikohen në figurën e disa veprave penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu institucione publike si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëpërmjet vendimmarrjes së tij, ka adresuar raste të tjera të gjuhës së urrejtjes, të cilat për nga rrezikshmëria shoqërore nuk inkuadroheshin në asnjë prej veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal. Megjithatë, në Shqipëri ende nuk ka një kontroll dhe luftë të mirëorganizuar kundër gjuhës së urrejtjes, e cila kohët e fundit (në përputhje me trendet ndërkombëtare) po përhapet më lehtësisht për shkak të aksesit të gjerë në media e rrjete sociale. Për këtë arsye, rekomandimet e mëposhtme do të shërbenin në përfundim dhe efikasitetin e luftës kundër këtij fenomeni në Shqipëri.

- Në doktrinën dhe jurisprudencën shqiptare mungon një qëndrim i konsoliduar lidhur me **përkufizimin e termiit ,gjuhë e urrejtjes’**. Kjo sepse në Shqipëri nuk ka ende një akt normativ që të bëjë një përkufizim të këtij termi, i cili do të shërbente në përcaktimin e elementëve që lehtësojnë identifikimin e gjuhës së urrejtjes nga organet kompetente. Ashtu si është përmendur edhe në studim, çështja e përkufizimit të këtij termi është një problem me përmasa ndërkombëtare pasi instrumente të ndryshëm ndërkombëtarë bëjnë përkufizime të ndryshme të këtij termi, duke zgjeruar ose ngushtuar spektrin e veprimeve/thënieve që përbëjnë gjuhë urrejtjeje. Megjithatë, në kontekstin e Shqipërisë, përkufizimi i gjuhës së urrejtjes është i nevojshëm sidomos në kuadër të legjislacionit penal të Shqipërisë, ku për shembull në Kodin Penal adresohen vepra të ndryshme që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me gjuhën e urrejtjes. Në këtë mënyrë, gjykatat dhe çdo institucion tjetër publik do të mund të ofronin qasje të ngjashme lidhur me kategorizimin e një akti si gjuhë urrejtjeje apo jo. Në këtë rast, amendimi i Kodit Penal, duke shtuar si vepër penale më vete vetëm gjuhën e urrejtjes dhe ofrimi i një përkufizimi të këtij termi do të shërbente si një mjet efikas në luftën kundër këtij fenomeni përmes përdorimit të ligjit të penal, me kusht nuk do të hyjë në fuqi që asnjë masë tjetër më pak kufizuese dhe që do të respektohet e drejta për lirinë e shprehjes dhe mendimit.
- Ngritja dhe vendosja e prioritetit tek **njësitë e veçanta dhe të specializuara për të parandaluar, gjurmuar dhe ndëshkuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes online që arrijnë kufirin e veprave penale** do të shërbente për të organizuar një luftë më të shpejtë dhe efikase kundër gjuhës së urrejtjes online. Kjo e fundit, duke qenë aktualisht forma më e zakonshme e përhapjes së gjuhës së urrejtjes dhe për shkak të zhvillimit të teknologjisë më e vështira për t’u gjurmuar dhe ndëshkuar, kërkon mjete të veçanta dhe trajnime të posaçme për t’u adresuar, të përshtatshme për ndryshimet e vazhdueshme të teknologjisë online.
- Miratimi i një programi të veçantë nga ana e organeve publike (si p.sh. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) që ka në fokus **dhënien e ndihmës dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtat e tyre të viktimave të gjuhës së urrejtjes**. Diçka e tillë është shumë e nevojshme në shoqërinë shqiptare, duke qenë se në praktikën gjyqësore shqiptare ende mungojnë proceset civile për shpërblimin e dëmit (pasuror dhe/ose jopasuror) të shkaktuar nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes. Kjo është dëshmi ndër të tjera e një ndërgjegjësimi të kufizuar të viktimave lidhur me mundësitë e tyre ligjore për të kërkuar

---

<sup>224</sup> Nga Mirela Bogdani

drejtësi. Për këtë arsye, ofrimi i programeve të rehabilitimit dhe ndërgjegjësimit të viktimave të gjuhës së urrejtjes do të shërbente jo vetëm në përmirësimin e gjendjes dhe statusit të viktimave, por edhe në intimidimin e përdoruesve të gjuhës së urrejtjes në të ardhmen.

- Rritja e **bashkëpunimit ndërmjet organeve publike shqiptare** të cilat adresojnë problemin e gjuhës së urrejtjes (duke nisur nga gjykatat dhe duke vazhduar me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit etj.) dhe organeve apo organizatave ndërkombëtare të ngritura me po të njëjtin objekt. Për shkak të një eksperience më të madhe dhe shumëdimensionale në luftën kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave në luftën kundër gjuhës së urrejtjes do të jetë esencial në përditësimin e informacionit, trajnimin e stafit të këtyre organeve dhe përafrimit të qasjes ndërkombëtare lidhur me gjuhën e urrejtjes.
- **Institucionet e pavarura për barazi, si Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi, Autoriteti i Mediave Audio-vizuale (AMA) dhe Avokati i Popullit** duhet të zhvillojnë mekanizma për mbledhjen e të dhënave për të nxitur hulumtime empirike dhe të tjera për diskriminimin mbi baza të ndryshme, përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Çdo politikë gjithëpërfshirëse për të trajtuar pabarazinë, diskriminimin dhe forma të tjera të paragjykitit kundër njerëzve LGBTI duhet të mbështeten mbi prova. Informacioni i mbledhur nga institucione për barazinë është me rëndësi për të identifikuar prioritetet e politikave, për të identifikuar aktorët kyçë si dhe pengesat, si dhe për të monitoruar dhe vlerësuar efektivitetin e politikave. Organizatat e shoqërisë civile duhet të inkurajohen që të luajnë rol aktiv në lidhje me incidentet e monitorimit të intolerancës dhe paragjytimeve dhe t'u ofrojnë të dhëna organeve për barazi.
- **Fushata për edukimin dhe informimin publik.** Fushatat për edukim dhe informim publik janë thelbësore për të luftuar stereotipet negative të dhe diskriminimin ndaj personave LGBTI dhe romë si dhe për të nxitur mjedise të sigurta për ta në shoqëri. Të pajisur me informacion, njerëzit mund të identifikojnë dhe me plot besim të kundërshtojnë manifestimin e intolerancës në ndërveprimet e tyre të përditshme. Në veçanti, fushatat për edukim dhe informim publik duhet të integrohen në edukimin parësor, dytësor dhe tretësor, por edhe të plotësohen me politika konkrete kundër bullizmit, përfshirë ofrimin e shërbimeve për viktimat e bullizmit, ndër to edhe nisma të udhëhequra nga kolegët apo bashkëmoshatarët. Organizatat e shoqërisë civile mund dhe duhet të inkurajohen që të luajnë rol qendror në udhëheqjen apo bashkëpunimin me Shtetet lidhur me fushatat për informim publik.
- **Trajnim për barazi:** Qeveria shqiptare duhet të ofrojë trajnime për zyrtarët publike dhe figura të tjera publike për të drejtat e personave LGBTI dhe romë sa i përket barazisë dhe mosdiskriminimit, sidomos aty ku diskriminimi është institucionalizuar dhe ka histori të moskundërshtimit. Fushat me prioritet në këtë drejtim duhet të përfshijnë shkollat dhe mjedise të tjera të edukimit, profesionet mjekësore, forcat e armatosura, policinë, gjyqësorin, shërbimet juridike, shoqatat politike apo institucionet fetare.
- **Politikanët shqiptarë** dhe personat e tjerë me influencë në shoqëri duhet të udhëzohen për rëndësinë e shmangies së deklaratave që mund të nxisin diskriminim apo të minojnë barazinë dhe duhet të shfrytëzojnë pozitën e tyre për të promovuar mirëkuptimin, edhe duke kundërshtuar, aty ku është e duhur, deklaratat dhe sjellje diskriminuese. Kodet e etikës dhe politikat “jo diskriminim” të miratuara nga partitë politike duhet po ashtu të merren parasysh.
- **Mobilizimi i aktorëve me ndikim dhe aleancave institucionale:** Përmirësimi i të kuptuarit të publikut rreth çështjeve që kanë të bëjnë me racën, përkatësinë etnike dhe orientimin seksual apo identitetin gjinor dhe trajtimi i intolerancës dhe paragjytimeve ndaj personave LGBTI dhe romëve kërkon nxitjen e dialogut dhe angazhimit ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile dhe shoqërisë në përgjithësi. Aktorët kryesorë duhet të përpiqen të krijojnë **aleanca për të bashkëpunuar** në trajtimin e manifestimeve të intolerancës dhe paragjykitit në shoqëri - në veçanti duke kërkuar mbështetjen e organizatave joqeveritare, organeve të barazisë, institucioneve fetare, policisë, politikëbërësve dhe organizatave ndërkombëtare për të bashkëpunuar në trajtimin e manifestimeve të intolerancës dhe paragjytimeve në shoqëri.
- Sa i përket **medias së transmetuar**, çdo kornizë rregullatore duhet të promovojë të drejtën e njerëzve LGBTI dhe romë për të hyrë dhe përdorur lirisht media dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit për prodhimin dhe qarkullimin e përmbajtjes së tyre dhe për marrjen e përmbajtjes së prodhuar nga të

tjerët. Të gjitha format e medias duhet ta pranojnë se kanë përgjegjësi morale dhe shoqërore për të promovuar barazinë dhe mos-diskriminimin, përfshirë për shkak të racës, etnisë, aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual apo identitetit gjinor. Në lidhje me kushtetutat e tyre, subjektet e medias duhet të ndërmarrin hapa për të:

- Siguruar se fuqia e tyre punëtore ka diversitet dhe përfaqëson të tërë shoqërinë;
- Adresuar sa më shumë që është e mundur çështje që kanë të bëjnë me të gjithë grupet në shoqëri, përfshirë LGBTI, romët dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Kërkuar burime dhe zëra të shumëllojshëm brenda komuniteteve LGBTI, romë në vend se t'i përfaqësojnë personat LGBTI dhe romë si bllok i tërë;
- Respektuar standardet më të larta të dhënies së informacionit, që plotëson standardet e njohura profesionale dhe etike;
- Kodet profesionale të mirësjelljes për media dhe gazetarët duhet të pasqyrojnë parimet e barazisë dhe duhen ndërmarrë hapa efektive për të shpallur dhe zbatuar kode të tilla.

– **Lidhur me luftimin e diskriminimit, subjektet e medias duhet të marrin parasysh:**

- Të kujdesen që të raportojnë në mënyrë kontekstuale dhe faktike, duke siguruar se aktet e diskriminimit sillen para vëmendjes së publikut;
- Të jetë syçelë ndaj rreziqeve nga diskriminimi dhe stereotipet negative të personave LGBTI dhe romë që mund të përhapen nga media;
- Të shmangin referencat e panevojshme ndaj orientimit seksual apo identitetit gjinor që mund të nxisin intolerancë;
- Të rrisin ndërgjegjësimin për dëmin që shkaktohet nga diskriminimi dhe stereotipizimi negativ i personave LGBTI dhe romë;
- Të raportojnë për grupe apo komunitete të ndryshme dhe t'u japin anëtarëve të tyre mundësinë që të flasin dhe të dëgjohen në mënyrë që nxit të kuptuarit më të mirë të tyre, ndërkohë që pasqyrojnë perspektivat e këtyre grupeve apo komuniteteve.



# Shtojcat

---

## 1. Fjalorthi

**Fyerje e trupit:** Akti i talljes ose përqeshjes së pamjes fizike të një personi. Fushëveprimi i fyerjes së trupit është i gjerë dhe mund të përfshijë, edhe pse jo i kufizuar në, fyerje për mbipeshën, fyerje për të qenit i dobët, fyerje për gjatësinë, fyerje për qimet në trup (ose për mungesën e tyre), për ngjyrën e flokëve, formën e trupit, muskujt e dikujt (ose për mungesën e tyre), fyerje për pamjen (tiparet e fytyrës) dhe në kuptimin e vet më të gjerë mund të përfshijë edhe fyerje për tatuazhe dhe piercing apo për sëmundje që lënë gjurmë fizike, siç është psoriaza. Ndonjëherë, fyerja e trupit mund të shtrihet deri në perceptimin se dikush nuk shfaq mjaftueshëm tipare mashkullore ose femërore. Për shembull, burrat me ije të gjera ose gjoks të dukshëm ose mungesë të qimeve të fytyrës ndonjëherë turpërohen se kanë paraqitje femërore. Ngjashëm, gratë janë turpëruar për shkak të mungesës së feminilitetit të tyre, se duken që kanë fryrje mashkullore apo shpatulla të gjera, tipare që lidhen zakonisht me burrat. Fyerja e trupit në nivele të ekzagjeruara mund të ketë efekte negative emocionale, përfshirë ulje të vetëvlerësimit dhe çështje të tjera të tilla si çrregullimet të të ngrënit, ankth, dismorfia trupore dhe depresion. Gjithashtu, fyerja e trupit mund të çojë në depresion të rëndë, sidomos kur njerëzit mendojnë se trupi i tyre nuk i përmbush kriteret shoqërore.

**Kërcënimi me vdekje:** kërcënimi me vdekje është kërcënim, i bërë shpesh në mënyrë anonime, nga një person ose një grup njerëzish për të vrarë një person tjetër ose një grup njerëzish. Këto lloj kërcënimesh shpesh bëhen për t'i frikësuar viktimat, për t'i penguar ose manipuluar sjelljen e tyre, dhe kështu kërcënimi me vdekje mund të jetë një formë e shtrëngimit. Për shembull, kërcënimi me vdekje mund të përdoret për ta shkurajuar një figurë publike nga ndjekja e një hetimi penal apo e një fushate avokuese.

**Shpifja:** e njohur edhe si përfolje, poshtërim, trillim, njollosje, akuza të rreme apo lëndim, është komunikimi me gojë ose me shkrim i një deklarate të rremë për një person apo grup tjetër që në mënyrë të padrejtë cenon reputacionin e tyre dhe zakonisht përbën shkelje ose krim. Disa juridiksione të së drejtës zakonore bëjnë dallimin ndërmjet shpifjes së folur dhe shpifjes në media të tjera, si fjalë të shtypura apo imazhe. Në disa juridiksione, shpifja trajtohet edhe si krim.

**Dehumanizimi:** mohimi i humanizimit të plotë të tjerët dhe mizoria dhe vuajtja që e shoqërojnë atë. Më gjerësisht, t'i shikosh dhe trajtosh personat e tjerë sikur u mungojnë kapacitetet mendore që zakonisht u atribuohen qenieve njerëzore. Dehumanizimi është gjithashtu një 'teknikë' në nxitjen e gjenocidit dhe është përdorur për të justifikuar luftën, vrasjet gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, skllavërinë, konfiskimin e pasurisë, mohimin e votës dhe të drejtat e tjera dhe për të sulmuar armiqtë ose kundërshtarët politikë.

**Denigrimi:** sulmi ndaj kapacitetit, karakterit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me përkatësinë e tyre me një grup të caktuar personash.

**Diskriminimi:** çdo trajtim diferencial mbi baza të tillë si "raca", ngjyra, gjuha, feja, kombësia ose origjina kombëtare ose etnike, si dhe prejardhja, besimi, seksi, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual ose karakteristika të tjera personale ose statusi, që nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

**Shaka mbi baza etnike:** shprehje që synon të bëjë humor lidhur me një grup etnik, racor ose kulturor, shpesh duke iu referuar një stereotipi etnik të grupit në fjalë kur jep thelbin e shprehjes. Perceptimet e shakave me baza etnike janë ambivalente: teksa shumë i konsiderojnë ato raciste dhe fyese (dhe madje edhe si thirrje për dhunë), disa njerëz i konsiderojnë ato të pranueshme, brenda fushës së humorit. Sidoqoftë, shumica e

studiuesve pohojnë se shakatë mbi baza etnike mund të përforcojnë stereotipet etnike dhe të kenë efekte të rënda psikologjike tek shënjestrat e tyre.

**Gjinia:** role, sjellje, aktivitete dhe tipare të konstruara nga shoqëria, që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat.

**Identiteti gjinor:** ndjenja e thellë e brendshme dhe individuale e secilit person lidhur me përjetimin e gjinisë, që mund ose nuk korrespondon me seksin e caktuar në lindje, duke përfshirë edhe ndjesinë personale të trupit (që mund të përfshijë, nëse zgjidhet lirisht, modifikime të pamjes trupore ose funksionit me mjete mjekësore, kirurgjikale ose të tjera) dhe shprehje të tjera të gjinisë, duke përfshirë veshjen, të folurit dhe manerizmat.

**Gjuha e urrejtjes:** përfshin përdorimin e një apo shumë formave të caktuara të të shprehurit, përkatësisht avokimin, promovimin, ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes, apo poshtërimit të një personi apo grupi të personave, si dhe ngacmimet, fyerjet, stereotipizimet negative, stigmatizimin apo kërcënimin e këtij personi apo personave dhe çdo arsytim të të gjitha këtyre formave të të shprehurit që bazohen në listë jo përfundimtare të karakteristikave personale apo statusit që përfshin "racën", ngjyrën, gjuhën, fenë ose besimin, kombësinë ose origjinën kombëtare ose etnike, si dhe prejardhjen, moshën, aftësinë e kufizuar, seksin, gjininë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual. Përdorimi i formave të tilla si forma të shprehjes nuk ka për synim të nxisë kryerjen e akteve të dhunës, intimidimit, armiqësisë apo diskriminimit, por gjithashtu konsiderohet se e kanë atë efekt. Në këtë kontekst, shprehja kuptohet se mbulon të folurit dhe publikimin në çfarëdo forme, si edhe përhapjen dhe ruajtjen dhe mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të folura, apo çdo formë tjetër si fotografi, shenja, simbole, piktura, muzikë, drama apo video. Gjithashtu, format e të shprehurit mund të përfshijnë edhe mohimin publik, uljen e rëndësisë, arsytimin apo shfajësimin e krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës që gjykatat kanë konstatuar se kanë ndodhur, si edhe glorifikimin e personave që i kanë kryer këto krime.

**Urrejtja:** normalisht konsiderohet si gjendje shpirtërore e karakterizuar si emocione të forta dhe irracionale të përbuzjes, armiqësisë dhe neveritjes ndaj personit ose grupit të synuar. Sidoqoftë, mund të përkufizohet edhe si reagim i thellë psikologjik ndaj ndjenjës së të qenit i/e bllokuar ose i/e paaftë për të kuptuar rregulla të caktuara sociologjike, si dhe një reagim racional për vetëruajtjen dhe menaxhimin strategjik të konfliktit dhe agresionit.

**Homofobia:** paragjykim kundër, ndaj, ose frika nga homoseksualiteti ose ndaj njerëzve që identifikohen ose perceptohen se janë biseksualë, gej, lesbike ose transgjjinorë.

**Nxitja:** deklarata për grupe të personave që krijojnë rrezik të menjëhershëm për diskriminim, armiqësi ose dhunë ndaj personave që u përkasin atyre grupeve.

**Islamofobia:** paragjykitime qëllimkëqija ndaj, urrejtje ndaj ose frikë nga feja Islame ose myslimanët.

**Stereotipizimi negativ:** atribuimi ndaj një anëtarit ose ndaj anëtarëve të një grupi personash i një besimi të përgjithësuar në lidhje me karakteristikat e atyre që i përkasin atij grupi që përfshin shikimin e të gjithë atyre me sy negativ, pavarësisht nga karakteristikat e veçanta të anëtarit ose anëtarëve të veçantë në fjalë.

**Racizmi:** besimi se baza të tillë si "raca", ngjyra, gjuha, feja, kombësia ose origjina kombëtare ose etnike arsyetojnë përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e epërsisë së një personi ose një grupi personash.

**Orientimi seksual:** kapaciteti i secilit person për tërheqje të thellë emocionale, ndjesore dhe seksuale, si dhe intime dhe seksuale.

**Stigmatizimi:** etiketimi i një grupi personash në mënyrë negative.

**Sharje:** sharja racore ose etnike është shprehje me qëllimin për të shpifur, poshtëruar, përbuzur dhe fyer pjesëtarë të një grupi racor ose etnik, zakonisht nga ata që nuk janë pjesëtarë të atij grupi racor ose etnik. Në anglisht, shembuj të sharjeve racore ose etnike përfshijnë shprehje si "negro," "kun" dhe "kajak".

**Transfobia:** paragjykim ndaj, urrejtje kundër apo frikë nga transeksualiteti dhe personat transeksualë ose transgjinatorë, në bazë të shprehjes së identitetit të tyre gjinor të brendshëm.

**Abuzim verbal:** edhe, sulm verbal apo mësymje verbale, është akti i kritikës, fyerjes apo denoncimit me forcë të një personi tjetër. Karakterizohet nga zemërimi dhe urrejtja e fshehur, është një formë shkatërruese e komunikimit që synon të lëndojë konceptin e personit tjetër dhe të krijojë emocione negative. Abuzimi verbal është mekanizëm i keqpërshtatur që secili mund ta shfaqë herë pas here apo në kohë të stresit apo paretatisë së madhe fizike. Për disa njerëz, është model i sjelljes që përdoret me qëllim për të kontrolluar ose manipuluar të tjerët, ose për t'u hakmarrë.

**Poshtërimi:** kritika abuzive e një apo më shumë personave në lidhje me përkatësinë e tyre në një grup të caktuar personash.

**Dhuna:** përdorimi i forcës fizike ose fuqisë kundër një personi tjetër, ose kundër një grupi ose komuniteti, që rezulton në, ose ka gjasë të lartë të rezultojë në, lëndim, vdekje, lëndim psikologjik, keqzhvillim ose privim. Në fushën e gjuhës së urrejtjes dhe kontrastit të gjuhës së urrejtjes, sidoqoftë, dhuna synon të jetë edhe psikologjike, d.m.th. është veprimi i qëllimshëm kundër një personi ose një grupi njerëzish që sjell dëmtime fizike, mendore, shpirtërore, morale dhe shoqërore, përfshirë fyerje, kërcënime, sulme, abuzim verbal.

**Grupet e ndjeshme:** ato grupe që janë posaçërisht objekt i gjuhës së urrejtjes, që ndryshojnë në varësi të rrethanave kombëtare, por ka të ngjarë të përfshijnë azilkërkues dhe refugjatë, emigrantë dhe migrantë të tjerë, komunitete të të zinjve dhe hebrenjve, myslimanë, romë/ciganë, si dhe pakica të tjera fetare, historike, etnike dhe gjuhësore dhe personat LGBT; në veçanti përfshin fëmijë dhe të rinj që i përkasin grupeve të tilla.

**Ksenofobia:** përkufizohet si frika ose urrejtja ndaj asaj që perceptohet të jetë e huaj ose e panjohur. Është shprehje e konfliktit (të perceptuar dhe të pavetëdijshëm) midis një grupi të brendshëm dhe një grupi të jashtëm dhe mund të shfaqet si dyshim ndaj njëri-tjetrit, si dëshirë për të marginalizuar, heshtur, ose eliminuar praninë e grupit të jashtëm dhe frikën e humbjes së identitetit kombëtar, etnik ose racor.

## 2. Pyetësor

### GJUHA E URREJTJES DHE DISKRIMINIMI NË SHQIPËRI

Ky sondazh merret me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin në Shqipëri. Sondazhi synon të vlerësojë dhe të rrisë ndërgjegjësimin për gjuhën e urrejtjes në shoqëri. Rezultatet e tij do të përdoren për të mbështetur dhe vënë në zbatim veprime për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe efektet e gjuhës së urrejtjes. Për këtë arsye, ne do të ishim shumë mirënjohës nëse mund të plotësonit pyetësinorin i cili do të na japë pikëpamjet tuaja mbi këtë temë. Pyetësori është anonim. Faleminderit për bashkëpunimin.

#### Informata bazë (B)

B1: Seksi/gjinia

1. Mashkull
2. Femër
3. Preferoj të vetëpërkrahem si \_\_\_\_\_ (jobinar, gjini e papërcaktuar, pagjinor, lutemi specifikoni)
4. Preferoj të mos e them

B2: Moshë

\_\_\_\_\_ (i anketuari e plotëson moshën e vet)

B3: Kombësia/grupi etnik

1. Malazez
2. Serb
3. Shqiptar
4. Boshnjak
5. Grek
6. Bullgar
7. Rom
8. Egjiptian
9. Arumun
10. Maqedonas i Veriut
11. Kombësi tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

B4: Niveli i shkollimit të përfunduar

1. Pa shkollim
2. Shkollë e mesme – cikli i parë
3. Shkollë e mesme – cikli i dytë
4. Universitet – parauniversitar/i diplomuar
5. Universitet – pasuniversitar (Master, Ph.D.)

B5: A jeni të punësuar në:

1. Sektorin publik
2. Sektorin privat
3. Vetëpunësuar
4. Papunësuar
5. Në pension

B6: Feja (vetëm një përgjigje)

1. Kisha ortodokse

2. Islami
3. Katolicizmi
4. Kisha evangjelike
5. Bektashi
6. Fe të tjera
7. Pa orientim fetar
8. Preferoj të mos e them

**Si do ta përkufizonit veten?**

1. Heteroseksual
2. Lesbike
3. Gej
4. Vajzë/grua biseksuale
5. Vajzë/grua transgjimore
6. Djalë/burrë transgjimor
7. Interseks
8. Tjetër, specifiko

**A jeni person me aftësi të kufizuara?**

1. Po
2. Jo

Informacion i ndërlidhur me gjuhën e urrejtjes (GJU)

GJU1: A e dini se çfarë është gjuha e urrejtjes?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di/Nuk jam i/e sigurt

GJU1.1 A e dini se çfarë është gjuha fyese/diskriminuese?

*Për shembull, përdorimi i fjalëve specifike që ofendojnë personat për shkak të orientimit seksual, karakteristikave fizike etj.*

1. Po
2. Jo-Fundi i pyetësorit

GJU2: Nëse jeni përgjigjur me 'po' në pyetjet paraprake, a mund të shpjegoni me disa fjalë ç'nënkupton kjo për ju?

GJU3: Sipas mendimit tuaj, deri në ç'masë është e përhapur gjuha e urrejtjes në Shqipëri?

1. Në masë të vogël
2. Deri diku
3. Në masë të moderuar
4. Në masë të madhe
5. Në masë shumë të madhe
6. Nuk jam i sigurt

GJU4: Sipas mendimit tuaj, cili është motivi kryesor që nxit gjuhën e urrejtjes (mund të zgjidhni më shumë se një motiv)?

1. Homo-bi-lesbo-transfobia (*Fobia/frika nga komuniteti LGBT*)
2. Mosigjinya (*Fobia/frika nga gratë*)
3. Paraqitja fizike
4. Kombësia (kundër kombësive të tjera)
5. Etnia (kundër pakicave etnike, si romë, egjiptianë etj.)
6. Ksenofobia (kundër të huajve, emigrantëve, refugjatëve)
7. Raca

8. Feja
9. Mendimi politik
10. Statusi social
11. Varfëria/mungesa e strehës
12. Urrejtja ndaj OJQ-ve, vullnetarëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut
13. Moshë
14. Aftësia e kufizuar
15. Të gjitha
16. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU5: Nga përvoja juaj, ku/në cilin kontekst përjetohet më së shumti në Shqipëri gjuha e urrejtjes (mund të zgjidhni më shumë se një)?

1. Vendi i punës
2. Shkollat/universitetet
3. Sporti
4. Zyrat publike
5. Sektori i shëndetësisë
6. Transporti
7. Media e popullarizuar, si gazetat, TV, radio, etj.
8. Media sociale
9. Platforma për transmetim, si Zoom, Meet, Teams, etj.
10. Ligjërimi politik
11. Bisedat private
12. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU6: Sipas mendimit tuaj, cilat programe televizive (nëse ka) kanë më shumë gjasa të përhapin gjuhën e urrejtjes tek audiencat e tyre?  
(mund të zgjidhni më shumë se një)

1. Lajmet e mbrëmjes
2. Debatet politike
3. Debatet e përgjithshme
4. Programet e pasdites
5. Programet e mbrëmjes
6. Shfaqjet e realitetit
7. Telenovelat
8. Filmat
9. Reklamat
10. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU7: Sipas mendimit tuaj, cila nga format e mëposhtme të shprehjes mund të etiketohet si gjuhë e urrejtjes?  
(mund të zgjidhni më shumë se një)

1. Blasfemia
2. Sharjet/fyerjet me baza etnike
3. Shpifja (akti i dëmtimit të reputacionit të mirë të dikujt)
4. Kërcënimet
5. Mësymjet verbale
6. Nxitja për urrejtje
7. Fyerja e trupit
8. Stereotipe për njerëzit LGBTIQ
9. Stereotipet për grupet etnike
10. Dehumanizimi i emigrantëve/refugjatëve
11. Shaka për persona me aftësi të kufizuara
12. Shaka për gratë

13. Shaka për pakicat etnike
14. Shaka për fe specifike
15. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU8.1 A keni dëgjuar kohëve të fundit apo a i jeni ekspozuar vetë gjuhës së urrejtjes apo keni dëgjuar për të tjerë?

(mund të zgjidhni më shumë se një)

Po, personalisht

Po, për të tjerë

3. Jo, nuk i jam ekspozuar dhe as nuk kam dëgjuar për të tjerë

GJU8.2: A mund të na jepni një shembull të gjuhës së urrejtjes që keni dëgjuar apo i jeni ekspozuar kohëve të fundit? (nëse përgjigja në pyetjet e mësipërme ishte Po)

GJU9: Sipas mendimit tuaj, cilat janë institucionet më të angazhuara në luftën kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri (mund të zgjidhni më shumë se një)?

(mund të zgjidhni më shumë se një)

1. Qeveria qendrore
2. Ministria e Drejtësisë
3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
4. Ministria e Arsimit
5. Ministria e Kulturës
6. Parlamenti (dhe komisionet parlamentare)
7. Qeveria rajonale ose lokale
8. Partitë politike
9. Zyrat publike dhe nëpunësit civilë
10. Shkollat/Universitetet
11. Kompanitë mediatike shtetërore
12. Autoriteti i Medias Audio-Vizuale (AMA)
13. Kompani mediatike private përveç medias sociale
14. Kompani të medias sociale
15. Kompani të tjera private
16. Institucionet fetare
17. Komisioneri Kundër Diskriminimit
18. Avokati i Popullit
19. Policia
20. Gjykatat dhe magjistratët
21. Institucionet arsimore
22. OJQ-të
23. Shoqatat/shoqëria civile
24. Organizatat ndërkombëtare (si BE, OSCE/ODIHR, Këshilli i Evropës, OKB, etj.)
25. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU10: A jeni në dijeni të ndonjë ligji që i mbron njerëzit nga gjuha e urrejtjes?

1. Po
2. Supozoj se ka disa ligje, por nuk jam i/e mirëinformuar
3. Jo, nuk di gjë për asnjë ligj të tillë

GJU11: Nëse do të bëheshit shënjestër e gjuhës së urrejtjes, ku do të drejtoheshit për ndihmë? (mund të zgjidhni më shumë se një)

1. Zyrtar policor
2. Gjykata
3. Avokati

4. Komisioneri Kundër Diskriminimit
5. Avokati i Popullit
6. Çdo zyrë publike
7. Mjeku/psikologu
8. Media (gazetarët)
9. OJQ-të
10. Shoqata të shoqërisë civile
11. Miq dhe/ose familjarë
12. Nuk e di
13. Nuk do të flisja me asnjeri
14. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU12: Nëse i jeni përgjigjur pikës 13 në pyetjen paraprahe, a mund të na shpjegoni pse?  
(mund të zgjidhni më shumë se një)

1. Sepse kisha/do të kisha frikë mos nuk më marrin seriozisht
2. Sepse kisha/do të kisha frikë mos viktimizohesha sërish
3. Sepse askujt nuk i intereson
4. Sepse nuk mendoja/nuk do të mendoja që gjuha e urrejtjes është çështje shumë serioze
5. Sepse askush nuk do të më besonte
6. Sepse do të më vinte turp t'i tregoja dikujt se çfarë më ka ndodhur
7. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU13: A i jeni ekspozuar ndonjëherë gjuhës së urrejtjes online?

1. Kurrë
2. Një herë
3. Pak herë
4. Disa herë
5. Shumë shpesh
6. Nuk e di

GJU14: Në rast se i jeni ekspozuar gjuhës së urrejtjes online, çfarë keni bërë?  
(mund të zgjidhni më shumë se një)

1. Absolutisht asgjë: E kam kapërcyer
2. Nuk e dija çfarë të bëja dhe kam kërkuar këshilla nga dikush tjetër
3. E kam raportuar tek ofruesi i medias sociale
4. E kam raportuar në polici
5. E kam raportuar tek avokati/në gjykatë
6. E kam raportuar tek shoqata e shoqërisë civile
7. E kam raportuar tek Komisioneri Kundër Diskriminimit
8. E kam raportuar tek Avokati i Popullit
9. Jam kundërpërgjigjur dhe jam përpjekur të përfshihem me personin që më sulmoi
10. E kam fshirë mesazhin me gjuhë të urrejtjes e kam larguar nga lista e miqve/bllokuar personin që më ka sulmuar
11. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU15: Në rast se keni qenë dëshmitar i gjuhës së urrejtjes ndaj dikujt tjetër, a keni ndërmarrë ndonjë veprim?

*(nëse pyetjes GJU8.1 i jeni përgjigjur me po)*

1. Po
2. Jo
3. E kam menduar, por pastaj nuk dija se çfarë të bëja
4. Nuk kam qenë kurrë dëshmitar i asaj situate



GJU16: Sipas mendimit tuaj, cilët nga personat. grupet në vijim të shënjestruar nga gjuha e urrejtjes kanë gjasa të përjetojnë:

()

(mund të zgjidhni më shumë se një)

1. Asgjë: gjuha e urrejtjes nuk është aspak e dëmshme, janë vetëm fjalë
2. Befasi të vogël
3. Mosbesim: përse unë?
4. Ndjesi të kërcënimit ndaj vetes
5. Ndjesi të kërcënimit për familjen, miqtë, grupin e tij/saj
6. Ndjesi turpi
7. Parehati fizike
8. Dhimbje emocionale
9. Ndjesi të përgjithshme pasigurie
10. Ankth dhe depresion
11. Humbje të vetëbesimit
12. Humbje të besimit tek të tjerët
13. Urrejtje ndaj atij/asaj që e ka sulmuar
14. Ndjenjë të hakmarrjes
15. Stres post-traumatik
16. Tjetër (lutemi specifikoni) \_\_\_\_\_

GJU17: Sipas mendimit tuaj, deri në ç'masë ka ndikuar epidemia e Covid-19 në qarkullimin e gjuhës së urrejtjes?

1. Mendoj se përgjithësisht e ka rritur përhapjen e gjuhës së urrejtjes
2. Mendoj se e ka rritur nivelin e gjuhës së urrejtjes ndaj individëve/grupeve specifike
3. Mendoj se e ka ulur përhapjen e gjuhës së urrejtjes
4. Nuk ka pasur ndonjë efekt specifik
5. Nuk e di/nuk mund të them

### 3. Metodologjia CAWI

**Qasja CAWI** (intervistimi online) është përdorur për të mbledhur intervistat në Shqipëri. Në këtë rast është përdorur platforma IDRApoll. IDRApoll ([www.idrapoll.com](http://www.idrapoll.com)) është një panel i sondazheve online (në dijeninë tonë, i vetmi panel sondazhi në tregun shqiptar) i krijuar nga IDRA Research and Consulting ([www.idracompany.com](http://www.idracompany.com)), me synimin për të zgjeruar hulumtimin e tregut dhe sondazhet edhe përmes platformave online.

Për të krijuar një komunitet përfaqësues, në aspektin gjeografik, të moshës dhe të statusit shoqëror, i krijuar edhe një sistem shpërblimi përmes pikëve, për secilin sondazh të kryer nga IDRApoll, ku përdoruesit grumbullojnë pikë që mund të përdoren për dhurata të ndryshme. Çdo përdorues i regjistruar i IDRApoll ka plotësuar informacionin në lidhje me demografinë si gjinia, moshën, statusin shoqëror, etj., duke krijuar kështu profilin e secilit përdorues. Bazuar në këtë informacion është krijuar modeli për sondazhe dhe në rast se në platformë ka munguar ndonjë informacion specifik lidhur me profilin, është bërë parazgjedhja e të anketuarve. Kjo do të thotë që vetëm ata përdorues që janë "të përshtatshëm" për projektin mund të jenë pjesë e mostrës së sondazhit.

